VENDIM
Nr. 51, datë 26.1.2022

PËR MIRATIMIN E PROGRAMIT TË REFORMAVE EKONOMIKE (ERP) 2022–2024

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, me propozimin e ministrit të Financave dhe Ekonomisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Miratimin e Programit të Reformave Ekonomike (ERP) 2022–2024, sipas tekstit që i bashkëlidhet këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTËR
Edi Rama

PROGRAMI I REFORMAVE EKONOMIKE
2022–2024
31 janar 2022

Pasqyra e përmbajtjes

1. KUADRI I PËRGJITHSHËM POLITIK DHE OBJEKTIVAT
2. ZBATIMI I UDHËZIMEVE POLITIKE
Rekomandimi 1
Rekomandimi 2
Rekomandimi 3
Rekomandimi 4
Rekomandimi 5
Rekomandimi 6
3. KUADRI MAKROEKONOMIK
3.1 Zhvillimet e fundit ekonomike
3.2 Skenari makroekonomik afatmesëm
3.3 Skenari alternativ dhe rreziqet
4. KUADRI FISKAL
4.1 Politikat strategjike dhe objektivat afatmesëm
4.2 Implementimi i buxhetit për vitin 2021
4.3 Planet buxhetore për vitin e dorëzimit të ERP-së
4.4 Perspektiva buxhetore afatmesme
4.5 Balanca strukturore
4.6 Niveli i borxhit dhe zhvillimet
4.7 Analiza e ndjeshmërisë dhe krahasimi me programin e mëparshëm
4.8 Cilësia e financave publike
4.9 Qeverisja fiskale dhe kuadri buxhetor
4.10 Qëndrueshmëria e financave publike
5. REFORMAT STRUKTURORE PARËSORE MË 2022–2024
5.1 Përditësim mbi tri pengesat kryesore në konkurrueshmëri dhe rritje përfshirëse dhe masat e reformave të lidhura
Sfida kyçe #1
Sfida kyçe #2
Sfida kyçe #3
5.2. Analiza e pengesave në fusha të tjera
5.2.1 Menaxhimi i financave publike
5.2.2 Tranzicioni i gjelbër

5.2.3 Transformimi digjital, kërkim, zhvillim dhe inovacion
5.2.4 Mjedisi i biznesit dhe reduktimi i ekonomisë informale
5.2.5 Integrimi ekonomik
5.2.6 Energjia
5.2.7 Transporti
5.2.8 Bujqësi, industri dhe shërbime
5.2.9 Arsimimi dhe aftësitë
5.2.10 Punësimi dhe tregjet e punës
5.3 Përmbledhje e masave të reformës
6. KOSTIMI DHE FINANCIMI I REFORMAVE STRUKTURORE
7. ÇËSHTJET INSTITUCIONALE DHE PËRFSHIRJA E GRUPEVE TË INTERESIT
SHTOJCA I
Tabela 1a: Perspektivat makroekonomike
Tabela 1b: Zhvillimet e çmimeve
Tabela 1c: Zhvillimet në tregun e punës
Tabela 1d: Bilancet sektoriale
Tabela 1e: PBB, investime dhe vlera e shtuar bruto
Tabela 1f: Zhvillime të sektorit të jashtëm
Tabela 1g: Indikatorët e qëndrueshmërisë
Tabela 2a: Perspektivat e përgjithshme buxhetore të qeverisë
Tabela 2b: Perspektivat e përgjithshme buxhetore të qeverisë
Tabela 4: Zhvillime të përgjithshme të borxhit të qeverisë
Tabela 5: Zhvillime ciklike
Tabela 6: Divergjenca nga programi i mëparshëm
Tabela 8: Supozimet bazë mbi mjedisin e jashtëm ekonomik, që qëndron në themel të kornizës së programit
Tabela 9a: Tabela e treguesve socialë
Tabela 9b: Tregues të tjerë
Tabela 10a: Kostimi i masave të reformave strukturore
Sfidat kyçe
Fushat e tjera
Tabela 10b: Financimi i masave të reformave strukturore
Sfidat kyçe
Fushat e tjera
Tabela 11: Raportimi mbi zbatimin e masave të reformave strukturore të ERP 2021–2023
SHTOJCA II
SHTOJCA III

1. KUADRI I PËRGJITHSHËM POLITIK DHE OBJEKTIVAT

Hartimi dhe përgatitja e Programit të Reformave Ekonomike (ERP) 2022–2024 u bë i mundur përmes bashkëpunimit ndërinstitucional midis Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë, në cilësinë e Koordinatorit Kombëtar të ERP-së, dhe ministrive të ndryshme të linjës, Bankës së Shqipërisë dhe INSTAT-it.

Programi i Reformave Ekonomike 2022–2024 paraqet politikat kryesore makroekonomike dhe fiskale, që synojnë të vendosin një ekuilibër të qartë midis forcave të brendshme dhe kërcënimeve të jashtme, me qëllim që të mundësojnë zhvillim të qëndrueshëm, rritje të punësimit dhe uljen e borxhit publik. Për më tepër, ERP-ja përmbledh masat e reformave prioritare të qeverisë së Shqipërisë për periudhën afatshkurtër, me qëllim rritjen e prodhimit vendës, nxitjen e investimeve të reja dhe sigurimin e një zhvillimi të qëndrueshme dhe rritjen e konkurrueshmërisë.

ERP 2022–2024, gjithashtu, përfshin ato reforma strukturore prioritare, që janë në vazhdimësi nga ERP-ja e mëparshme, së bashku me shtesat e reja të përfshira në këtë cikël. Qëllimi kryesor i kësaj qasjeje është të sigurojë një përfaqësim të vazhdueshëm të atyre reformave, që janë ende në zbatim, duke siguruar kështu qëndrueshmëri në agjendën e reformës prioritare.

Ekonomia shqiptare ka qenë mjaft elastike përballë dy goditjeve të njëpasnjëshme të tërmetit të nëntorit 2019, ndjekur nga shpërthimi i pandemisë COVID-19. Mbështetja e politikës fiskale dhe monetare së bashku me masat e duhura rregullatore kanë ndihmuar në zbutjen e ndikimit në popullatë dhe ekonomi

dhe kanë përgatitur terrenin për një rimëkëmbje të shpejtë dhe të fuqishme. Pas një tkurrjeje prej 4 për qind në vitin 2020, ekonomia po rimëkëmbet fuqishëm me 8.7 për qind të parashikuar më 2021-shin. Sfidat kryesore janë investimet me efikasitet për të mbështetur zhvillimin e vazhdueshëm të vendit dhe për të rindërtuar hapësirën e duhur për politikën fiskale me qëllim uljen e deficitit fiskal dhe borxhit publik.

Politika fiskale në periudhën afatmesme 2022–2024 do të orientohet drejt konsolidimit fiskal, në përputhje me rregullat fiskale të përcaktuara në ligjin organik të buxhetit, si dhe në rekomandimet e Komisionit Evropian në Përfundimet e Përbashkëta të Dialogut Ekonomik dhe Financiar midis BE-së dhe Ballkanit Perëndimorë, në korrik të vitit 2021.

Në vitin 2022, deficiti i përgjithshëm fiskal pritet të arrijë në 5.4% të PBB-së, në rënie, duke e krahasuar me ligjin e buxhetit 2020 të rishikuar prej 6.8%, si dhe duke e krahasuar me tejkalimin e pritur për 2021-shin, me rreth 5.8% të PBB-së. Në vijim, bilanci i përgjithshëm fiskal synohet të arrijë në 2.9% më 2023-shin, dhe 2.8% më 2024-ën. Pavarësisht parashikimit për një deficit primar prej -2.7% të PBB-së më 2022-shin, bilanci primar është përmirësuar në krahasim me nivelin e pritur të vitit 2021 prej -3.8%. Më 2023-shin, bilanci primar synohet në balancë dhe më 2024-ën pritet të arrijë një suficit prej 0.3% të PBB-së. Si rezultat, niveli i borxhit publik parashikohet të rikthehet në një trajektore rënëse nga 2022-shi e në vijim. Borxhi i përgjithshëm publik është parashikuar në 78.9% të PBB-së më 2022-shin, nga rreth 80.1%, që pritet për 2021-shin. Në fund të vitit 2023, borxhi publik parashikohet të reduktohet në rreth 77.7% të PBB-së dhe më 2023ë-shin në rreth 75.8% të PBB-së.

Njëkohësisht, është synuar dhe programuar ruajtja e një niveli mesatar vjetor të investimeve publike prej rreth 5.3% të PBB-së, gjatë periudhës 2022–2024, që është thelbësore për të mbështetur rritjen ekonomike në periudhën afatmesme dhe afatgjatë. Bilanci korrent fiskal (diferenca midis investimeve publike dhe deficitit fiskal), do të jetë pozitive në vitin 2022, në nivelin 1% të PBB-së nga një nivel i pritshëm përsëri pozitiv prej 2.3% për vitin 2021, në përputhje kjo me rregullën respektive fiskale ("rregulla e artë" e buxhetit).

2. ZBATIMI I UDHËZIMEVE POLITIKE

Rekomandimi 1

1.1 Me kusht që rimëkëmbja e ekonomisë të rrënjoset mirë, të parashikohet në buxhetin e vitit 2022 dhe në planin fiskal afatmesëm një ulje graduale e borxhit publik, si raport i PBB-së dhe, bazuar në një parashikim realist të të ardhurave, kthim në balancë primare pozitive që nga viti 2023, në përputhje me rregullën fiskale përkatëse

Ekonomia e vendit tonë ka treguar qëndrueshmëri të konsiderueshme përballë tërmetit të vitit 2019 dhe pandemisë. Në vitin 2020, si kundërpërgjigje kryesore ndaj amortizimit deri diku të goditjes pandemike, është ndërmarrë një politikë fiskale mjaft ekspansioniste, duke ruajtur këtë politikë edhe për vitin 2021. Për rrjedhojë, deficiti total buxhetor pritet të arrijë në rreth 5.8% e PBB-së më 2021-shin nga rreth 6.8% më 2020-shin dhe borxhi publik pritet të rritet në rreth 80.1% të PBB-së nga rreth 75.7% më 2020-shin ose rreth 65.8%, që ishte në fund të 2019.

Pas një viti të vështirë në 2020, ekonomia po rimëkëmbet fuqishëm, parashikuar në 8.7 për qind të PBB-së më 2021 dhe pritet të jetë rreth 4.1% gjatë viteve 2022–2024. Për periudhën afatmesme, objektivi bazë i politikës fiskale, në përputhje me qëllimin kryesor të sigurimit të stabilitetit makroekonomik të vendit si një premisë thelbësore për sigurimin e rritjes ekonomike të qëndrueshme dhe gjithëpërfshirëse, si dhe në përputhje me këtë udhëzim të politikës (PG 1.1), do të jetë sërish konsolidimi fiskal. Politika fiskale do të synojë një trajektore rënëse të borxhit publik, pra një trajektore graduale rënëse, por të qëndrueshme vjetore, ndërkohë që balanca primare do të kthehet në një nivel pozitiv nga viti 2024 e në vazhdim, në përputhje edhe me rregullën fiskale në ligjin organik të buxhetit (LOB).

Duke filluar nga ky vit (2022), borxhi publik si raport i PBB-së pritet të kthehet në një trajektore rënëse, në përputhje me rregullën fiskale përkatëse, ku pritet të bjerë në rreth 78.9 për qind të PBB-së nga rreth 80.1 për qind e parashikuar për 2021. Sipas skenarit bazë, borxhi publik pritet të bjerë në rreth 74.6 për qind në vitin 2025 dhe më tej në rreth 67.7 për qind deri në vitin 2028.

1.2 Përfundimi i Strategjisë Afatmesme të të Ardhurave dhe fillimi i zbatimit të saj në përputhje me marrëveshjen e grupit ndërinstitucional të punës, por jo më vonë se përpara dorëzimit të ardhshëm të ERP-së

Strategjia afatmesme e të ardhurave është në proces finalizimi dhe në vitin 2022 do të fillojë zbatimi i masave të parashikuara.

1.3 Rritja e kapaciteteve institucionale të njësisë së riskut fiskal për të vazhduar dhe për të zgjeruar punën e saj pa u mbështetur në asistencën e jashtme

Parimisht dakord, bazuar edhe në kërkesat tona për rritje të stafit dhe trajnimeve, por theksojmë se rritja e kapaciteteve të NJRF-së është në vendimmarrjen e nivelit drejtues.

Rekomandimi 2

2.1 Të vijohet reduktimi i stokut të detyrimeve të prapambetura të bazuara në kontratë; të zerohen detyrimet e prapambetura të rimbursimit TVSH-së në vitin 2022 dhe të analizohen arsyet e rritjes së detyrimeve të prapambetura të pushtetit vendor

Që nga prilli 2020, DPT-ja publikon rregullisht në faqen e saj të internetit një publikim tremujor të dedikuar në lidhje me rimbursimin e TVSH-së dhe detyrimet e prapambetura për TVSH-në.

Konceptimi i procedurës së automatizuar me bazë risku për administrimin e rimbursimeve të TVSH-së ka përfunduar dhe pjesa më e madhe e punës për të zbatuar rimbursimin automatik të TVSH-së është kryer. Gjatë vitit 2020 u amendua rregullorja e brendshme e TVSH-së në DPT, që synonte lehtësimin dhe thjeshtimin e kritereve të aplikuara të riskut. Prandaj afatet e rimbursimit të TVSH-së u përgjysmuan dhe metoda FIFO u ndoq rreptësisht. Si rezultat, stoku i prapambetur i rimbursimeve të TVSH-së u ul në vitin 2020, krahasuar me vitin 2019.

Trendi në rënie i detyrimeve të prapambetura të rimbursimit të TVSH-së ka qenë më i theksuar gjatë vitit 2021. DPT-ja zeroi (prej shtatorit 2021) të gjithë stokun e rimbursimeve TVSH me këste, me përjashtim të njërit prej tyre, pagesa e kështit të fundit të të cilit do të jepet brenda vitit 2021. Deri në fund të shtatorit 2021 ka një stok TVSH prej 477 milionësh ALL, ulur me 95% krahasuar me vlerën e stokut në 31.12.2020 (ishte 9.8 miliardë ALL).

DPT-ja është e angazhuar të pastrojë të gjithë stokun e papaguar të TVSH-së deri në fund të vitit 2021.

Lidhur me rekomandimin "*Vijoni të reduktoni stokun e detyrimeve të prapambetura të bazuara në kontratë*"- Kjo është në përgjegjësi direkte të ministrive të linjës/institucioneve buxhetore, të cilat janë përgjegjëse për krijimin e detyrimeve të prapambetura. Ndërkohë që përgjegjësia e Drejtorisë së Menaxhimit të Buxhetit/Sektorit të Risqeve Fiskale lidhet me procesin e përpunimit dhe të raportimit të detyrimeve të prapambetura, proces të cilin e zbatojmë dhe jemi në përputhje të plotë me rekomandimet e dhëna nga partnerët.

Konceptimi i procedurës së automatizuar me bazë risku për administrimin e rimbursimeve të TVSH-së ka përfunduar dhe pjesa më e madhe e punës për të zbatuar rimbursimin automatik të TVSH-së është kryer. Gjatë vitit 2020 u amendua rregullorja e brendshme e TVSH-së në DPT, që synonte lehtësimin dhe thjeshtimin e kritereve të aplikuara të riskut. Prandaj afatet e rimbursimit të TVSH-së u përgjysmuan dhe metoda FIFO u ndoq rreptësisht. Si rezultat, stoku i prapambetur i rimbursimeve të TVSH-së u ul në vitin 2020, krahasuar me vitin 2019. Trendi në rënie i detyrimeve të prapambetura të rimbursimit të TVSH-së ka qenë më i theksuar gjatë vitit 2021. DPT-ja zeroi të gjithë stokun e rimbursimeve TVSH me këste, me përjashtim të njërit prej tyre, pagesa e kështit të fundit, i cili do të jepet brenda vitit 2021. Deri në fund të nëntorit 2021, stoku i TVSH-së është 621 milionë lekë, ulur me 94% krahasuar me vlerën e stokut në 31.12.2020 (ishte 9.8 miliardë lekë). DPT-ja është e angazhuar të pastrojë të gjithë stokun e papaguar të TVSH-së deri në fund të vitit 2021.

Lidhur me rekomandimin "*Analizoni arsyet e rritjes së detyrimeve të prapambetura të pushtetit vendor*", sqarojmë si vijon:

- Detyrimet e prapambetura të njësive të vetëqeverisjes vendore janë kryesisht detyrime të prapambetura të krijuara në të kaluarën, të trashëguara nga ish-njësitë vendore (komunat).

- Rritja e stokut të detyrimit për t'u paguar ndikohet edhe nga faktorë të tjerë të mundshëm, si: vendimet e reja gjyqësore në favor të të tretëve dhe mosrealizimi i të ardhurave vendore të planifikuara. Gjatë dy viteve të fundit, faktorët e jashtëm, si fatkeqësia natyrore, ka ndodhur në vitin 2019, dhe pandemia globale e sëmundjes koronavirus 2019, kanë ndikuar në rritjen e stokut të detyrimeve të prapambetura në disa njësi vendore. Detyrimet e reja të krijuara kanë të bëjnë kryesisht me kategorinë "Investime", "Mallra dhe shërbime" dhe "Vendime gjyqësore".

2.2 Vlerësimi dhe miratimi i të gjitha investimeve, të cilat përfshijnë fonde publike, përfshirë PPP-të, përmes të njëjtit proces miratimi dhe vijimi i raportimit të shpenzimeve aktuale të rindërtimit nga tërmeti në zbatim të buxhetit të konsoliduar

2.3 Riorientimi i përbërjes së shpenzimeve publike drejt zhvillimit të kapitalit njerëzor dhe inovacionit, duke parashikuar një rritje graduale të vazhdueshme të shpenzimeve për arsimin, shëndetësinë, sigurimet shoqërore dhe "Kërkim dhe zhvillim" për sa i përket pjesëmarrjes në totalin e shpenzimeve

Shpenzimet në arsim, shëndetësi, mbrojtje sociale dhe kërkim dhe zhvillim, në vlera nominale janë në rritje nga viti 2016 deri në vitin 2024, të paraqitura dhe në tabelën e shpenzimeve funksionale të qeverisë më sipër.

Rritja e shpenzimeve në këto funksione tregon përpjekjet e vazhdueshme të qeverisë për të mbështetur me prioritet sektorët, si arsim, shëndetësi, mbrojtje sociale dhe K&ZH. Në buxhetin e vitit 2022, sektorëve të arsimit, shëndetësisë, mbrojtjes sociale dhe K&ZH i është kushtuar vëmendje e veçantë duke mbështetur me prioritet politikat e mëposhtme:

- rriten me 6% pagat e punonjësve në sektorët e shëndetësisë, arsimit dhe mbrojtjes;
- financohen si prioritete mbështetja e *start-up*-eve, pagesa e papunësisë së naftëtarëve dhe garancia sovrane 1 miliardë lekë për manifakturën dhe sipërmarrjen;
- për Spitalin Rajonal të Fierit programohet një fond prej 750 milionësh, si dhe do të vijojnë skemat e rimbursimit të barnave dhe e bonusit të bebes;
- do të vijojë skema e librave shkollorë falas për nxënësit nga shtresa në nevojë, e cila zgjerohet deri në shkollën e mesme;
- rritet fondi i mbështetjes për shtresat në nevojë;
- ndihma ekonomike rritet me 10% për 50 mijë familje që përfitojnë prej saj;
- trefishohet ndihma për 675 gra të trafikuara dhe 670 fëmijët e mitur nën 18 vjeç;
- dyfishohet ndihma për nënat me shumë fëmijë nga e cila përfitojnë 15 mijë familje;
- me një fond shtesë prej 250 milionë lekësh për 2022-shin e në vijim sigurohet transporti për nxënësit dhe mësuesit që banojnë larg nga shkolla;
- me 700 milionë lekë të alokuara për projektet e binjakëzimit për universitetet, fokusi mbetet tek të rinjtë dhe edukimi;
- investimet në digjitalizim përfshijnë ministritë përkatëse në sektorët e rendit, mbrojtjes, shëndetësisë, financave dhe ekonomisë dhe arsimin;
- me një fond 1.9 miliardë lekë financohen në arsimin parauniversitar laboratorët shkencorë dhe klasat e teknologjisë së informacionit.

Me investimet në projektet për trajnimin e të rinjve në teknologjinë e informacionit, ata do të përshtaten më mirë me kërkesat dhe ofertat në tregun e punës dhe krijohen vende cilësore të punës.

Rekomandimi 3

3.1 Ruajtja e një kuadri të fortë rregullativ për sektorin financiar, në linjë me praktikat me të mira ndërkombëtare dhe të BE-së, sigurimi i administrimit të shëndoshë të rrezikut të kredisë, i një paraqitjeje transparente të cilësisë së aktiveve dhe i një provigjionimi të përshtatshëm

Përputhshmëria e kuadrit tonë prudencial me praktikat më të mira ndërkombëtare dhe të Bashkimit Evropian, mbetet objektivi ynë i pandryshueshëm.

Në këtë kuadër, në vitet e fundit kemi miratuar disa ligje të rëndësishme për veprimtarinë financiare jobankare, që përfshijnë ligjet: "Mbi sigurimin e detyrueshëm në sektorin e transportit", "Mbi tregjet e kapitalit", "Mbi sipërmarrjet e investimeve kolektive", "Mbi tregjet financiare të bazuar mbi teknologjinë e regjistrave të shpërndarë". Jemi në procesin e përgatitjes së projektligjit "Mbi fondet private të pensionit". Puna për përgatitjen e akteve nënligjore që lidhen me këto ligje, po avancon.

Në lidhje me veprimtarinë bankare përgjatë së njëjtës periudhë, janë miratuar disa rregullore të rëndësishme në fushat e mbikëqyrjes mikro- dhe makroprudenciale dhe të ndërhyrjes së jashtëzakonshme, duke përfshirë rregulloret: "Mbi raportin e likuiditetit", "Për raportin e levës financiare të bankave", "Për shtesat makroprudenciale të kapitalit", "Për fondin e ndërhyrjes së jashtëzakonshme dhe procedurat për administrimin e tij", "Kërkesat minimale për instrumentet e kapitalit rregullator dhe detyrimet e pranuara". Gjithashtu janë publikuar një sërë udhëzimesh dhe metodologjish në fushat e përmendura më sipër.

Ky proces do të vazhdojë në mënyrë të qëndrueshme, duke monitoruar njëherazi dhe me kujdes zhvillimet ekonomike dhe financiare, në mënyrë që, nëse nevojitet, të bëhen rregullimet e nevojshme dhe të gjendet ekuilibri i duhur.

Fokusi kryesor i mbikëqyrjes gjatë periudhës 2020–2021 ishte verifikimi që administrimi i rrezikut të kredisë nga bankat, ishte kryer në mënyrën e duhur, në vijim të ndikimit të COVID-19. Masat ekonomike, financiare dhe prudenciale të marra në kohën e duhur, të shoqëruara me një komunikim të shpeshtë dhe të afërt me bankat ishin elemente që mundësuan ruajtjen e cilësisë së portofolit të kredisë në banka, madje edhe përmirësimin e tij. Megjithatë, pasiguritë në lidhje me zhvillimet ekonomike dhe të shëndetit publik, në vend dhe jashtë tij, mbeten të pranishme. Për më tepër, masat prudenciale për lehtësimin e procesit të

ristrukturimit të kredive, identifikimit të kredive me probleme dhe të provigjionimit të tyre, tani kanë përfunduar. Për këtë arsye, me qëllimin për identifikimin dhe adresimin e çdo dobësie në administrimin e rrezikut të kredisë, ne do të angazhojmë burime dhe procese specifike mbikëqyrëse gjatë vitit 2022.

3.2 Të reduktohen më tej pengesat e mbetura institucionale dhe ligjore për heqjen dhe zgjidhjen efektive të NPL-ve, duke përfshirë zgjidhjen e bllokimit të përmbarimit dhe forcimin e procedurave të falimentimit.

Për sa i përket forcimit të procedurave të falimentimit, Ministria e Drejtësisë është asistuar nga ekspertët e IFC-së në përgatitjen dhe hartimin e "Ligji për falimentimin" (2017) si dhe të akteve nënligjore. Aktualisht janë miratuar 2 aktet e mëposhtme:

- "Për rregullimin e marrëveshjeve së ristrukturimit jashtëgjyqësorë për debitorët në vështirësi financiare", qeveria ka miratuar me vendimin nr. 65, datë 3.2.2021, të Këshillit të Ministrave, rregulloren "Për marrëveshjet e riorganizimit të përshpejtuar jashtë gjykatës".
- "Për rregulloren për paraqitjen e llogarive dhe shkarkimin përfundimtar të përfaqësuesit të falimentimit", Këshilli i Ministrave ka miratuar vendimin nr. 733, datë 13.11.2019, "Për miratimin e standardeve kombëtare për administrimin e masës së falimentimit", i cili parashikon mënyrën e përgatitjes dhe të paraqitjes së llogarive dhe shkarkimin përfundimtar të administratorit të falimentimit.

Për sa i përket funksionimit të procedurës së falimentimit, informacioni në lidhje me vendimin e falimentimit është i disponueshëm publikisht në sisteme/platforma të ndryshme. Së pari, të gjitha procedurat e falimentimit janë, në thelb, procedura gjyqësore. Në këtë këndvështrim, të gjitha proceset gjyqësore janë të disponueshme për publikun në faqet e internetit të gjykatave përkatëse. Në Shqipëri ka shumë sisteme të ndryshme të menaxhimit të gjykatave ARK IT, që përdoret kryesisht nga gjykata e Tiranës dhe ICMIS, që përdoret nga gjykata të tjera. Gjithashtu, disa gjykata kanë faqen e tyre të internetit, si: Gjykata e Apelit të Tiranës dhe Gjykata e Lartë, ku çdo vendim është i disponueshëm për publikun. Nga ana tjetër, bazuar në ligjin për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit, është i detyrueshëm regjistrimi në regjistrin tregtar të çdo vendimi të gjykatës për fillimin e procedurës së falimentimit të një shoqërie. Ky vendim vihet publikisht në faqen e Qendrës Kombëtare të Biznesit dhe pjesë e ekstraktit tregtar të secilës kompani. Prandaj, palët e treta që duan të kryejnë një transaksion biznesi me atë kompani do të informohen lehtësisht nëse kjo kompani është në procedurë falimentimi. Duke marrë parasysh situatën aktuale, të gjithë partnerët përkatës, që kanë ndihmuar Ministrinë e Drejtësisë (IFC etj.) në përmirësimin e kuadrit të përgjithshëm të procedurave të falimentimit e konsiderojnë kuadrin aktual ligjor në fuqi, si efektiv, në drejtim të lehtësimit të procedurave të falimentimit dhe përdorimit të këtij instrumenti për kompanitë në vështirësi.

3.3 Vazhdimi i zbatimit të masave, që synojnë nxitjen e përdorimit të monedhës kombëtare, përfshirë zhvillimin e tregut të instrumenteve financiare mbrojtëse nga rreziku i kursit të këmbimit

Mbështetja e zhvillimit të instrumenteve financiare mbrojtëse nga rreziku i kursit të këmbimit është një ndër objektivat afatmesëm të Bankës së Shqipërisë. Përpjekjet për të zhvilluar tregun e brendshëm të këmbimit valutor nëpërmjet inkurajimit të përdorimit të instrumenteve mbrojtës, janë planifikuar sipas rekomandimeve të lëna nga misioni i posaçëm i asistencës teknike të FMN-së në fund të vitit 2019. Mbështetur në këtë plan veprimi, janë realizuar disa masa:

i. ka rinisur emetimi i bonove të thesarit me maturitet 3-mujor, me periodicitet të përshtatshëm;

ii. është rishikuar udhëzimi mbi mënyrën e llogaritjes "fiksit" të kursit zyrtar të këmbimit, duke realizuar publikimin e kursit të kërkuar dhe atij të ofruar, krahas kursit "fiks". Kuotimet mblidhen vetëm nga bankat për vlera të standardizuara;

iii. është rishikuar rregullorja "Për procedurat e ndërhyrjes së Bankës së Shqipërisë në tregun e brendshëm të këmbimeve valutore", ku janë prezantuar instrumentet *"forwards"* 3-mujore si alternativë për kryerjen e ndërhyrjeve. Kjo do të ndihmojë familjarizimin e tregut me instrumentet dhe përcaktimin e çmimeve të produkteve financiare;

iv. është miratuar udhëzimi për "Raportimin e veprimeve të këmbimeve valutore", i cili përmirëson procesin e standardizimit dhe përpunimit të raportimeve nga operatorët e tregut, dhe rrit informacionin e përftuar duke dalluar instrumentet e përdorur dhe kundër palët në këtë treg.

Banka e Shqipërisë po vlerëson mundësinë për të publikuar në një fazë të mëvonshme të dhëna të agreguara mbi volumin dhe çmimin e transaksioneve të kryera në tregun e këmbimeve valutore, me qëllim rritjen e transparencës. Disa hapa janë bërë në drejtim të prezantimit të marrëveshjeve të standardizuara për transaksionet e këmbimit valutor, nëpërmjet përpjekjeve për prezantimin e instrumenteve derivativë në

marrëdhëniet me Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë. Masa të tjera në planin e punës, të cilat do të konsiderohen në vijim, lidhen me përmirësimin e edukimit financiar dhe standardizimin e marrëveshjeve midis bankave.

Rekomandimi 4

4.1 Ofroni shërbime të zgjeruara të mbështetjes së biznesit për të përmirësuar aksesin në financa dhe njohuritë e sipërmarrjes

Agjencia Shqiptare e Zhvillimit të Investimeve (AIDA) është institucioni qendror publik i dedikuar që ofron shërbime për mbështetjen e biznesit (BSS) për SME-të. AIDA jep informacion të përgjithshëm, p.sh. mbi legjislacionin përkatës për fillimin e një biznesi, si të zhvillohet një plan biznesi dhe çfarë BSS financiare dhe jofinanciare janë të disponueshme. Mbështetja e mëtejshme për NVM-të përfshin lehtësimin e pjesëmarrjes në panairet kombëtare dhe ndërkombëtare, identifikimin e tregjeve të reja, partnerëve të eksportit, trajnimeve dhe nevojave të certifikimit të produkteve dhe mbështetjes përmes projekteve të ndryshme me donatorë.

Përveç informacionit, AIDA ofron mbështetje financiare për bizneset. Megjithatë, kërkesa deri më tani ka qenë mjaft e ulët. Në periudhën 6-vjeçare nga viti 2014 deri në vitin 2019, 373 SME kanë marrë grante nga fondet e AIDA-s me një shumë totale prej 264 milionë lekësh. Sipas indeksit të politikave të SME-ve, SME-të i perceptojnë si frenuese procedurat e aplikimit për fondet e AIDA-s. Përveç kësaj, grantet e ofruara përmes këtyre fondeve janë relativisht të vogla. Kjo duket se i pengon më tej aplikantët e mundshëm nga kalimi i procesit të gjatë të aplikimit. Si pjesë e aplikimit, SME-të duhet të takohen personalisht me stafin e AIDA-s në zyrën e vendosur në Tiranë. Kjo raportohet të jetë një pengesë për SME-të në rajone të tjera dhe faktor në hezitimin e tyre për të aplikuar për shërbimet financiare të AIDA-s. Nën tri zonat e ndërhyrjes së BIDS-it 2021–2027 ka disa masa, si p.sh.:

- Programi i strukturuar për shërbimin e mëtejshëm të kujdesit, kohët e fundit, roli i kujdesit të mëtejshëm është forcuar në të gjithë globin, në kuadrin e ndërprerjes serioze të zinxhirëve të vlerave ndërkombëtare, flukseve të tregtisë dhe investimeve të shkaktuara nga pandemia COVID-19. Megjithatë, kujdesi i mëtejshëm ofron një potencial premtues, që shkon përtej krizës aktuale. Konsiderohet si një mënyrë me kosto efektive për të kursyer investimet, për të siguruar riinvestim dhe për të rritur ndikimin në zhvillim. Koordinimi dhe bashkëpunimi ndërorganizativ konsiderohet si faktor kyç për sukses. Ekziston një gamë e gjerë institucionesh që ofrojnë shërbime mbështetëse për investitorët ose që luajnë një rol të rëndësishëm në ofrimin e këtyre shërbimeve (p.sh. BDHTI-ja, dhomat e tregtisë, shoqatat, bashkitë). Shërbimet e mëtejshme të kujdesit do të zgjerohen, duke ndjekur një qasje bashkëpunuese për të shmangur dyfishimin dhe konfuzionin midis investitorëve ekzistues. Theks i veçantë do t'i kushtohet forcimit të lidhjeve midis pushtetit qendror dhe bashkive nëpërmjet memorandumeve të bashkëpunimit që do të lidhen me AIDA-n dhe bashkitë.
- Promovimi/lehtësimi sistematik i investimeve të shënjestruara.
- Forcimi i ekosistemit të *start-up*-eve, duke njohur kontributin e konsiderueshëm të bizneseve të reja për një ekonomi më të orientuar nga inovacioni dhe njohuri, ky veprim fokusohet në zhvillimin e një mjedisi të favorshëm sipërmarrës, të lidhur ngushtë me projektligjin për mbështetjen dhe zhvillimin e bizneseve inovative, dhe inovacioni dhe programi i BE-së për inovacion. Theks i veçantë do t'u kushtohet grave sipërmarrëse dhe bizneseve fillestare, që ofrojnë zgjidhje ose produkte/shërbime digjitale, që kontribuojnë në zhvillimin e një ekonomie të gjelbër dhe rrethore. Veprimet prioritare do të trajtojnë gjithashtu masat rregullatore që lehtësojnë themelimin e bizneseve fillestare dhe pasqyrojnë rëndësinë e mbrojtjes së të drejtave të pronësisë industriale dhe intelektuale. Ngritja e kapaciteteve, duke adresuar ekosistemin fillestar dhe inovacionin: masat e personalizuara të ngritjes së kapaciteteve do të synimi *start-ups,* si dhe do të mbështesin organizatat (si inkubatorët, përshpejtuesit dhe iniciativat e institucioneve të arsimit të lartë), duke i ndihmuar ata të përmirësojnë dhe zgjerojnë shërbimet e tyre. Masat e mëtejshme synojnë diversifikimin e strukturës dhe shërbimeve mbështetëse për fillestarët, si dhe tërheqjen e lojtarëve të rinj publikë dhe privatë (p.sh., nga diaspora) në ekosistem.
- Përmirësimi i aksesit në financa: Ndërtimi i skemave ekzistuese/të mbështetura nga donatorët, p.sh. nën inovacionin e BE-së, ky komponent parashikon futjen e instrumenteve të mëtejshme financimi, që plotësojnë dhënien e granteve për bizneset fillestare dhe organizatat mbështetëse. Kjo përfshin, ndër të tjera, zhvillimin e një rrjeti engjëjsh biznesi dhe kuadrin ligjor për financimin nga turma.
- Programi i aftësive të sipërmarrjes për SME-të etj. Ky program do të përdorë në mënyrë specifike sinergjitë me veprime të tjera prioritare, si vlerësimi periodik i nevojave për trajnim dhe programi i

zhvillimit të fuqisë punëtore. Vlerësimi i nevojave për trajnim do të ndihmojë në përshtatjen e shërbimeve mbështetëse të biznesit me nevojat e NVM-ve, sektorit të tyre, fazës së zhvillimit dhe përvojës së tregut. Gjithashtu, ky veprim plotëson zhvillimin e aftësive të punonjësve përmes programit të zhvillimit të fuqisë punëtore.

- Një nga KPI-të në fushën e "zhvillimit të NVM-ve, sipërmarrjes dhe inovacionit" është rritja e vlerësimit në indeksin e politikave të NVM-ve (Shërbimet mbështetëse për SME-të) nga 3.6 në 4.4.

4.2 Përmirësimi i transparencës në miratimin dhe zbatimin e legjislacionit, veçanërisht duke siguruar një konsultim efektiv në kohë të bizneseve dhe partnerëve socialë mbi legjislacionin e ri që ndikon në veprimtarinë e tyre

Për të përmirësuar transparencën në miratimin dhe zbatimin e legjislacionit ne plotësojmë disa forma të konsultimit publik të dërguara nga Kryeministri të quajtura "Raportet e Konsultimeve Publike", të cilat përmbajnë të gjitha informacionet në lidhje me metodat e konsultimit publik, palët e interesuara të përfshira, deklaratën e komenteve të marra me komente arsyetuese. marrë/refuzuar, kohëzgjatja e konsultimit. Ky raport më pas publikohet në faqen zyrtare të konsultimit publik: https://konsultimipublik.gov.al/Konsultime/Detaje/355.

4.3 Hartoni dhe konsultoni një strategji gjithëpërfshirëse për të trajtuar dhe mbikëqyrur të gjitha aspektet e informalitetit, me një plan veprimi me baselines, duke përfshirë objektiva të qartë dhe të matshëm dhe për të vendosur një monitorim të rregullt të bazuar në ecurinë e zbatimit dhe rezultateve të tij

Gjatë periudhës 2022–2024, përpjekjet e Administratës Tatimore Shqiptare për të luftuar informalitetin do të përqendrohen në:

1. Kriteret e reja dhe të përmirësuara të riskut për identifikimin e tatimpaguesve në mospërmbushje të detyrimeve tatimore (tatimpaguesit me rritje të të ardhurave, por ulje të detyrimit TVSH; tatimpaguesit që nuk deklarojnë shpenzimet për faturat e energjisë elektrike; tatimpaguesit me paga të nëndeklaruara për punonjësit e tyre – të identifikuara duke krahasuar të dhënat disavjeçare).
2. Trajtimi i evazionit fiskal, mashtrimit fiskal dhe informalitetit, duke përdorur në kohë reale mbikëqyrjen e transaksioneve financiare midis tatimpaguesve, sipas sistemit të sapozbatuar të fiskalizimit (sistemi i monitorimit dhe mbikëqyrjes së veprimtarive tregtare të tatimpaguesve nga autoritetet tatimore shqiptare). Ky sistem do të sjellë më shumë raportime transaksionesh me para në dorë dhe do të reduktojë transaksionet e fshehura pa para, me kontroll më të mirë të sistemit fiskal. Do të ndihmojë, gjithashtu, efikasitetin në raportimin fiskal, duke mbledhur më shumë të dhëna nga tatimpaguesit dhe duke parambushur deklaratën e TVSH-së me këto të dhëna.
3. Detektimi i të ardhurave globale të padeklaruara nga tatimpaguesit dhe individët, nëpërmjet shkëmbimit të parë automatik të informacionit mbi llogaritë financiare në vitin 2021 e në vijim, sipas standardit të përbashkët të raportimit të OECD-së.
4. Integrimi dhe përdorimi i të dhënave nga palët e treta në *Data Warehouse* të administratës tatimore, {autoritetet kombëtare të shërbimeve (uji, elektriciteti), regjistrimi i automjeteve, bashkitë etj.} Duke marrë në konsideratë hendekun e TVSH-së, si dhe mospërputhjet e të dhënave, mbledhjen e të dhënave dhe administrimin e mire të tyre, ndërtimi i një *Data Warehouse* (si një nga rekomandimet e FMN-së) me të dhëna të centralizuara, të menaxhuara nga vetëm një burim, bëhet një hap i madh përpara në lidhje me luftën kundër informalitetit.
5. Ndërtimi i Regjistrit të Aseteve të Tatimpaguesve (te tundshme dhe të patundshme), me qëllim vlerësimin real të pasurive të tatimpaguesve, duke ndërtuar një sistem për verifikimin dhe ndjekjen e të ardhurave të tatimpaguesve, kontrollin e plotë të pagesave të bëra mbi taksat e pasurisë. Ky proces do të kalojë nëpër 3 faza: a) krijimi i një regjistri asetesh me atributet përkatëse; b; shkëmbimi i të dhënave me *web-service*; c) analiza e të dhënave me raportet BI.
6. Hartimi dhe zbatimi i një programi përmbushjeje për individët më të pasur[1].
7. Fuqizimi i sistemit dhe përdorimi i të dhënave në procesin e vendimmarrjes, në lidhje me individët e pasur.
8. Përdorimi i qasjes së integruar për zbatimin e strategjisë së përmbushjes së individëve të pasur.
9. Zbatimi i planit sektorial të turizmit.
10. Analiza dhe zbatimi i rregullave të riskut për monitorimin e tatimpaguesve, në kuadrin e ndryshimit

[1] Bazuar në rekomandimin e FMN-së, përkufizimi aktual i individit më të pasur për mjedisin shqiptar është çdo individ me të ardhura vjetore bruto mbi 125 milionë lekë ose me vlerë të akumuluar pasurie mbi 1 miliardë lekë.

të pragut të TVSH-së në 10 milionë lekë.

11. Zbatimi i planit sektorial të informalitetit në tregun e punës në 4 komponentët e tij.

Të gjitha këto aktivitete përshkruhen më hollësisht në seksionin *Masa e Reformës 06: Forcimi i luftës kundër informalitetit*.

Administrata tatimore ka marrë në mënyrë të vazhdueshme masa në luftën ndaj informalitetit gjatë periudhës së vitit 2021.

Janë ndërmarrë hapa konkretë në dërgimin e letrave të personalizuara, në bazë të kritereve të riskut të miratuara në komitetin e përmbushjes për evidentimin e tatimpaguesve për deklarimin e pagës reale.

Konkretisht janë dërguar 3883 letra të personalizuara për tatimpaguesit për deklarimin e pagës reale.

Nga monitorimi i kryer për reagimin e këtyre tatimpaguesve është vënë re se kemi një rritje me 2% të numrit të punonjësve dhe me të njëjtën normë të vendeve të punës.

Nga të dhënat e fundit që disponojmë, kemi

- 665,327 punonjës;
- 705,738 numri i vendeve të punës;

Për periudhën janar–nëntor 2021, kontributet shoqërore dhe shëndetësore janë në vlerën 99,121,021,923 lekë:

- rreth 59.000 tatimpagues aktivë të fiskalizuar dhe që prej datës 1 janar të këtij viti;
- 88.609 tatimpagues ose 73% e totalit të tatimpaguesve aktivë janë pajisur me certifikatë fiskalizimi;
- rreth 55 698 biznese aktive janë të pajisura me llogari bankare (sipas ligjit për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë).

Të ardhurat tatimore neto për 11-mujorin e 2021 llogariten në vlerën 129,920,719 ALL, duke shënuar një rritje prej 4% në krahasim me gjithë vitin 2020.

Periudha	Nr. i punonjësve	Nr. i vendeve të punës	Kontributet shoqërore dhe shëndetësore në total
Janar–nëntor 2021	665,327	705,738	108,132,023,916 lekë

Nëpërmjet planeve sektoriale administrata tatimore synon të identifikojë sektorë me risk në ekonomi dhe të hartojë plane për të luftuar informalitetin në fushat që kanë ndikim më të madh në ekonomi, si: nëndeklarimin e pagës reale apo mosdeklarim korrekt të numrit të punonjësve. Kjo do të bëhet nëpërmjet të dhënave që disponon administrata tatimore nga sistemet informatike tatimore, duke evidentuar ata tatimpagues që më parë kanë pasur një historik mospërmbushjeje të detyrimeve tatimore. Administrata tatimore synon përmirësimin e kuadrit bashkëpunues ndërinstitucional dhe sigurimin e planeve operacionale për të identifikuar punonjësit informale, duke u mbështetur në një strategji të qartë. Përgjegjësia për trajtimin e punës së padeklaruar është e përhapur në disa institucione: mospërmbushja e detyrimeve tatimore me administratën tatimore, trajtimi i kontributeve me ISSH-në dhe respektimi i Kodit të Punës nga Inspektorati i Punës. Në vijimësi parashikojmë të forcojmë bashkëpunimin me njësinë e riskut të Zyrës së Punës, për të garantuar një marrëveshje bashkëpunimi, me qëllim shkëmbimin e informacionit ndërmjet këtyre institucioneve. Administrata tatimore disponon të dhëna më cilësore për tatimpaguesit, që më pas do t'i vendosen në dispozicion dhe zyrës së punës apo dhe Institutit të Sigurimeve Shoqërore.

Disa nga hapat konkretë që do të ndiqen në vijimësi, në përputhje me Strategjinë Afatmesme të të Ardhurave, kanë të bëjnë me:

1. Zvogëlimi i hendekut të përmbushjes së TVSH-së. Indikatorët në zvogëlimin e hendekut të TVSH-së konsiderohen: rritja e të ardhurave nga TVSH-ja për të gjithë sektorët e ekonomisë; rritja e të ardhurave nga TVSH-ja në sektorin e ndërtimit; koha e kontrollit të subjekteve; rritja e qarkullimit në baza mujore të sektorëve me risk.
2. Reduktimi i punës së padeklaruar dhe nëndeklarimet e ekonomisë *cash*.
3. Tatimi i çdo pasurie të pajustifikuar brenda dhe jashtë vendit.
4. Zvogëlimi i shmangies së taksave.
5. Reduktimi i kostove të përmbushjes dhe rritja e sigurisë tatimore dhe besimit të administrate tatimore.
6. Motivimi i qytetarëve për të qenë pjesë e luftës ndaj informalitetit.

Gjithashtu, administrata tatimore ka implementuar një proces madhor, si fiskalizimi, që do të ndikojë pozitivisht në uljen e informalitetit. Në zbatim të Drejtorisë së Menaxhimit të Riskut do të jenë 101 kritere

risku, që parashikojmë të zbatohen plotësisht brenda vitit 2024, me përditësimin e modulit të riskut, në bazë të projektit të fiskalizimit dhe të ndërthurjes me modulin aktual.

Si fillim, në vijimësi të punës së Drejtorisë së Menaxhimit të Riskut do të aplikohen vetëm 44 kritere.

Rekomandimi 5

5.1 Krijimi i një task-force ndërministrore, që përfshin ministritë përkatëse, agjencitë e tyre dhe palët e interesuara për të zhvilluar një plan zbatimi të garancisë rinore.

Ngritja i grupit ndërinstitucional u vonua disi, për shkak të krijimit të qeverisë së re të Shqipërisë, e cila ndodhi në mesin e shtatorit 2021. Bazuar në strukturën e re të ministrive kemi një listë paraprake të ministrive, agjencive dhe organizatave të shoqërisë civile të propozuara. Urdhri i Kryeministrit është përgatitur dhe është dërguar për miratim. Urdhri cakton koordinatorin kombëtar të GR-së (zëvendësministrin përgjegjës për punësimin dhe aftësitë), krijimin e grupit ndërinstitucional dhe të Grupit teknik.

Grupi ndërinstitucional do të kryesohet nga ministri i Financave dhe Ekonomisë dhe do të përbëhet nga institucione të ndryshme publike që do të jenë pjesë e skemës GR. Pjesë e grupit do të jenë edhe përfaqësues të partnerëve socialë dhe organizatave rinore. Grupi teknik i punës do të kryesohet nga zëvendësministri i Financave dhe Ekonomisë, përgjegjës për punësimin dhe aftësitë dhe do të përbëhet nga përfaqësues të institucioneve dhe agjencive të ndryshme, që lidhen me futjen e skemës GR në Shqipëri.

5.2 Zhvilloni mjete të institucionalizuara për monitorimin e nevojave për aftësi në tregun e punës, me synimin për të ofruar udhëzime përkatëse për karrierë dhe për të përmirësuar ofertën e kurseve profesionale afatshkurtra, në përputhje me rrethanat

Analiza e nevojave për aftësi në nivel kombëtar është paraparë të bëhet në bashkëpunim me UNDP-në.

AKSHP-ja, në bashkëpunim me partnerët ka iniciuar kryerjen e analizave rajonale të tregut të punës, me qëllim planifikimin më të mirë të nevojave për trajnim dhe edukim. Ky instrument u pilotua në qarkun e Elbasanit dhe së shpejti do të bëhet prezantimi i gjetjeve. Ndërkohë, SNA-ja në nivel kombëtar ende nuk është realizuar. Megjithatë, bashkëpunimi me UNDP-në ka filluar për realizimin e tij. Është planifikuar të zhvillohen takime me aktorë, që kanë punuar më parë për këtë instrument. Qëllimi është që metodologjia të kthehet në një instrument të qëndrueshëm.

Në fund të vitit 2020, projekti *Skills 4 Jobs* organizoi 14 *workshop*-e në 5 qarqe të vendit, ku operon projekti, përkatësisht në Vlorë, Lezhë, Elbasan, Shkodër dhe Berat. Qëllimi i këtyre tabelave të dialogut është të lehtësojë procesin e përshtatjes së programeve të studimit dhe trajnimit në rajon me nevojat e bizneseve lokale për punëtorë të kualifikuar. Objektivat e platformës së dialogut janë:

- rritja e ndërgjegjësimit dhe shkëmbimit të informacionit në nivel qarku ndërmjet ofruesve të arsimit dhe trajnimit, dhe kompanive;
- lehtësimi i koordinimit dhe i partneritetit ndërmjet ofruesve dhe punëdhënësve, në mënyrë që të zvogëlohet hendeku midis arsimit dhe trajnimit, dhe botës së punës;
- promovimi i zhvillimit të aftësive të kërkuara nga tregu i punës nëpërmjet një procesi të vlerësimit të nevojave pjesëmarrëse dhe gjithëpërfshirëse;
- lehtësimi i përfshirjes më të madhe dhe në rritje të kompanive si në identifikimin e aftësive ashtu edhe në ofrimin e aftësive të reja.

Ajo që u vu re dhe u konkludua nga këto takime ishte gatishmëria e lartë e sektorit privat për t'u përfshirë në krijimin e kurseve apo profileve afatshkurtra të prezantuara dhe pjesëmarrjen/frekuentimin e tyre nga punonjës të sektorëve përkatës.

Ekziston, gjithashtu, një interes i shtuar i sektorit privat për të intensifikuar bashkëpunimin me institucionet e AFP-së dhe aktorë të tjerë; si rezultat i kërkesës në rritje për specialistë të kualifikuar në të gjitha industritë.

Gatishmëria e sektorit privat për bashkëpunim në përmirësimin e kurrikulave dhe moduleve mësimore, si dhe realizimin e praktikës profesionale, me qëllim përshtatjen e aftësive me kërkesat e industrisë.

AKKSH-ja, në bashkëpunim me partnerët, ka iniciuar kryerjen e analizave rajonale të tregut të punës për të planifikuar nevoja më të qarta për trajnim dhe trajnim. Ky instrument u pilotua në qarkun e Elbasanit dhe së shpejti do të bëhet prezantimi i gjetjeve.

5.3 Incentivoni lidhjen midis bizneseve inovative dhe akademisë në draftin e ardhshëm të Strategjisë për Zhvillimin e Biznesit dhe Investimeve 2021–2027, duke përfshirë objektiva të qartë për të rritur financimin e shkencës dhe kërkimit dhe duke krijuar kushtet për zhvillimin e inkubatorëve të biznesit

Inteligjenca e shkathtësive të shëndosha përbën pikën fillestare për sigurimin e arsimit dhe trajnimit modern dhe dinamik, në përputhje me nevojat e tregut të punës dhe të shoqërisë. Bazuar në inteligjencën e aftësive të përditësuara dhe lehtësisht të arritshme, nevojiten përpjekje të bashkërenduara për të ndihmuar NVM-të në identifikimin e masave të duhura për përmirësimin e aftësive, për të zgjeruar ofertën e trajnimit dhe për të mbajtur ritmin me shpejtësinë e tranzicioneve dhe ndryshimeve në mjedisin konkurrues. Kjo përfshin forcimin e lidhjeve midis aktorëve të heliksit të trefishtë, që eksplorojnë qasje të reja për të promovuar bashkëpunimin dhe lëvizshmërinë midis akademisë dhe bizneseve.

Në këtë kontekst, ekziston, gjithashtu, një potencial premtues për të përdorur sinergjitë në ndërlidhjen midis zhvillimit të kapitalit njerëzor dhe fushave të tjera të ndërhyrjes së BIDS-it, në veçanti, në lidhje me:

- fokusimi në nevojat e investitorëve dhe përfshirja e tyre në masat e zhvillimit të aftësive në të njëjtën kohë;
- nxitja e të mësuarit sipërmarrës dhe intensifikimi i bashkëpunimit ndërmjet sipërmarrësve dhe institucioneve arsimore dhe trajnuese;
- integrimi i zhvillimit të aftësive në masat dhe iniciativat mbështetëse të SME-ve për të përmirësuar zinxhirët premtues të vlerës në kontekstin e specializimit të zgjuar.

Në fushën e ndërhyrjes 3: Zhvillimi i kapitalit njerëzor, ka disa parime të Strategjisë së BE-së për SME-të dhe agjendën e aftësive, BIDS-i i ri thekson rëndësinë strategjike të aftësive nga këndvështrimi i SME-ve, investitorëve të mëdhenj dhe *start-up*-eve. Aftësitë dhe të mësuarit gjatë gjithë jetës janë thelbësore për rritjen e qëndrueshme, produktivitetin dhe inovacionin. Është vetëm me aftësitë e duhura që Shqipëria mund të forcojë pozicionin e saj në konkurrencën ndërkombëtare dhe zinxhirët e vlerave dhe të ketë një rinisje të qëndrueshme ekonomike pas krizës pandemike.

Aktivitetet arsimore dhe të aftësive të larta janë thelbësore për t'i bërë firmat lokale të përshtatshme për transformimin e zinxhirëve ndërkombëtarë të vlerës, tregun e vetëm, për specializim të zgjuar, si dhe transformimin e gjelbër dhe digjital. Në një mjedis konkurrues në ndryshim, *start-up*-et dhe SME-të e krijuara njësoj shpesh sfidohen nga mungesa e punonjësve të kualifikuar. Ata shpesh nuk kanë të njëjtat burime si kompanitë e mëdha për të investuar në trajnimin e punonjësve të tyre. Në të njëjtën kohë, baza e aftësive ka fituar rëndësi në vendimet për vendndodhjen e investitorëve, veçanërisht nga grupe synimi të drejtuara nga njohuritë dhe teknologjia.

Duke marrë parasysh situatën aktuale dhe burimet e disponueshme është e rëndësishme që të kontekstualizohet zhvillimi i kapitalit njerëzor me fushat e tjera të ndërhyrjes dhe të ndiqet një qasje e ardhshme dhe bashkëpunuese. Në këtë sfond, veprimet në këtë fushë ndërhyrje synojnë arritjen e objektivave dhe rezultateve të pritshëm të paraqitur në figurën më poshtë, duke plotësuar dhe specifikuar qëllimin e përcaktuar të politikës.

Ka disa masa që synojnë të forcojnë lidhjet midis bizneseve inovative dhe akademisë, si:

- Skema e mbështetjes së zhvillimit të kapitalit njerëzor bashkëpunues.

Si ndërmarrjet fillestare, ashtu edhe SME-të e themeluara, shpesh përballen me sfida nga mungesa e punonjësve të kualifikuar, veçanërisht për pozicionet e punës që kërkojnë më shumë aftësi. Bazuar në rekomandimet e planit të veprimit *Triple Helix*, do të zhvillohet një skemë mbështetëse për të rritur bazën e aftësive dhe për të eksploruar qasje të reja për të nxitur bashkëpunimin dhe lëvizshmërinë midis shkollës dhe bizneseve. Kjo skemë do të ofrojë mbështetje financiare për punësimin e talenteve të kualifikuar në projektet e K&ZH-së dhe të inovacionit dhe mbulon dy komponentë:

1. Asistencë për SME-të që punësojnë të sapodiplomuar të talentuar për projekte inovacioni

Të diplomuarit e rinj do të punësohen për detyra në fushat e kërkimit dhe të zhvillimit, zhvillimit/përmirësimit të produkteve dhe proceseve të reja, kërkimit të tregut dhe zhvillimit të biznesit për inovacion.

Kjo skemë do të sigurojë një subvencion pagash, që mbulon deri në 50% të pagës bruto, si dhe shpenzimet e lidhura me punën (si trajnimi) të një të sapodiplomuari nga një SME për të punuar në projekte inovacioni, për një periudhë deri në 18 muaj. Kontributi maksimal do të arrijë vlerën 4500 euro për person (25 euro në muaj). Të diplomuarit e rinj do të punësohen sërish dhe për herë të parë. I sapodiplomuari nuk duhet të zëvendësojë një pozicion ekzistues.

2. Asistencë për studentët e doktoraturës

Programi i doktoraturës industriale është një projekt kërkimor i fokusuar në industri dhe program PHD dhe zhvillohet së bashku nga një kompani e sektorit privat, një kandidat për PHD industriale dhe një institucion i arsimit të lartë. Kandidati për PHD industrial është i punësuar në kompani dhe në të njëjtën

kohë është i regjistruar në institucionet e arsimit të lartë dhe punon për të njëjtin projekt në të dyja vendet. Kandidati duhet të kalojë gjithë kohën e punës duke punuar në projekt dhe nuk mund të kryejë detyra të tjera. Kompania merr një subvencion pagash për pagesën e kandidatit (p.sh. deri në 50% të pagës së plotë bruto/deri në 200 euro në muaj) për një periudhë deri në tre vjet. Institucionet e arsimit të lartë marrin një subvencion për mbikëqyrje, pajisje dhe shpenzime të tjera për arsimimin e kandidatit (p.sh. deri në 2,000 euro për vitin).

Nevojitet një pozicion shtesë i AIDA-s për të koordinuar skemën, e cila do të mbështesë edhe zbatimin e skemës së mbështetjes së sipërmarrjes (aksioni prioritar 2.1). Gjatë fazës së hartimit do të vlerësohet nëse është i nevojshëm ndryshimi i kuadrit ligjor/rregullator. Bazuar në vlerësimet e përvojës së fituar, programi mund të zgjerohet në grupe të targetuara të tjera. Hartimi dhe zbatimi i një skeme mbështetëse që përfshin:

- asistencë për SME-të që punësojnë të sapodiplomuar për projekte inovative;
- asistencë për doktorantët që janë të punësuar në NVM dhe njëkohësisht të regjistruar në institucionet e arsimit të lartë, duke punuar në një projekt të përbashkët kërkimor;
- programet "Inovacioni dhe ekselenca në prodhimtari" dhe "Inovacioni dhe ekselenca në IT" do të krijohen për trajnime në inovacion, disenjim, marketing, kërkim dhe zhvillim, duke mbuluar 100% të kostove të trajnimit. Kostot do të rimbursohen 50% direkt dhe 50% si taksë e zbritshme, 2 herë për kompanitë ku përfituesi është i punësuar. Kostot e këtyre programeve do të përcaktohen gjatë përgatitjes së politikave fiskale të mëposhtme;
- programi i zhvillimit të fuqisë punëtore për dhe me NVM-të dhe investitorët.

Atraktiviteti i një destinacioni për investitorët varet shumë nga cilësia e bazës së aftësive, veçanërisht nga këndvështrimi i grupeve Synimi, bizneset e të cilëve mbështeten në njohuri dhe teknologji. Në të njëjtën kohë, përvoja ndërkombëtare tregon se investitorët dhe bizneset vendëse mund të japin një kontribut të çmuar në forcimin e kapitalit njerëzor. Programi i zhvillimit të fuqisë punëtore do të përfshijë investitorët dhe SME-të në rritjen e bazës së aftësive, si dhe rritjen e aftësive digjitale për fuqinë punëtore të SME-ve, përmes trajnimeve të specializuara për TIK-un. Ky program përfshin tre komponentë të cilët do të zbatohen në faza.

Komponenti 1: Integrimi i zhvillimit të aftësive në shërbimet e kujdesit pasues

Ky komponent mund të bazohet në aktivitetet ekzistuese dhe mbështetjen e donatorëve, siç është asistenca nga GIZ-i për shërbime të mëtejshme të kujdesit. Fokusi do të jetë në lehtësimin e shërbimeve, duke mbështetur investitorët për të zhvilluar fuqinë e tyre punëtore përmes, strukturave dhe programeve ekzistuese, si trajnimi në vendin e punës dhe trajnimi profesional. Këto shërbime do të zhvillohen përmes bashkëpunimit të ngushtë ndërmjet AIDA-s, APK-së, qendrave të formimit profesional dhe palëve të tjera të interesuara si dhomat dhe organizatat. Ndarja e detyrave do të detajohet përmes MM-së.

Ky program do të koordinohet nga AIDA dhe do të zbatohet në bashkëpunim të ngushtë me ofruesit privatë të trajnimit dhe shoqatat e biznesit. Fokusi kryesor do të jetë në kurset afatshkurtra, p.sh., kurse trajnimi afatshkurtër për saldator. Kurset e trajnimit do të mbahen nga ekspertë të jashtëm/trajnerë privatë. Për të siguruar zbatimin efektiv, AIDA do të ketë nevojë për burime dhe kapacitete të përshtatshme. Koordinimi i programit të zhvillimit të fuqisë punëtore do të bëhet nga sektori i trajnimit.

Komponenti 2: Studimi i fizibilitetit për një qendër zhvillimi aftësish sipas modelit PPP

Përvoja ndërkombëtare tregon se ka një potencial premtues për bashkëpunim me investitorët, në lidhje me masat e zhvillimit të aftësive. Zbatimi i modeleve PPP për zhvillimin e aftësive konsiderohet një opsion strategjik premtues. Në përputhje me praktikat e mira ndërkombëtare, siç është Qendra e Zhvillimit të Aftësive "Penang", do të kryhet një studim gjithëpërfshirës fizibiliteti për të vlerësuar fizibilitetin e një qendre trajnimi pilot bazuar në modelin PPP dhe në bashkëpunim me investitorët në një TEDA. Kjo qendër mund të përfshijë programe trajnimi të orientuara nga synimi, si kurse teknike, trajnime profesionale ose diploma *Bachelor*.

Si KPI në Strategji është paraparë:

- rritja e përqindjes së punësimeve në profesionet që kërkojnë njohuri të thelluara nga 17.5% në 19.5%;
- rritja e vlerësimit në indeksin e politikave për SME-të (aftësitë sipërmarrëse) nga 4.3 në 3.9.

Rekomandimi 6

6.1 Kryeni një vlerësim të mjaftueshmërisë së përfitimeve sipas skemës së "Ndihmës ekonomike", duke marrë parasysh të dhënat e anketës për "Statistikat e të ardhurave dhe Kushtet e jetesës", në këndvështrimin e rregullimit në mënyrë sistematike

Qeveria ndërmori masa të përkohshme për të zgjeruar përshtatshmërinë e përfitimeve të ndihmës sociale dhe për të zgjeruar mbështetjen me të ardhura gjatë pandemisë. Buxheti i skemës së ndihmës ekonomike për vitin 2021 u rrit dhe si rrjedhojë, përfitimet u dyfishuan në gjashtëmujorin e parë të vitit 2021. Lidhur më këtë, është përgatitur tashmë udhërrëfyesi me hapat dhe afatet kohore për rregullimin e përfitimeve të ndihmës ekonomike dhe vendosjen e një mekanizmi transparent për rishikime të rregullta vjetore, në përputhje me kushtin e asistencës makrofinanciare të BE-së për Shqipërinë.

Për hapat e udhërrëfyesit angazhimi është të zbatohen deri në fund të vitit 2024. Hapat përfshijnë analizën e performancës së përfitimit të ndihmës ekonomike, duke përdorur të dhënat më të fundit të HBS-së dhe EU-SILC dhe krijimin e një mekanizmi për të përditësuar rregullisht nivelin e përfitimeve të ndihmës ekonomike.

6.2 Ndërtoni kapacitete në qeverisjen vendore për të aplikuar për mbështetje nga fondi social dhe për të planifikuar, administruar dhe ofruar shërbime të kujdesit social

Bazuar në Programin e Shërbimit Social Shtetëror nr. 1756 prot., datë 6.11.2019, "Për bashkërendimin e procesit të hartimit dhe zbatimit të planeve sociale", gjatë vitit 2021, 37 bashki të qarqeve Kukës, Dibër, Berat, Gjirokastër, Fier, Korçë dhe Vlorë janë asistuar në hartimin dhe zbatimin e planeve sociale. Së pari, ndihma u fokusua në identifikimin e çështjeve kyçe që duhet të adresohen, për të vlerësuar nevojat për shërbime sociale dhe së dyti, u prezantua një model për hartimin e një plani social, bazuar në prioritetet e secilës bashki, përkthyer në projekte konkrete për aplikim në Fondin social. Për vitin 2021, ndër të tjera, 3 shërbime emergjente për viktimat e dhunës në familje (Gjirokastër, Berat, Kukës); 1 shërbim ditor për fëmijët me aftësi të kufizuara (Lushnjë) dhe 2 qendra fëmijë dhe familje, në reformën De-I (Korçë dhe Vlorë) u mbështetën nga fondi social. Deri më tani, 60 nga 61 bashki kanë miratuar planet e kujdesit social.

6.3 Ridisenjoni politikën e mbulimit, duke përfshirë mjekësinë ambulatore, për të reduktuar nevojën e paplotësuar për kujdes mjekësor dhe vështirësi financiare, veçanërisht midis personave me aftësi të kufizuara dhe sëmundjeve kronike, familjeve të varfra, njerëzve të moshës 65 vjeç e lart dhe minoriteteve

Në përputhje me vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 489, datë 30.7.2021, "Për miratimin e listës së rimbursimit të barnave (LRB)", lista e re përmban 1,191 barna, nga të cilat numri i përgjithshëm i përfituesve, përfshirë fëmijët, të moshuarit dhe pacientët me sëmundje kronike, është 400,000. Lista e re e barnave të rimbursueshme përfshin barna që trajtojnë dhe mbajnë nën kontroll diagnozat më të zakonshme të sëmundjeve kronike, si: diabeti, HTA-ja dhe sëmundjet kardiovaskulare. Për më tepër, në listë përfshihen edhe barna inovative për trajtimin e patologjive të ndryshme të kancerit si kanceri i mushkërive, kanceri i gjirit si dhe pacientët post-COVID.

Pacientët me dializë janë një tjetër grup që janë përfitues të drejtpërdrejtë të LRB-së nëpërmjet rimbursimit të barnave të reja që janë shtuar në listë. Buxheti i përgjithshëm i LRB-së së re është 107 milionë USD.

Për më tepër personat me aftësi të kufizuara përfitojnë paketën sanitare në para. Rreth 6500 persona me aftësi të kufizuara përfitojnë një pagesë mujore për paketën sanitare në shumën 160 USD.

3. Kuadri makroekonomik

3.1 Zhvillimet e fundit ekonomike

Ekonomia shqiptare u rekuperua ndjeshëm gjatë vitit 2021 pas recesionit të vitit të kaluar. Efektet e pandemisë ishin të përmbajtura si pasojë e mbështetjes nga politikat fiskale e monetare ndërthurur me masat rregullative. Rritja ekonomike rezultoi më e fortë dhe me bazë më të gjerë krahasuar me atë që pritej. Rritja reale e PBB-së ishte 11.9% gjatë gjysmës së parë të vitit 2021 nxitur nga investimet, konsumi familjar dhe eksportet. Efekti bazë dhe ndikimi nga prodhimi i energjisë elektrike ishin, gjithashtu, faktorë të veçantë që dhanë kontribut në rritje. Rikuperimi i kërkesës ka qenë i shpejtë dhe prodhimi ka tejkaluar nivelet e paratërmetit dhe të parapandemisë. Edhe tregu i punës paraqet përmirësim me rritje të punësimit dhe rënie të normës së papunësisë në nivelin 11.6% në tremujorin e dytë të vitit.

Grafik 3.1.1 Rritja vjetore e PBB-së 2010–2021-GJ1



Burimi: INSTAT *gjysmëpërfundimtare **paraprake

Nga pikëpamja e prodhimit, rritja ekonomike është nxitur nga sektori prodhues i cili dha një kontribut 5.6 pikë përqindje gjatë gjysmës së parë të vitit. Aktiviteti ka qenë veçanërisht intensiv në ndërtim, industri nxjerrëse dhe përpunuese, si dhe në prodhimin e energjisë elektrike. Në rastin e fundit, kushtet e favorshme atmosferike kanë qenë faktor mbështetës. Nga ana tjetër, rënie vjetore është vënë re në rastin e bujqësisë. *Sektori i shërbimeve* dha një kontribut prej 5.4 pikë përqindjeje në rritje gjatë gjysmës së parë të vitit 2021. Performanca e mirë ishte më e dukshme gjatë tremujorit të dytë të vitit, kur kufizimet ndaj lëvizjes së udhëtarëve u lehtësuan dhe sektori turistik u rigjallërua.

Tabelë 3.1.1 Kontributet në rritjen e PBB-së, sipas prodhimit dhe kërkesës agregate në pikë përqindjeje

	2020**				**2021****	
	T1	**T2**	**T3**	**T4**	**T1**	**T2**
sipas sektorëve:						
Bujqësi, pyje, peshkim	0.5	0.5	-0.2	-0.5	0.0	-0.2
Industri, energji, ujë	-0.9	-1.9	-0.5	0.0	2.6	4.2
Ndërtim	-1.3	-0.9	0.9	1.8	1.2	3.4
Shërbime	-0.8	-7.0	-2.7	1.5	1.9	8.8
Taksa minus subvencione	-0.2	-2.0	-1.1	-0.4	-0.2	1.7
Rritja reale e PBB-së (vjetore në %)	-2.8	-11.3	-3.5	2.4	5.5	17.9
sipas shpenzimeve:						
Konsumi privat	1.4	-6.8	-2.6	1.4	1.3	8.5
Konsumi publik	0.2	0.1	-0.1	0.5	0.8	1.3
Investimet	-3.2	-2.6	1.2	2.7	3.7	7.8
Eksporte neto	1.5	1.2	-0.2	1.3	-2.7	4.1
Inventarë dhe mospërputhje statistikore	-2.8	-3.0	-1.7	-3.5	2.5	-4.0
Rritja reale e PBB-së (vjetore në %)	-2.8	-11.3	-3.5	2.4	5.5	17.9

Burimi: INSTAT *gjysmëpërfundimtare **paraprake

Nga pikëpamja e kërkesës agregate, kërkesa e brendshme dha kontributet kryesore me një rritje vjetore prej 10.1% gjatë gjysmës së parë 2021. Ndikimi themelor ka buruar nga investimet, me një kontribut 5.7 pikë përqindje. Si investimet private, ashtu edhe ato publike janë zgjeruar, me ndikim edhe nga shpenzimet për rindërtimin nga tërmeti në rastin e dytë. Të dhënat indirekte sugjerojnë një impakt të fortë nga ndërtesat rezidenciale. Nga ana tjetër, rikuperimi i konsumit privat ishte më i ngadaltë, me një rritje prej 1.4% në tremujorin e parë të vitit. Por, me lehtësimin e masave kufizuese në tremujorin e dytë, konsumi i popullatës u rrit me 9.8%. Edhe konsumi publik u zgjerua ndjeshëm në saje të rritjes së shpenzimeve të lidhura me pandeminë (sikurse shëndetësia dhe shërbime të tjera mbështetëse). Së fundi, rikuperimi global gjalleroi edhe kërkesën për mallra vendëse, eksportet e të cilave dhanë ndikim në rritjen e PBB-së. Në rastin e shërbimeve, zhvillimet ishin ende të dobëta gjatë tremujorit të parë të vitit kur kufizimet në

lëvizjen ndërkombëtare ishin ende të pranishme. Tremujori i dytë shënoi pikën e kthesës, kur masat u lehtësuan ndjeshëm dhe turizmi u zgjerua në mënyrë të qenësishme. Kontributi i eksporteve neto rezultoi pozitiv gjatë tremujorit të dytë – me 4.1 pikë përqindjeje.

Grafik 3.1.2 Rritja reale e PBB-së ,sipas qasjes së shpenzimeve



Burimi: INSTAT *gjysmëpërfundimtare **paraprake

Tregu i punës shfaqi rezistencë përballë goditjes nga pandemia, mbështetur edhe nga masat qeveritare. Pas rikuperimit të kërkesës, edhe punësimi kaloi në trend përmirësues gjatë tremujorit të dytë 2021, me një rritje prej 1.1%. Rritja e punësimit rezultoi me bazë të gjerë mbështetur nga industria, ndërtimi dhe shërbimet. Norma e papunësisë ra në 11.6%, nga 11.9% në 2020T2. Gjatë vitit të kaluar, rritja e normës së papunësisë nuk ishte proporcionale me rënien e punësimit. Masat qeveritare, ndërthurur me pritshmëritë se situata do të ishte e përkohshme, nxitën shumë individë të regjistroheshin si "inaktivë", duke mos u përfshirë kështu në shifrën e papunësisë.

Pavarësisht përmirësimeve të fundit, punësimi mbetet ende nën nivelin e parapandemisë dhe norma e papunësisë mbi atë të parapandemisë. Rënia e punësimit në bujqësi po pengon rikuperimin e plotë në tregun e punës.

Rritja e pagës qëndroi në norma pozitive (si në terma nominalë ashtu edhe realë) pavarësisht pandemisë. Paga mesatare u rrit me 5.0% gjatë gjysmës së parë 2021, me norma më të larta rritjeje në sektorin publik (7.4%) krahasuar me atë privat (4.1%). Kjo ecuri ka reflektuar edhe rritjen e pagës minimale me 15.1% në janar 2021. Axhustuar për inflacion, rritja reale e pagës, për gjysmën e parë të vitit 2021, llogaritet në 3.6%.

Grafik 3.1.3 Treguesit e tregut të punës



Burimi: INSTAT

Gjysma e parë e vitit 2021, reflektoi një rënie të shpejtë të *kostos së punës për njësi*[2] (5.0% mesatarisht në ndryshim vjetor). Kjo përbën një përmbysje krahasuar me vitin e kaluar, kur kostoja e punës për njësi u rrit me 1.1% mesatarisht. Ecuria e *produktivitetit të punës* ishte faktori përcaktues në ecurinë e kostos së punës për njësi për të dyja vitet. Gjatë vitit 2020, produktiviteti u pakësua ndjeshëm me frenimin e aktivitetit ekonomik. Gjatë gjysmës së parë të vitit 2021, rikuperimi i ekonomisë nxiti edhe rritjen e produktivitetit.

Norma mesatare e inflacionit për 10 muajt e parë të vitit 2021 rezultoi 1.8%, duke qëndruar 0.2 pikë përqindjeje më lart se ajo e një vit më parë. Inflacioni u rrit mjaft shpejt nga tremujori i parë në tremujorin e dytë, përkatësisht nga 0.9% në 1.8%, ndërkohë që u vu re një rritje më graduale gjatë katër muajve të fundit, në rreth 2.4%. Rritja e inflacionit i atribuohet kryesisht: i. rritjes së çmimit të naftës, duke reflektuar ndër faktorët e tjerë edhe efektin bazë nga rënia e vitit të kaluar. Megjithatë, në tetor 2021, vlera e indeksit të nëngrupit tejkaloi nivelin e para pandemisë, duke sugjeruar shuarjen e efektit bazë; ii. rritja e çmimeve të ushqimeve të papërpunuara, kryesisht perimeve; iii. rritja e çmimeve të ushqimeve të përpunuara – veçanërisht që prej muajit qershor – e nxitur kryesisht nga çmimet e larta të ushqimeve bazë në tregun ndërkombëtar.

Lehtësimi i masave anti-COVID zgjeroi kërkesën për shërbime, duke ushtruar presione në rritje në çmimet e tyre. Presione të tilla janë parë në rritjen e inflacionit të kategorisë "Argëtim dhe kulturë" – veçanërisht gjatë tremujorit të tretë – të "Hotele, bare dhe restorante", gjatë muajve të verës dhe të "Transportit", "Shëndetësisë" dhe "Komunikimit", duke filluar nga tremujori i dytë.

Nga pikëpamja e faktorëve makroekonomikë, rritja e inflacionit është ndikuar kryesisht nga rritja e shpejtë e çmimeve të energjisë dhe ushqimeve në tregun ndërkombëtar. Gjithashtu, edhe presionet e brendshme inflacioniste kanë ardhur në rritje pas rimëkëmbjes së kërkesës. Inflacioni bazë rezultoi 1.5% gjatë 10 muajve të parë të 2021-shit, pak më i lartë se vitin e kaluar. Kontributi i tij në inflacionin total ishte relativisht i qëndrueshëm në rreth 1.1 pikë përqindjeje. Gjatë dy muajve të fundit, në shtator dhe tetor, ai u përshpejtua përkatësisht në 1.8% dhe 2.2%. Rritja në muajt e fundit vjen si pasojë e inflacionit më të lartë të shërbimeve dhe inflacionit më të lartë të nëngrupit "Bukë dhe drithëra" – i cili ka një peshë të konsiderueshme në shportën e IÇK-së, por luhatshmëri të ulët të çmimeve ndër vite.

Pavarësisht ngushtimit të hendekut të prodhimit dhe rritjes së presioneve të brendshme inflacioniste, këto të fundit janë ende të frenuara, siç dëshmohet nga nivelet e ulëta të inflacionit bazë. Rritja e punësimit dhe e pagave është ende e pamjaftueshme, ndërkohë që pritjet inflacioniste mbeten nën objektivin e inflacionit. Pritjet për inflacionin nga agjentët financiarë dhe bizneset gjatë 10 muajve të parë të 2021 janë pothuajse të pandryshuara nga viti i kaluar. Ndërkohë, pritjet e konsumatorëve për inflacionin janë rritur disi, veçanërisht në dy muajt e fundit.

Në terma afatshkurtër, presionet e huaja inflacioniste pritet të mbeten të larta, të nxitura kryesisht nga çmimet e larta të lëndëve të para në tregjet ndërkombëtare. Këto të fundit pritet të normalizohen gjatë vitit

[2] Treguesit përafrues për produktivitetin e punës, koston e punës për njësi dhe kompensimin e punonjësve llogariten nga Banka e Shqipërisë, bazuar në seritë e "Statistikave afatshkurtra", kur sektori bujqësor nuk është i përfshirë (INSTAT-i, botimi i fundit 2021 T2).

2022. Nga ana tjetër, presionet e brendshme inflacioniste pritet të rriten gradualisht pas zgjerimit të vazhdueshëm të ekonomisë shqiptare dhe ngushtimit të hendekut negativ të prodhimit. Kjo do të çojë në një rritje më dinamike të pagave dhe të kostove të tjera të prodhimit, duke nxitur konvergimin gradual të inflacionit drejt objektivit deri në fund të vitit 2022.

Grafik 3.1.4 Inflacioni sipas IÇK-së dhe kontributet nga kategoritë kryesore



Burimi: INSTAT dhe llogaritjet e BSH-së

Deficiti korrent është ngushtuar me 9.6% në terma vjetorë gjatë gjysmës së parë 2021, pasi u zgjerua ndjeshëm vitin e kaluar. Zhvillimet pozitive në rastin e shërbimeve dhe të të ardhurave dytësore dhanë ndikimet kryesore.

Borxhi i jashtëm bruto i Shqipërisë ra në 62.6% të PBB-së në tremujorin e dytë 2021, nga 68.1% që ishte një vit më parë. Përveç efektit të lidhur me rritjen e PBB-së, rënia e raportit pasqyron edhe pakësimin e borxhit të qeverisë së përgjithshme lidhur kjo me ripagesat e detyrimeve të mëparshme të Eurobondit, kryesisht në tremujorin e fundit 2020.

Tregu valutor ka funksionuar në kushte normale tregtimi dhe parametra rreziku, duke reflektuar balancën e ofertës dhe kërkesës për valutë në treg. Në tremujorin e parë të vitit monedha vendëse ka qenë e qëndrueshme kundrejt euros me një mesatare prej 123.5 lekësh/eurosh. Në muajt në vijim, hapja e ekonomisë pas lehtësimit të kufizimeve të COVID-19 dhe rigjallërimi i aktivitetit turistik, përcaktuan një mbiçmim gradual të lekut, duke kulmuar në tremujorin e tretë me mesatarisht 1.7% në terma vjetorë. Aktualisht, kursi i këmbimit të lekut ndaj euros luhatet lehtas mbi 121 lekë/euro. Mbiçmimi i lekut në terma efektivë ka ardhur duke u ngadalësuar në muajin tetor (me 2.8%), pasi arriti kulmin në muajin prill (me 5.4%). Kjo sjellje ka reflektuar nënçmimin e lekut kundrejt monedhës kineze dhe ngadalësimin e mbiçmimit të tij ndaj lirës turke.

Tregjet financiare janë karakterizuar nga kushte të përshtatshme likuiditeti, prime të përmbajtura të rrezikut dhe norma të ulëta interesi. Politika monetare stimuluese e Bankës së Shqipërisë i ka ofruar ekonomisë kushte të favorshme monetare, ndërkohë që bilancet e shëndetshme të bankave kanë mundësuar transmetimin e duhur të këtij stimuli në treg. Normat e interesit të kredisë për bizneset kanë mbetur pranë niveleve të tyre të vitit 2020 (mesatarisht 5.6%) dhe pak më të ulëta për individët (mesatarisht 6.1%), duke reflektuar kushtet mbështetëse të financimit për investime dhe konsum. Kërkesa më e lartë për financim e qeverisë këtë vit është përthithur lehtësisht nga tregu, pa frenuar rritjen e kredisë ndaj sektorit privat dhe pa shtuar presione. *Yield*-et e letrave të borxhit të qeverisë janë luhatur afër mesatares së tyre të vitit 2020.

Kushtet e favorshme financiare po kontribuojnë në rritjen e kredisë. Kredia për ekonominë ka qenë e rëndësishme në sigurimin e likuiditetit të bizneseve dhe ka ndihmuar në financimin e rritjes së investimeve dhe konsumit privat. Kredia për sektorin privat u rrit në 8.1% në tetor nga 6.7% në vitin 2020. Rimëkëmbja e aktivitetit ekonomik dhe përmirësimi i besimit kanë nxitur kërkesën për kredi, veçanërisht nga individët. Në të njëjtën kohë bankat kanë lehtësuar standardet e kreditimit. Rritja e kredisë është

mbështetur nga zgjerimi i kredisë në lekë e cila shënoi rritje 10.5% deri në muajin tetor. Politika monetare lehtësuese ka mbështetur zgjerimin e vazhdueshëm të këtij portofoli, ku pesha e kredisë në lekë arriti 50.2% ose 1 pikë përqindjeje më e lartë se mesatarja e vitit 2020. Gjatë vitit 2021 edhe kreditimi në valutë ka regjistruar rritje, duke shënuar norma rritjeje prej 6%. Kredia në valutë u kanalizua kryesisht në tregti, turizëm dhe ndërtim. Kredia për individë, gjithashtu, është rritur këtë vit, duke reflektuar rigjallërimin e konsumit dhe kërkesën e individëve për blerje banesash. Zgjerimi i kësaj kredie shënoi 10.4% deri në muajin tetor, duke qenë afërsisht sa dyfishi i rritjes së një viti më parë.

Grafik 3.1.5 Treguesit monetarë



Stoku total i depozitave në sistemin bankar ka vijuar të zgjerohet në vitin 2021, duke reflektuar kursime më të larta të familjeve dhe likuiditet të bollshëm të biznesit. Deri në muajin tetor depozitat janë rritur me 8.2%, duke treguar një ritëm rritjeje 2.4 pikë përqindjeje më të lartë se vitin e kaluar. Shtimi i depozitave është mbështetur si nga ato në lekë ashtu edhe nga ato në valutë duke u rritur respektivisht me 7.7% dhe 8.7%. Rritja e depozitave në valutë reflekton flukse më të larta nga jashtë, si dhe oferta promocionale të bankave gjatë verës. Në terma të strukturës kohore, depozitat pa afat vazhdojnë të dominojnë stokun e depozitave. Pesha e tyre ndaj totalit ka arritur në 55%. Gjithsesi, ndryshe nga një vit më parë, duke nisur prej verës depozitat me afat kanë rritur kontributin e tyre në rritjen totale.

3.2. Skenari makroekonomik afatmesëm

Sektori real

Performanca e vitit 2020, për sa i përket aktivitetit ekonomik dhe financave publike, ishte një nga vitet më të vështira në tri dekada. Shqipëria, përveç tronditjes nga pandemia që vuajti e gjithë bota, pak përpara saj u godit edhe nga tërmeti, e sigurisht efekti negativ në ekonomi është i amplifikuar.

Viti 2020 regjistroi një reçesion prej 4 përqindësh, i cili, për shkak të pandemisë arriti kulmin e tkurrjes së PBB-së në tremujorin e dytë në rreth -11.3 për qind, por duke shfaqur shenja rimëkëmbje e duke u rikthyer përsëri në terren pozitiv në tremujorin e fundit të vitit e në vijim. Megjithatë, pavarësisht ndikimit të rëndë që kanë pasur të dyja goditjet, në saje të përgjigjeve relativisht mjaft të mira të politikës ekonomike (fiskale dhe monetare), të dhënat e fundit statistikore të disponueshme tregojnë se situata e përgjithshme në mbyllje të vitit 2020 ishte konsiderueshëm më pak e rëndë nga sa pritej në fillim të pandemisë, duke filluar nga rreth -6 për qind (parashikim i Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë) në rreth -8 për qind nga institucionet e tjera vendëse dhe ndërkombëtare. Gjatë gjithë vitit 2021, rimarrja e ritmit të ekonomisë është konsiderueshëm më e shpejtë se sa pritshmëritë fillestare. Deri më tani, duket se fondamentet kryesore ekonomike dhe financiare dhe stabiliteti i përgjithshëm makroekonomik i vendit i kanë rezistuar relativisht mirë këtyre goditjeve.

Gjatë nëntëmujorit të parë të vitit 2021, ekonomia e vendit shfaqi shenja mjaft inkurajuese, duke shënuar rikuperim të shpejtë të aktivitetit ekonomik. Produkti i Brendshëm Bruto (PBB) për nëntëmujorin e parë të vitit 2021 është rritur me rreth 10.38 për qind krahasuar me të njëjtën periudhë të vitit 2020, sipas vlerësimit të fundit të disponueshëm nga INSTAT-i. Kjo rimëkëmbje mbështetet në një gamë të gjerë faktorësh dhe është e pranishme, pothuajse në të gjithë sektorët e ekonomisë. Ulja (pothuajse heqja) e kufizimeve pas rënies së infeksioneve, ku një rol kyç ka luajtur edhe procesi i vaksinimit, rritja e besimit të biznesit dhe konsumatorit, përmirësimi i ekonomive partnere, si dhe politikat mbështetëse fiskale dhe monetare, kanë ndikuar në rritjen e konsumit, investimeve publike dhe private, si dhe eksporteve. Sektori i prodhimit, ashtu edhe ai i shërbimeve, kanë përfituar nga këto zhvillime, duke siguruar rimëkëmbje për biznesin dhe punësimin, si dhe duke krijuar premisa të mira për perspektivën afatmesme.

Sipas optikës së kërkesës agregate, në nëntëmujorin e parë të vitit 2021 vlerësohet se të gjithë komponentët e kërkesës agregate kanë shënuar rritje të fortë, duke reflektuar kështu rifillimin e aktivitetit normal ekonomik, pas pasojave të forta nga bllokimi gjatë vitit 2020. Rritja gjatë nëntëmujorit të parë të vitit 2021 u gjenerua kryesisht nga kërkesa e brendshme, si nga konsumi privat ashtu edhe nga investimet. Ndërkohë, kërkesa e huaj neto vlerësohet të ketë edhe një efekt neto të moderuar ndaj rritjes totale. Kjo, për shkak se kontributi i lartë pozitiv nga rritja e fortë e eksporteve të mallrave dhe shërbimeve u balancua pothuajse tërësisht nga kontributi negativ gjithashtu i forte nga rritja e importeve të mallrave dhe shërbimeve.

Në këtë kontekst, konsumi final, që është komponenti më i madh i ekonomisë, është ulur me rreth 1.9 për qind në terma realë gjatë vitit 2020 dhe konsumi final i popullatës është ulur me rreth 2.3 për qind. Ndërkohë, për nëntëmujorin e parë të vitit 2021, konsumi final shënoi rritje të ndjeshme prej 5.67 përqindësh, ndërsa konsumi privat shënoi rritje prej 5.30 përqindësh krahasuar me të njëjtën periudhë të një viti më parë.

Formimi i kapitalit fiks bruto (investimet totale) u ul me rreth 2 për qind në terma realë gjatë vitit 2020, ndërsa për nëntëmujorin e parë të 2021-shit kjo normë u rrit me rreth 20.15 për qind. Kjo rritje i atribuohet në një masë të konsiderueshme rritjes së investimeve publike gjatë kësaj periudhe, përfshirë ato për rindërtimin pas tërmetit.

Për sa i përket perspektivës ekonomike, duke supozuar se evolucioni i pandemisë do të qëndrojë brenda disa kufijve të moderuar gjatë muajve në vijim, dhe së dyti, duke marrë parasysh se fondamentet kryesore ekonomike dhe financiare nuk kanë pësuar asnjë goditje problematike dhe normalisht pritet të vazhdojnë të mbeten relativisht solide, për periudhën afatmesme në vazhdim parashikohet që rritja të kthehet në nivele pozitive relativisht të qëndrueshme.

Rritja për vitin 2021 pritet të jetë rreth 8.7%, një rikthim shumë i fortë, dukshëm mbi parashikimin fillestar. Në periudhën afatmesme rritja parashikohet të konvergojë dhe të stabilizohet rreth nivelit 4%, që është edhe niveli i vlerësuar i rritjes potenciale nga Ministria e Financave dhe Ekonomisë. Më konkretisht, rritja ekonomike afatmesme e Shqipërisë parashikohet në 4.1% në vitin 2022, 4.2% në 2023 dhe 3.9% në 2024.

Në periudhën afatmesme, rritja pritet të gjenerohet kryesisht nga kërkesa e brendshme, si nga konsumi ashtu edhe nga investimet. Ndërkohë, kërkesa e huaj neto (eksport-import) pritet të ketë një efekt neto të moderuar. Kredimarrja për konsum parashikohet të nxitet edhe nga përmirësimi i pritshëm i kushteve financiare të individëve, ashtu edhe nga lehtësimi i pritshëm i standardeve të huadhënies nga sistemi bankar në periudhën afatmesme, pas kapërcimit të efektit negativ nga goditja e pandemisë.

Ndërsa rritja graduale e investimeve pritet të nxitet nga një shfrytëzim më i intensifikuar i kapaciteteve ekzistuese të prodhimit, si dhe nga përshpejtimi i aktivitetit ekonomik gjatë periudhës së parashikuar dhe perceptimi i përmirësuar i biznesit mbi perspektivën ekonomike afatmesme e afatgjatë. Njëkohësisht edhe përmirësimi i kushteve financiare dhe lehtësimit të standardeve të huadhënies priten të jenë një faktor i rëndësishëm incentivues i investimeve private në afatin e mesëm. Indeksi i ndjeshmërisë ekonomike ka shënuar rritje të konsiderueshme në nëntëmujorin e parë të vitit 2021, pas përmirësimeve të ndjeshme pozitive në tremujorët e mëparshëm. Pra duket një trend i qartë, i fortë, rritës i besimit dhe i perceptimit të agjentëve ekonomikë për ecurinë e aktivitetit ekonomik së fundmi, si dhe pritshmëritë e tyre në të ardhmen e afërt.

Më konkretisht, konsumi final për periudhën afatmesme (2022–2024) parashikohet të rritet në terma realë me mesatarisht 2.9% në vit, duke kontribuar me mesatarisht 2.6 pikë përqindjeje në vit në rritjen totale. Ndërsa investimet parashikohen të rriten në terma realë me mesatarisht 3.2% në vit, me një kontribut mesatar në rritjen totale prej 0.8 pikë përqindjeje në vit.

Kërkesa e huaj neto pritet të ketë një kontribut pozitiv të moderuar në periudhën afatmesme. Eksportet e mallrave, të cilat zakonisht kanë pasur performancë të mirë në vite, priten të vazhdojnë këtë trend pozitiv dhe të ruajnë ritmet e kaluara. Eksportet e shërbimeve, veçanërisht shërbimet turistike, priten gjithashtu të rikthejnë performancën pozitive në periudhën afatmesme dhe të jenë elementi kryesor për të kompensuar kontributin negativ të ardhur prej rritjes së importeve. Eksportet e mallrave dhe të shërbimeve, për periudhën 2022–2024, parashikohen të rriten me mesatarisht 5.8% në vit në terma realë, me një kontribut mesatar pozitiv prej 1.6 pikë përqindjeje në vit. Ndërsa importet e mallrave dhe të shërbimeve, për periudhën afatmesme, parashikohen të zgjerohen me 2.4%, me një kontribut mesatar negativ në rritjen totale me rreth -1.0 pikë përqindje në vit. Për rrjedhojë, kërkesa e huaj neto pritet të ketë

një kontribut lehtësisht pozitiv në rritjen e përgjithshme me një mesatare prej 0.7 pikë përqindjeje në vit.

Grafik 3.2.1 Rritja reale (në %)



Grafik 3.2.2 Kontributet në rritje (në p.p.) sipas komponentëve të kërkesës



Burimi: Ministria e Financave dhe Ekonomisë (2021)

Tabelë 3.2.1 Rritja reale (në të majtë, në %) dhe kontributet në rritje (në të djathtë, në p.p.), sipas komponentëve të kërkesës

	2018	2019	2020	2021 Vler.	2022 Para.	2023 Para.	2024 Para.	2018	2019	2020	2021 Vler.	2022 Para.	2023 Para.	2024 Para.
Konsumi Final (a+b+c)	**2.9**	**3.1**	**-1.9**	**4.1**	**3.1**	**3.1**	**2.5**	**2.6**	**2.8**	**-1.7**	**3.9**	**2.8**	**2.8**	**2.3**
Konsumi Final i Popullatës	3.1	3.2	-2.3	5.5	2.8	3.6	2.7	2.4	2.5	-1.8	4.5	2.3	2.9	2.2
Konsumi Final i Administratës Publike	0.7	2.9	1.6	-6.1	4.7	-1.0	0.9	0.1	0.3	0.2	-0.7	0.5	-0.1	0.1
Konsumi Individual	-0.8	4.2	2.9	-7.7	4.3	-1.2	1.0	0.0	0.2	0.2	-0.4	0.2	-0.1	0.0
Konsumi Kolektiv	2.0	1.8	0.4	-4.7	5.0	-0.8	0.9	0.1	0.1	0.0	-0.3	0.3	0.0	0.0
Konsumi i Institucioneve Jo-	17.0	2.0	-12.0	11.2	2.0	2.0	1.5	0.1	0.0	-0.1	0.1	0.0	0.0	0.0
Formimi Bruto i Kapitalit Fiks	**2.3**	**-3.7**	**-2.0**	**19.9**	**2.5**	**2.4**	**4.9**	**0.6**	**-0.9**	**-0.5**	**4.6**	**0.6**	**0.6**	**1.2**
Publik	9.2	0.0	7.1	28.4	-9.8	-12.9	6.5	0.5	0.0	0.4	2.0	-0.8	-0.9	0.4
nga e cila qeveria qendrore	14.6	-4.4	35.6	26.5	-11.4	-15.8	6.9	0.6	-0.2	1.6	1.7	-0.8	-1.0	0.3
Privat	0.4	-4.8	-5.0	16.1	8.6	8.7	4.3	0.1	-0.9	-0.8	2.6	1.4	1.5	0.8
Kërkesa e brendshme (1+2)	**2.8**	**1.7**	**-1.9**	**7.2**	**2.9**	**2.9**	**3.0**	**3.2**	**1.9**	**-2.2**	**8.5**	**3.4**	**3.4**	**3.4**
Eksporti neto^ (a-b)	**-1.0**	**1.5**	**1.8**	**-1.8**	**-4.8**	**-6.7**	**-3.8**	**0.2**	**-0.2**	**-0.2**	**0.3**	**0.7**	**0.8**	**0.5**
Eksportet e mallrave e shërbimeve	4.0	2.6	-28.2	31.7	4.7	6.5	6.1	1.3	0.8	-8.8	7.3	1.3	1.8	1.7
Eksportet e mallrave	13.8	-8.5	-16.0	48.2	0.7	8.8	9.0	1.0	-0.7	-1.1	2.9	0.1	0.7	0.8
Eksportet e shërbimeve	1.3	6.2	-31.5	25.8	6.4	5.6	4.9	0.3	1.5	-7.8	4.4	1.3	1.1	1.0
Importet e mallrave e shërbimeve	2.4	2.3	-19.1	18.7	1.6	2.4	3.2	1.1	1.0	-8.6	7.1	0.7	1.0	1.3
Importet e mallrave	1.8	1.7	-5.8	21.4	1.4	2.7	3.3	0.6	0.5	-1.7	6.2	0.5	0.9	1.1
Importet e shërbimeve	3.5	3.4	-44.3	10.0	2.1	1.4	2.6	0.5	0.53	-6.9	0.9	0.2	0.1	0.2
Ndryshimet e gjendjeve	**-89.6**	**2738.4**	**0.0**	**0.0**	**0.0**	**0.0**	**0.0**	**-0.4**	**1.3**	**0.0**	**0.0**	**0**	**0**	**0**
Mospërputhje statistikore	**-98.0**	**146.0**	**133**	**0**	**0.0**	**0.0**	**0.0**	**1.1**	**-0.9**	**-1.5**	**0.0**	**0**	**0**	**0**
PRODHIM I BRËNDSHËM BRUTO (3+4+5)	**4.1**	**2.1**	**-4.0**	**8.7**	**4.1**	**4.2**	**3.9**	**4.0**	**2.1**	**-4.0**	**8.7**	**4.1**	**4.2**	**3.9**

Burimi: Ministria e Financave dhe Ekonomisë (2021)

Nga pikëpamja e ofertës agregate pritet që të gjithë sektorët kryesorë të vazhdojnë rreth të njëjtit trend të mesatares së tyre historike, pasi efektet e goditjeve do të zbehen. Specifikisht, bujqësia pritet të rritet mesatarisht me 2.1% në vit në terma realë përgjatë periudhës 2022–2024, me një kontribut mesatar prej 0.4 pikë përqindjeje në vit; Industria me një mesatare vjetore prej 4.4%, me një kontribut mesatar prej 0.5 pikë përqindjeje në vit; Ndërtimi me 3.0%, me një kontribut mesatar prej 0.3 pikë përqindjeje në vit dhe Shërbimet me një mesatare 4.9% në vit, me kontributin më të lartë në rritje në saje të peshës së tyre, me një mesatare prej 2.4 pikë përqindjeje në vit.

Grafik 3.2.3 Rritja reale (në %)



Grafik 3.2.4 Kontributet në rritje (në p.p.), sipas komponentëve të ofertës



Burimi: Ministria e Financave dhe Ekonomisë (2021)

Tabelë 3.2.2 Rritja reale (në të majtë, në %) dhe kontributet në rritje (në të djathtë, në p.p.), sipas komponentëve të ofertës

	2018	2019	2020	2021 Vler.	2022 Para.	2023 Para.	2024 Para.	2018	2019	2020	2021 Vler.	2022 Para.	2023 Para.	2024 Para.
Bujqësia, pyjet dhe peshkimi	1.5	0.6	0.3	-0.1	1.8	2.1	2.3	0.3	0.1	0.1	0.0	0.3	0.4	0.4
Industria nxjerrëse	7.6	11.1	-26.8	21.7	5.3	5.7	4.5	0.2	0.3	-0.8	0.4	0.1	0.1	0.1
Industria përpunuese	6.3	5.5	-5.7	17.2	4.1	5.2	4.1	0.4	0.3	-0.4	1.1	0.3	0.3	0.3
Energjia elektrike, gazi, avulli dhe furnizimi me ajër të kor	57.6	-11.5	12.7	32.2	3.2	4.3	3.9	1.1	-0.3	0.3	0.6	0.1	0.1	0.1
Furnizimi me ujë, aktivitetet e trajtimit dhe menaxhimit të r	12.0	7.8	2.1	4.7	3.5	3.4	2.9	0.1	0.1	0.0	0.0	0.0	0.0	0.0
Ndërtimi	2.5	-2.2	1.9	16.7	2.1	3.3	3.5	0.2	-0.2	0.2	1.5	0.2	0.3	0.3
Tregtia me shumicë dhe me pakicë; riparimi i automjeteve	2.9	2.5	-8.0	8.1	5.2	4.9	4.9	0.3	0.3	-0.9	0.9	0.5	0.5	0.5
Transporti dhe magazinimi	2.7	1.2	-16.4	23.2	9.3	5.9	5.0	0.1	0.0	-0.5	0.7	0.3	0.2	0.2
Akomodimi dhe shërbimi ushqimor	14.3	14.1	-24.5	28.2	14.3	9.8	7.0	0.3	0.3	-0.7	0.6	0.3	0.3	0.2
Informacioni dhe komunikacioni	-4.5	3.9	-2.0	5.6	2.9	3.5	3.0	-0.1	0.1	-0.1	0.2	0.1	0.1	0.1
Aktivitete financiare dhe të sigurimit	2.9	13.6	-4.4	15.6	4.4	5.3	4.3	0.1	0.3	-0.1	0.3	0.1	0.1	0.1
Aktivitete të pasurive të paluajtshme	-0.1	4.6	7.0	6.9	3.2	3.4	3.4	0.0	0.3	0.4	0.4	0.2	0.2	0.2
Aktivitete profesionale, shkencore dhe teknike	12.2	1.1	-9.9	3.1	5.2	4.7	4.6	0.4	0.0	-0.3	0.1	0.1	0.1	0.1
Shërbime administrative dhe mbështetëse	1.7	10.3	-9.6	2.9	4.5	5.2	4.6	0.1	0.3	-0.3	0.1	0.1	0.2	0.2
Administrim publik dhe mbrojtja; sigurimi social i detyrues	0.1	2.1	0.9	4.1	4.5	4.4	4.1	0.0	0.1	0.0	0.2	0.2	0.2	0.2
Arsimimi	0.1	2.7	0.2	4.3	4.6	4.6	4.7	0.0	0.1	0.0	0.2	0.2	0.2	0.2
Shëndetësia dhe aktivitete të punës sociale	6.0	9.0	7.5	4.9	4.8	5.1	3.7	0.2	0.3	0.2	0.2	0.2	0.2	0.1
Arte, argëtim dhe çlodhje	-0.2	-50.0	-6.6	11.1	5.2	4.9	4.9	0.0	-0.5	0.0	0.1	0.0	0.0	0.0
Aktivitete të tjera shërbimi;	8.4	9.8	-6.8	7.7	5.3	5.1	4.7	0.1	0.2	-0.1	0.1	0.1	0.1	0.1
Vlera e Shtuar Bruto me çmime bazë	**4.2**	**2.4**	**-3.4**	**8.7**	**4.1**	**4.2**	**3.9**	**3.6**	**2.1**	**-3.0**	**7.6**	**3.6**	**3.7**	**3.4**
Taksa neto mbi produktet	3.4	0.1	-7.7	8.8	4.1	4.3	3.9	0.4	0.0	-1.0	1.1	0.5	0.5	0.5
PBB ME ÇMIMET E TREGUT	**4.1**	**2.1**	**-4.0**	**8.7**	**4.1**	**4.2**	**3.9**	**4.1**	**2.1**	**-4.0**	**8.7**	**4.1**	**4.2**	**3.9**

Burimi: Ministria e Financave dhe Ekonomisë (2021)

Rritja ekonomike është shoqëruar me rritje të punësimit dhe ulje të shkallës së papunësisë. Si sektori i prodhimit, ashtu edhe ai i shërbimeve, kanë përfituar nga këto zhvillime, duke siguruar rimëkëmbje për biznesin dhe punësimin dhe duke krijuar premisa të mira për perspektivën afatmesme. Ndërsa viti 2020 rezultoi me një përkeqësim të lehtë të shkallës së papunësisë me një nivel mesatar për të gjithë vitin prej 12.2 përqindësh, nëntëmujori i parë i 2021 shënoi sërish një përkeqësim të lehtë të këtij treguesi në tremujorin e parë të vitit dhe më pas një rikuperim në tremujorin e dytë dhe të tretë. Referuar të dhënave statistikore, shkalla e papunësisë shënoi nivelin 12.6 për qind në tremujorin e parë dhe një përmirësim në 12.1 në tremujorin e dytë dhe në 11.6 në tremujorin e tretë. Norma mesatare e papunësisë për nëntëmujorin e parë të 2021 ishte 12.1 për qind, krahasuar me 12.3 për qind në nëntëmujorin e parë të 2020. Sa i përket numrit të të punësuarve për T3-2021, krahasuar me tremujorin paraardhës (TM2-2021),

ai është rritur me 2.13%. Ndërsa, krahasuar me të njëjtin tremujor të një viti më parë (TM3-2020), numri i të punësuarve është rritur lehtësisht me 0.21%.

Në përputhje me parashikimet afatmesme të rritjes, punësimi pritet të rritet me një mesatare prej 1.3% në vit gjatë periudhës 2022–2024. Shkalla më e lartë e pjesëmarrjes në forcat e punës do të jetë gjeneruesi kryesor i rritjes së ofertës së punës, ndërsa rritja e kërkesës për punë pritet të reflektojë pak a shumë të njëjtën strukturë të perspektivës së ofertës agregate të aktivitetit ekonomik. Rrjedhimisht pritet që shërbimet të kontribuojnë më shumë në rritjen e kërkesës për punë në krahasim me sektorët e tjerë të ekonomisë. Pavarësisht zgjerimit të pritshëm të punësimit në afatin e mesëm, sërish produktiviteti i përgjithshëm i punës pritet të ketë një përmirësim të lehtë gjatë kësaj periudhe. Papunësia pritet të vazhdojë rënien graduale, duke arritur në 8.9% në vitin 2024.

Grafik 3.2.5 Punësimi (rritja vjetore në %)



Grafik 3.2.6 Norma e papunësisë (në %)



Burimi: Ministria e Financave dhe Ekonomisë (2021)

Politika monetare dhe e kursit të këmbimit dhe inflacioni

Objektivi kryesor i Bankës së Shqipërisë, sipas mandatit të saj ligjor, është arritja dhe ruajtja e qëndrueshmërisë së çmimeve. Politika monetare operon nën një regjim inflacioni të shënjestruar, me objektivin të caktuar në 3.0% në afatin e mesëm. Instrumenti kryesor për arritjen e objektivit është norma e interesit e marrëveshjeve të anasjellta të riblerjes me afat maturimi një javor. Banka e Shqipërisë aplikon një regjim kursi këmbimi të lirë, ku vlera e kursit të këmbimit përcaktohet nga lëvizje të kërkesës dhe ofertës në tregun valutor. Banka ruan të drejtën të ndërhyjë në treg për arsye që lidhen me rregullimin e rezervës valutore, me anë të ankandeve, të cilat zhvillohen sipas një kalendari të publikuar.

Banka e Shqipërisë e rriti stimulin monetar në fillimin e krizës COVID-19, në muajin mars të vitit 2020, duke ulur normën e interesit me 50 pikë bazë, duke e çuar atë në 0.50%, ose niveli saj më i ulët historik, e duke i ofruar likuiditet të pakufizuar sistemit bankar në operacionet e tregut të hapur me frekuencë javore. Qëndrimi lehtësues i politikës monetare qëndroi i pandryshuar në vitin 2021. Sinjalizimi i bankës për të ardhmen tregon se stimuli monetar do të vijojë edhe në afatin e shkurtër e të mesëm, me normën bazë që do të qëndrojë nën nivelin e saj të ekuilibrit. Politika monetare ekspansioniste, së bashku me sinjalizimin e qartë e transparent për trajektoren e ardhshme të politikës monetare, kanë ndikuar në ruajtjen e qetësisë në tregjet financiare përgjatë tkurrjes ekonomike të vitit 2020 dhe kanë ndihmuar në uljen e paqartësive të agjentëve ekonomikë, në lidhje me perspektivën ekonomike.

Pas tkurrjes së vitit 2020, ekonomia është në një shteg rritjeje të shpejtë në të gjithë sektorët, si dhe komponentët e kërkesës në vitin 2021. Ekonomia është rritur mbi nivelin e para tërmetit dhe para pandemisë, dhe të dhënat e deritanishme nuk tregojnë për ndonjë efekt negativ afatgjatë mbi ekonominë nga këto goditje të forta. Me përmirësimin e kushteve ciklike, presionet e brendshme inflacioniste kanë vijuar të forcohen, të cilat së bashku e rritjen e çmimeve të mallrave në tregjet ndërkombëtare kanë nxitur rritjen e inflacionit në vend, i cili mbetet nën nivelin e shënjestruar prej 3%.

Skenari bazë i Bankës së Shqipërisë parashikon që ekonomia do të rritet ndjeshëm në vitin 2021, e ndihmuar nga stimuli makroekonomik dhe rritja e kërkesës së huaj, e do të zhvendoset në një trajektore rritëse pranë potencialit të saj. Si pasojë e përmirësimit të kushteve ciklike, presionet e brendshme do të forcohen edhe më tej, duke nxitur konvergimin e qëndrueshëm e inflacionit drejt shënjestrës nga viti 2022.

Trajektorja e inflacionit në afatin e shkurtër, do të pasqyrojë efektin e goditjeve të ofertës nga çmimet më të larta të tregjeve ndërkombëtare, të cilat do të rrisin kostot vendëse të prodhimit. Si rezultat, inflacioni total pritet të rritet ndjeshëm në afatin e shkurtër. Efekti i këtyre goditjeve të ofertës pritet të jetë i përkohshëm.

Balanca e rreziqeve duket e zhvendosur në kahun e sipërm në afatin e shkurtër dhe e balancuar në atë të mesëm. Nga njëra anë, një rritje më e shpejtë apo më e zgjatur në kohë e çmimeve në tregjet financiare dhe një ritëm i konsolidimit më i ngadaltë përbëjnë rreziqe të kahut të sipërm ndaj inflacionit. Nga ana tjetër, rimëkëmbja më e ngadaltë e ekonomisë botërore përbën rreziqet e kahut të poshtëm ndaj inflacionit.

Kombinimi aktual i politikave përfshin një stimul monetar dhe fiskal, të diktuar nga nevoja për të garantuar një rimëkëmbje ekonomike të shëndetshme. Ndërsa kjo rimëkëmbje vazhdon dhe aktiviteti ekonomik qëndron në një shteg rritjeje të shëndetshëm, këta stimuj do të nisin të tërhiqen gradualisht.

Kjo tërheqje do të kryhet në kohë, në një mënyrë të koordinuar dhe transparente, në mënyrë që të mos pengojë trajektoren qëndrueshme të rritje së pritur të ekonomisë në afatin e mesëm

Sektori i jashtëm dhe qëndrueshmëria afatmesme e tij

- Zhvillimet në bilancin e pagesave dhe tregtinë e mallrave

Deficiti korrent u ngushtua me 9.6% gjatë gjysmës së parë të vitit 2021, duke qëndruar në nivelin 7.7% ndaj PBB-së. Një vit më parë, raporti qëndronte në 9.9%. Ky përmirësim ka pasqyruar rikuperimin e kërkesës së brendshme dhe të huaj, e dukshme kjo në mënyrë të veçantë gjatë tremujorit të dytë të vitit, kur flukset e shërbimeve kaluan në ecuri përmirësuese. Në të vërtetë, rikuperimi filloi më herët për tregtinë e mallrave, teksa rritja e kërkesës së brendshme dhe të huaj zgjeroi nevojën për mallra, duke u shoqëruar me zgjerim të eksporteve dhe importeve. Nga ana tjetër, kufizimet ndaj lëvizjes kombëtare të udhëtarëve qëndruan në fuqi, duke penguar rikuperimin e flukseve të shërbimeve (veçanërisht të turizmit). Intensiteti më i lartë importues në mallra (krahasuar me eksportet), shkaktoi fillimisht një përkeqësim të bilancit tregtar. Në tremujorin e dytë 2021, kufizimet ndërkombëtare u lehtësuan dhe flukset e shërbimeve u zgjeruan ndjeshëm (nivel treshifror), duke kundërbalancuar zgjerimin e deficitit tregtar në mallra. Rritja e fluksit të shërbimeve ndërthurur me zgjerimin e remitancave nxiti edhe ngushtimin e deficitit të përgjithshëm korrent.

Mbiçmimi real i lekut është përshpejtuar në fillim të vitit 2021, duke arritur në 4.7% në prill, kryesisht si pasojë e mbiçmimit nominal. Në muajt pasues, mbiçmimi real është ngadalësuar ndjeshëm, duke arritur 0.3% në terma vjetorë në tetor. Diferenca në normë krahasuar me mbiçmimin nominal (që shënon 2.8% në terma vjetorë) lidhen me normat më të ulëta inflacioniste në vend krahasuar me vendet partnere.

Flukset tregtare në mallra janë rikuperuar përgjatë vitit 2021, pas goditjes që morën vitin e kaluar. Pothuaj të gjitha kategoritë kanë tejkaluar nivelet e parapandemisë, me përjashtim të "Tekstileve". Pas rënies së pësuar gjatë 2020, eksportet e kësaj kategorie kanë vazhduar të pakësohen edhe gjatë vitit 2021, si pasojë e performancës së dobët të sektorit të veshjeve dhe modës në Itali, importuesi kryesor i fasoneve shqiptarë. Për faktin që sektori në fjalë është ende pre e kufizimeve, edhe kërkesa e tij për importe ndikohet negativisht.

Grafik 3.2.7: Hapja tregtare, eksportet, importet dhe Investimet direkte neto si përqindje ndaj PBB-së



Grafik 3.2.8: Ndryshimet vjetore nominale dhe reale të kursit efektiv të këmbimit (%)



Burimi: Banka e Shqipërisë, INSTAT

Dekompozimi i eksporteve shqiptare, sipas përpjesëve konstante të tregut (PKT)[3], dëshmon se rënia e

[3] Shihni: http://go.worldbank.org/KQCHUD4JN0, për një diskutim mbi PKT-në.

eksporteve botërore ka qenë faktori kryesor pas ngushtimit të eksporteve shqiptare drejt vendeve të BE-15 gjatë vitit 2020. Pason konkurrueshmëria me disa ndikime të vogla negative nga struktura sipas kategorive. Në rastin e eksporteve drejt vendeve të CEFTA-s, rënia e eksporteve botërore ka qenë faktori kryesor, pasuar nga struktura sipas kategorive dhe shpërndarja e tregut. Nga ana tjetër, në këtë rast, konkurrueshmëria ka dhënë një ndikim pozitiv duke shërbyer si kundërbalancë.

Tabelë 3.2.3 Dekompozimi i eksporteve shqiptare sipas metodës PKT (milionë euro)

	2020	
	BE-15	**CEFTA**
Rritja e eksporteve botërore	-162.4	-41.0
Struktura sipas kategorive	-0.6	-6.7
Shpërndarja e tregut	26.2	-5.4
Konkurrueshmëria	-68.3	31.2
Total	-205.1	-22.0

Burimi: Banka e Shqipërisë, INSTAT, UN Comtrade

Suficiti i shërbimeve është rikuperuar pas goditjes së rëndë që përjetoi gjatë vitit 2020. Udhëtimet (turizmi) kanë qenë faktori kryesor. Lehtësimi i masave kufizuese ndaj lëvizjes ndërkombëtare, veçanërisht gjatë tremujorit të dytë 2021, nxitën flukset e shërbimeve. Si rezultat, eksportet e shërbimeve u rritën me 47.7% për gjysmën e parë 2021 dhe 165.5% për 2021T2. Importet e shërbimeve u zgjeruan me 27.2% dhe 122.1% respektivisht në gjysmën e parë dhe tremujorin e dytë 2021. Si rrjedhojë, suficiti i shërbimeve është rritur me 75.8% për gjysmën e parë 2021 dhe 221.5% në 2021T2. Statistikat e udhëtarëve sugjerojnë për rritje të përpjesës së të ardhurve nga Kosova. Pavarësisht, normave të larta të rritjes, flukset e shërbimeve mbeten nën nivelet e para pandemisë (ndryshe nga mallrat). Gjithashtu, hendeku është më i thellë në rastin e importeve, pasi kufizimet ndërkombëtare ndaj lëvizjes së shqiptarëve janë më të forta krahasuar me ato vendëse ndaj të huajve.

Deficiti i të ardhurave primare u zgjerua në terma vjetorë më 45.7 milionë euro gjatë gjysmës së parë 2021, duke iu shtuar përkeqësimit të përjetuar gjatë vitit 2020. Kjo lidhet kryesisht me të ardhurat dalëse në rritje të lidhura me investimet (ato direkte). Nga ana tjetër, të ardhurat hyrëse të "kompensimit të punonjësve" nuk janë rikuperuar ende, pasi punonjësit vendës sezonalë ballafaqohen ende me kufizime kur udhëtojnë jashtë vendit për të punuar.

Suficiti i të ardhurave dytësore u zgjeruan në terma vjetorë me 23.3% gjatë gjysmës së parë 2021 nxitur nga rritja e fluksit të remitancave. Rritja vjetore e tyre shënoi 24.4% për gjysmën e parë të vitit 2021 dhe 41.8% për tremujorin e dytë. Prurjet e remitancave kanë shfaqur performancë të mirë edhe në gjysmën e dytë të vitit 2020 (me rritje vjetore afër niveleve dyshifrore) pas goditjes së pësuar në 2020T2. Emigrantët kanë shtuar dërgesat për të ndihmuar familjarët e tyre gjatë periudhës së vështirë të pandemisë. Rritja e fortë në 2021T2 lidhet edhe me një efekt të fortë bazë nga viti i kaluar.

Me përmirësimin e mëtejshëm të situatës, flukset tregtare dhe financiare pritet të vazhdojnë trendin përmirësues gjatë gjysmës së dytë të vitit 2021, ndonëse me norma rritjeje më të ngadalta. Shërbimet pritet të japin një ndikim të qenësishëm pozitiv në zhvillimet e deficitit korrent për tremujorin e tretë, sugjeruar kjo nga ecuria pozitive e sektorit turistik. Nënllogaria e të ardhurave pritet të shfaqë, gjithashtu, përmirësim e nxitur nga rritja e vazhdueshme e remitancave. Bazuar në rikuperimin e mëtejshëm të ekonomisë vendëse dhe të huaj, deficiti korrent pritet të rikthehet në nivelet e parapandemisë gjatë vitit 2022. Sigurisht, pasiguritë janë të pranishme. Shqipëria ka shtrënguar disi masa ndaj lëvizjes së udhëtarëve prej muajit shtator kur rastet me COVID-19 u shtuan. Gjithashtu, partnerët kryesorë tregtarë kanë rivendosur kufizimet e tyre.

Investimet direkte neto kanë vazhduar në ecurinë e dobët të nisur që më 2020-shin. Rritja vjetore e detyrimeve neto shënoi -1.7% për gjysmën e parë të vitit 2021. Përveç ndikimit të pandemisë, përfundimi i punimeve në gazsjellësin TAP, ka dhënë, gjithashtu, kontribut në ecurinë e IHD-ve. Nga ana tjetër flukset janë rritur në sektorë të tjerë sikurse "Industria nxjerrëse", "Tregtia", "Pasuritë e paluajtshme" dhe "Ndërtimi". Gjithashtu, projekte madhore (sikurse i Portit të Durrësit) pritet t'u japin shtysë IHD-ve në të ardhmen.

Investimet e portofolit kanë pasqyruar kryesisht aktive neto gjatë gjysmës së parë të vitit 2021. Korporatat depozit-marrëse kanë zgjeruar portofolat e huaja gjatë kësaj periudhe. Në të njëjtën kohë, qeveria e përgjithshme ka kryer ripagesat e lidhura me emetime të mëparshme të Eurobondit.

- Zhvillimet në borxhin e jashtëm

Borxhi i jashtëm ka qenë në trend zvogëlues gjatë gjysmës së parë 2021. Stoku qëndron në 8,811.4 milion euro në tremujorin e dytë 2021, duke u pakësuar me 1.5% në terma vjetorë. Raporti i borxhit ndaj PBB-së është gjithashtu i pakësuar në 62.6%, krahasuar me 68.1% në 2020T2. Rënia e borxhit pasqyron ripagesat e Eurobondit nga Qeveria e Përgjithshme. Borxhi afatgjatë përbën rreth 92.0% të totalit i lidhur kryesisht me huamarrjen afatgjatë të Qeverisë së Përgjithshme dhe sektorëve të tjerë[4]. Borxhi afatshkurtër përbën rreth 8.0% të totalit i lidhur me "monedhat dhe depozitat" e korporatave depozitëmarrëse dhe "kreditë tregtare".

Treguesit e aftësisë ripaguese afatgjatë i janë rikthyer ecurisë pozitive në 2021T2, duke përmbysur një përkeqësues, që vazhdonte prej 2020T1, për të arritur kulmin në 2021T1. Raporti i borxhit të jashtëm ndaj eksportit të mallrave dhe ndaj shërbimeve qëndron në nivelin 183.0% në T2, nga 221.1% në 2021T1. Gjithashtu, raporti i borxhit të jashtëm ndaj të ardhurave fiskale ra në 233.0% në 2021T2 nga 248.5% në 2021T1. Raporti i borxhit të qeverisë së përgjithshme ndaj të ardhurave fiskale ra në 111.3% në 2021T2 nga 120.2% në 2021T1. Treguesit e likuiditetit janë, gjithashtu, në trend përmirësues duke sugjeruar presione të ulëta nga detyrimet afatshkurtra.

Grafik 3.2.9 Raporti i borxhit të jashtëm ndaj eksporteve të mallrave dhe shërbimeve (majtas) dhe ndaj të ardhurave fiskale (djathtas)



Burimi: Banka e Shqipërisë

Në skenarin bazë për vitin 2021, borxhi i jashtëm pritet të arrijë deri në 65% ndaj PBB-së, një raport i ngjashëm me atë të vitit 2020. Ky vlerësim parashikon një zgjerim të shpejtë të borxhit të jashtëm bruto si pasojë e rritjes së huamarrjes së sektorit publik. Si rrjedhojë, pavarësisht parashikimit për një rimëkëmbje të shpejtë të ekonomisë, raporti i borxhit të jashtëm ndaj PBB-së mbetet përgjithësisht i pandryshuar krahasuar me atë të vitit 2020. Në periudhën afatmesme, parashikohet një rënie e vazhdueshme e raportit të borxhit ndaj PBB-së, në pasqyrim të trajektores fiskale të pritshme konsoliduese. Një gjë e tillë do të pakësonte nevojat për financim të jashtëm.

Ky projeksion përfshin disa risqe me prirje rritëse, disa prej të cilëve përfshihen në analizën e ndjeshmërisë së borxhit të jashtëm. Në këtë rast, simulohen dy goditje të lidhura me normat e interesit dhe me kursin e këmbimit. Në skenarin e parë, norma mesatare e interesit të borxhit të jashtëm rritet në mënyrë permanente me dy devijime standarde krahasuar me skenarin bazë. Ndërkohë, në skenarin e dytë, kursi i këmbimit i jepet një goditje nënçmuese prej 10% për një herë të vetme. Rezultatet e simuluara dëshmojnë se përkeqësimi i situatës së borxhit të jashtëm është më i fortë sipas skenarit të nënçmimit me 10%.

Grafik 3.2.10 Borxhi i jashtëm bruto ndaj PBB-së në skenarin bazë dhe sipas dy skenarëve të riskut: goditje e normës së interesit (majtas) dhe nënçmim real (djathtas)

[4] Statistikat e borxhit të jashtëm, sipas maturitetit kanë pësuar disa rishikime. Në saje të të dhënave më të sakta, një pjesë e borxhit të jashtëm që lidhet me depozitat e jorezidentëve është riklasifikuar si borxh afatgjatë. Kjo ka shkaktuar një rritje të fortë të përpjesës së borxhit afatgjatë në kurriz të atij afatshkurtër. Këto ndryshime janë pasqyruar në disa raporte të borxhit afatshkurtër përfshirë ata që lidhen me rezervën, sikurse do të paraqitet më vonë.



Burimi: Banka e Shqipërisë

- Zhvillimet në stokun e rezervës[5]

Banka e Shqipërisë optimizon nivelin e rezervës valutore, duke balancuar rreziqet e mundshme në të ardhmen dhe kostot që lidhen me mbajtjen e saj. Vlerësimi i mjaftueshmërisë së rezervës bazohet në një platformë, e cila mban parasysh këto parime. Banka e Shqipërisë zbaton nivelet minimale të pragut të mjaftueshmërisë së rezervës, bazuar në dy kritere: mbulimi i: 1. të paktën 4 muaj importe mallrash dhe shërbimesh; dhe 2. mbulim të paktën 100% të borxhit të jashtëm afatshkurtër. Në tetor 2021, stoku i rezervës ndërkombëtare qëndron në nivelin 4.2 miliardë euro, ose rreth 27% ndaj PBB-së. Ky nivel është i mjaftueshëm për të mbuluar 8 muaj importe mallrash dhe shërbimesh dhe 300% të borxhit të jashtëm afatshkurtër. Të dyja kriteret pritet të mbeten mbi nivelin e pragut minimal të mjaftueshmërisë në periudhën afatmesme.

Grafik 3.2.11 Projeksionet e rezervës ndërkombëtare ndaj importit të mallrave dhe shërbimeve (majtas) dhe ndaj borxhi të jashtëm afatshkurtër (djathtas)



Burimi: Banka e Shqipërisë

- Sektori financiar

Bilanci i përgjithshëm i institucioneve financiare ka vijuar të zgjerohet në terma nominalë dhe relativë gjatë 9 muajve të parë të vitit 2021. Zgjerimi ka qenë veçanërisht i dukshëm në bilancin e sektorit bankar vendës. Pesha e aktiveve të sistemit financiar ndaj PBB-së u rrit me 4 p.p. në 122.5% krahasuar me 118.5% në fund të dhjetorit 2020. Rritje në raport me PBB-në është vërejtur në industrinë e institucioneve financiare jobanka, fondet e investimeve dhe fondet e pensioneve. Nga ana tjetër, pesha e bilancit të

[5] *Data on reserve ratio to short term debt are recalculated according to revisions in short term debt statistics.*

shoqërive të kursim-kreditit dhe shoqërive të sigurimit ndaj PBB-së ka mbetur e pandryshuar nga nivelet e regjistruara në fund të vitit 2020.

Tabelë 3.2.4 Aktivet e sistemit financiar ndaj PBB-së

Autoriteti Mbikëqyrës	Banka e Shqipërisë			Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare			Ndërmjetësit financiarë
Sistemi financiar	Sektori bankar	IFJB	SHKK dhe unioni	Shoqëritë e sigurimit	Fondet e pensionit	Fondet e investimit	
2011	88.1	2.7	0.8	1.5	0.0		93.1
2012	92.1	2.7	0.8	1.6	0.0	1.2	98.6
2013	94.8	2.7	0.7	1.7	0.0	3.9	103.8
2014	97.6	3.0	0.8	1.9	0.0	4.8	108.2
2015	97.3	2.9	0.8	2.1	0.1	5.0	108.0
2016	100.5	3.0	0.6	2.1	0.1	4.7	111.0
2017	99.4	3.1	0.6	2.1	0.1	5.0	110.3
2018	96.0	3.5	0.6	2.1	0.2	4.5	106.9
2019	95.5	4.2	0.7	2.2	0.2	4.3	107.2
2020	105.9	4.5	0.8	2.6	0.2	4.5	118.5
2021*	109.5	4.7	0.8	2.6	0.3	4.6	122.5

Burimi: Banka e Shqipërisë, INSTAT, Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare * shtator 2021

Bilanci i sektorit bankar është zgjeruar me 11% nga fundi i tetorit 2020 deri në fund të tetorit 2021. Nga ana e aktiveve, rritja vjetore është mbështetur në mënyrë të barabartë nga rritja e fortë në tri klasat kryesore të aktiveve. Stoku i letrave me vlerë të bankave dhe stoku i veprimeve me thesarin dhe ekspozimeve ndërbankare u zgjeruan përkatësisht me 15% dhe 8%, ndërsa stoku i tepricës së kredive bankare u rrit me 11%. Struktura e letrave me vlerë të zotëruara nga bankat dominohet nga letra me vlerë të Qeverisë Shqiptare në lekë (60%) dhe në valutë (10%), ndërsa pjesa e mbetur prej 30% përbëhet nga letra me vlerë në valutë të huaj të emetuar nga jorezidentët. Aktivet në valutë dhe pretendimet ndaj jorezidentëve përbëjnë rreth 52% dhe 23% të totalit të aktiveve dhe janë rritur me 13% dhe 16% në vit në fund të tetorit 2021. Detyrimet dhe aktivet e bankave në valutë janë të krahasueshme në madhësi, ndërsa pretendimet ndaj jorezidentëve janë rreth 8 herë më të larta se detyrimet ndaj jorezidentëve. Burimi kryesor i financimit për bankat vendëse është në formën e depozitave, të cilat rezultojnë rreth 1,400 miliardë lekë në tetor 2021. Depozitat shënuan një rritje të fortë gjatë 10 muajve të parë të vitit 2021 dhe rritja arriti kulmin gjatë tremujorit të tretë, si pasojë e rritjes së theksuar të depozitave në valutë. Llogaritë rrjedhëse dhe në një masë më të vogël depozitat pa afat kanë vazhduar të rriten, ndërkohë që rënia e depozitave me afat u ndal në muajt e verës dhe u pasua me një rritje modeste në shtator dhe tetor. Në fund të tetorit 2021, depozitat me afat përbënin rreth 44% të stokut të përgjithshëm të depozitave, që tregon një rënie të ndjeshme krahasuar me raportin prej 51% në fund të vitit 2019 dhe atë prej 47% në fund të vitit 2020.

Tabelë 3.2.5 Rritja në stokun e kredisë dhe të depozitave

	2014	2015	2016	2017	2018	2019	2020	2021*
Hua (rritja vjetore,%)	5	-2	2	0	-3	-1	6	11
Depozita (rritja vjetore,%)	5	3	5	1	1	1	8	11
Hua/Depozita (%)	56	54	52	52	49	48	47	47

Burimi: Banka e Shqipërisë *tetor 2021

Në fund të tetorit 2021, stoku i tepricës së kredisë ishte 660 miliardë lekë nga 590 miliardë lekë në tetor 2020 dhe norma vjetore e rritjes ishte e barabartë me 11%. Kredia bankare u rrit me një ritëm të qëndrueshëm gjatë 12 muajve deri në tetor 2021, por rritja nominale (+60 miliardë lekë) dhe rritja mesatare vjetore (+6%) në stokun e kredive ishin më pak se ndryshimet përkatëse të depozitave. Ritmet e rritjes së portofolit të kredisë, sipas sektorëve institucionalë (individë dhe biznese) dhe sipas monedhës (lekë dhe valutë) kanë qenë të krahasueshme, por në terma të maturitetit, rritja e stokut të kredisë është e lidhur me rritjen në terma afatgjatë dhe me portofolin e kredive për pasuri të paluajtshme. Kreditë për pasuri të paluajtshme përbëjnë 22% të portofolit të përgjithshëm të kredisë nga 20% dhe 21% përkatësisht në dhjetor 2019 dhe dhjetor 2020 dhe norma e rritjes së portofolit të kredisë për pasuri të paluajtshme në tremujorin e tretë të 2021 ishte 12%. Rritja e lartë në këtë segment të portofolit të kredisë mund të lidhet

me kërkesën më të lartë dhe kushtet më të relaksuara të kreditimit, veçanërisht për kreditë hipotekare për sektorin e individëve. Rezultatet e vrojtimit të kredisë bankare për tremujorin e tretë 2021, sugjerojnë se si kërkesa, ashtu edhe oferta për kredi, janë rritur në krahasim me tremujorët e mëparshëm duke reflektuar përmirësimin e kushteve makroekonomike dhe besimin më të fortë të biznesit dhe të konsumatorëve. Numri i aplikimeve për kredi, për qëllime të investimit dhe likuiditetit nga sektori i individëve, dhe biznesi ka qenë më i lartë dhe shkalla e refuzimit më e ulët në krahasim me tremujorët e mëparshëm. Në të njëjtën kohë bankat kanë relaksuar standardet e tyre të kredisë dhe planifikojnë të vazhdojnë ta bëjnë këtë gjatë tremujorit të fundit të vitit, pasi kërkesa për kredi pritet të mbetet e fortë.

Kapitalizimi i sektorit bankar deri në fund të tremujorit të tretë 2021 mbeti në nivele të mjaftueshme, pavarësisht një rënie të lehtë të raportit të mjaftueshmërisë së kapitalit në 18.3% nga 18.7% në fund të dhjetorit 2020 dhe 18.6% në fund të shtatorit 2020. Rënia e raportit u shkaktua nga rritja e nivelit të aktiveve të ponderuara me rrezik. Bankat mbetën fitimprurëse gjatë periudhës janar–tetor 2021 dhe fitimi i përgjithshëm dhe raportet e përfitueshmërisë ishin më të larta se në vitin 2019 dhe 2020. Më shumë se gjysma e bankave, duke përfshirë bankat me rëndësi sistemike, kishin fitime më të larta krahasuar me fitimet e regjistruara gjatë 10 muajve të parë të vitit 2020. Rezultati neto i aktivitetit të sektorit bankar u rrit me 40% në 18 miliardë lekë nga 13 miliardë lekë në vitin 2020 dhe kthimi nga aktivet (RoA) dhe kthimi nga kapitali (RoE) arritën në 12.8% dhe 1.3% nga 9.6% dhe 1% në fund të muajit tetor 2020. Rreth 65% e fitimit neto gjenerohet nga aktivitetet në valutë, por vëllimi i kësaj pjese të fitimit ka mbetur i pandryshuar nga një vit më parë, ndërkohë që fitimet në lekë janë 5 herë më të larta (nga 1.2 miliardë lekë deri në 6 miliardë lekë). Rritja e ndjeshme e rezultatit neto të bankave lidhet me përmirësimin e të ardhurave neto nga interesi, si dhe një rënie të ndjeshme të shpenzimeve të provigjioneve për humbjen e kredisë. Rezultatet e provës së rezistencës që mbulojnë horizontin 2021–2022 tregojnë se sektori bankar mbetet elastik ndaj goditjeve të mundshme makroekonomike, megjithëse disa banka mund të përballen me nevojën për të forcuar pozicionet e tyre të kapitalit.

Rreziku i kredisë ka rënë ndjeshëm gjatë vitit 2021 dhe raporti i kredive me probleme (RKP) ra në 6.35% në tetor 2021, duke arritur nivelin më të ulët që nga viti 2009. Përmirësimi u vu re pothuajse në të gjitha kategoritë e kredive dhe erdhi si rezultat i rënies së kredive me probleme dhe, gjithashtu, rritjes së stokut të kredisë. Krahasuar me një vit më parë, stoku i kredive me probleme u tkurr me 15% ose 8 miliardë lekë, ndërsa raporti i kredive me probleme u ul me rreth 1.9 p.p. Rënia më e fortë është shënuar të kreditë me probleme në valutë (-22%), si dhe te stoku i kredive me probleme për bizneset dhe ato afatshkurtra (-18%). Rënia e stokut të kredive me probleme, sipas renditjes së kontributit, është ndikuar nga rritja e shlyerjeve në dy klasat e para të kredive me probleme; ristrukturimi i një pjese të kredive me probleme; dhe fshirjen e kredive të humbura nga bilancet e bankave. Rënia e stokut të kredive "nënstandarde" dhe "të dyshimta", së bashku me rënien e ndjeshme të fluksit të kredive të reja me probleme luajtën një rol të rëndësishëm në përmirësimin e cilësisë së kredisë. Struktura e kredive me probleme dominohet nga kategoria e kredive të humbura (52%), ndërsa kreditë e dyshimta dhe ato nënstandard zënë përkatësisht 21% dhe 27% të totalit. Rritja e peshës së kredive të humbura brenda stokut të kredive me probleme gjatë viteve të fundit lidhet me faktin se rënia e stokut të të dyja klasave të tjera të huave me probleme ka qenë më e shpejtë se rënia e stokut të kredive të humbura.

Mbikëqyrja makroprudenciale

Në interes të përmirësimit të transparencës, llogaridhënies dhe komunikimit, në maj 2021, Banka e Shqipërisë publikoi një dokument, që synon të informojë publikun mbi zbatimin e politikës makroprudenciale në Shqipëri. Temat kryesore të trajtuara në dokument janë: a) stabiliteti financiar dhe politika makroprudenciale; b) kuadri institucional i politikës makroprudenciale në Shqipëri; c) identifikimi dhe vlerësimi i rreziqeve sistemike; d) zbatimi i politikës makroprudenciale në Shqipëri; dhe e) komunikimi dhe llogaridhënia. Ky dokument ofron një pamje më praktike dhe më të detajuar të objektivave të ndërmjetëm dhe instrumenteve të politikës krahasuar me Strategjinë e Politikës Makroprudenciale (gusht, 2017) dhe fokusohet në masat makroprudenciale që janë zbatuar në Shqipëri pas miratimit të rregullores nga Banka e Shqipërisë, "Për shtesat makroprudenciale të kapitalit", në qershor 2019 (Rregullorja).

Rregullorja ofron bazën mbi të cilën Banka e Shqipërisë zbaton tri shtesat e kapitalit (shtesa konservuese e kapitalit, kundërciklike dhe shtesa e kapitalit për bankat me rëndësi sistemike) në periodicitetin dhe normat e parashikuara në rregullore dhe të mbështetura nga metodologjitë shoqëruese. Shtesa kundërciklike e kapitalit shpallet në fund të çdo tremujori me vendim të Guvernatorit. Vendimi për listën e bankave me rëndësi sistemike dhe për shtesat për rëndësinë sistemike shpallet një herë në vit në

fund të tremujorit të parë. Shtesa konservuese e kapitalit caktohet sipas afatit kohor dhe normave të parashikuara në rregullore. Pozicioni i secilës bankë ndaj kërkesave të shtesave makroprudenciale të kapitalit vlerësohet çdo tremujor nëpërmjet një pakete raportimi të veçantë dhe një raporti të dedikuar. Kërkesat e zbatueshme deri më 1 janar 2022 janë paraqitur në tabelën e mëposhtme.

Tabelë 3.2.6 Prezantimi i shtesave makroprudenciale të kapitalit që duhet të përmbushen deri më 1 janar 2022

Nr.	SHMAK (shtesat makroprudenciale të kapitalit)	Banka		Afati i përmbushjes
		BARS (bankat me rëndësi sistemike)	*Jo – BARS (bankat me rëndësi josistemike)*	
1	SIST (Shtesa e rëndësisë sistemike)	Siç parashikohet në vendimin e Guvernatorit 1767/2021, por deri në 1.5% për vitin 2022 ***Lista e BARS*** 1. BKT (Banka Kombëtare Tregtare) 1.0% 2. BR (Banka Raiffeisen) 1.0% 3. BC (Banka Credins) 1.0% 4. ISPBA (Banka Intesa San Paolo Shqipëri) 0.5% 5. OTP (Banka OTP) 0.5%	Jo e zbatueshme	1 janar 2022
2	KONS (shtesa konservuese e kapitalit)	1.5%	1.5%	1 janar 2022
3	SPEKUNC (shtesa kundërciklike e kapitalit specifike për bankën)	Siç parashikohet në vendimin e Guvernatorit 4217/2021 dhe bazuar në llogaritjet e bankës (por jo më lart se 1.875% për vitin 2022)	Siç parashikohet në vendimin e Guvernatorit 4217/2021 dhe bazuar në llogaritjet e bankës (por jo më lart se 1.875% për vitin 2022)	30 shtator 2022
4 = 1+2+3	**SHKOMAK (shtesa e kombinuar makroprudenciale e kapitalit)**	KONS (1.5%) + SIST (0.5% or 1.0% or 1.5%) + SPEKUNC	KONS (1.5%) + SPEKUNC	

Mjeti kryesor i përdorur nga Banka e Shqipërisë për të vlerësuar zhvillimet në rreziqet sistemike kundrejt objektivave të ndërmjetëm të politikës makroprudenciale është Harta tremujore e Nxehtësisë së Rreziqeve Makroprudenciale (vetëm për përdorim të brendshëm). Treguesit janë strukturuar dhe grupuar, sipas katër objektivave të ndërmjetëm, të lidhur me rreziqet specifike dhe zhvillimet në secilin prej treguesve bazë, përkundrejt kufijve, informojnë diskutimet e brendshme dhe vendimmarrjen makroprudenciale.

Sipas analizës së fundit (TM3-2021) Harta e Nxehtësisë së Rreziqeve Makroprudenciale tregon se nuk ka rreziqe të rëndësishme të lidhura me rritjen e tepërt të kredisë, përqendrimin në aktivitetin e sektorit bankar dhe madhësinë e institucioneve sistemike. Raporti arrin në përfundimin se masat që janë tashmë të zbatueshme janë të mjaftueshme dhe të përshtatshme për të adresuar rreziqet aktuale dhe se nuk ka nevojë për masa shtesë. Raporti nënvizon nevojën (për autoritetin makroprudencial) për të monitoruar nga afër dhe me kujdes zhvillimet në boshllëqet e maturitetit, shkallën e euroizimit dhe ekspozimet e sektorit bankar ndaj tregut të pasurive të paluajtshme, në kontekstin e rritjes së çmimeve të pasurive të paluajtshme dhe rritjes së fortë në kreditë për blerje të pasurive të paluajtshme dhe investimeve. Në këtë drejtim, Banka e Shqipërisë është pranë finalizimit të vlerësimit të praktikave të sektorit bankar, në lidhje me kredinë për pasuritë e paluajtshme (përdorimi i raporteve LTV), si dhe një udhëzues që do të ndihmojë bankat të harmonizojnë praktikat e tyre. Në të njëjtën kohë, Banka e Shqipërisë po punon mbi kuadrin për funksionalizimin e shtesës së rrezikut sistemik.

Kuadri i ndërhyrjes së jashtëzakonshme në sektorin bankar si pjesë e reformave të sektorit financiar

Banka e Shqipërisë, në cilësinë e Autoritetit të Ndërhyrjes së Jashtëzakonshme ka vijuar me zhvillimin mëtejshëm të kuadrit rregullator në fushën e ndërhyrjes së jashtëzakonshme në banka, ka finalizuar ciklin e tretë të planifikimit të ndërhyrjes së jashtëzakonshme dhe ka ndjekur hapat e nevojshëm për ngritjen e Fondit të Ndërhyrjes së Jashtëzakonshme. Gjatë vitit 2021, hyri në fuqi një kërkesë e re rregullatore, e cila ka të bëjë me kërkesën minimale për instrumente kapitalit rregullator dhe detyrime të pranuara - MREL, që bankat duhet të mbajnë për të përthithur humbjet dhe për të rikapitalizuar bankën, nëse ajo shkon në

ndërhyrje të jashtëzakonshme, pa përdorur ndihmën e fondeve publike.

- Zhvillimet në kuadrin e ndërhyrjes së jashtëzakonshme në sektorin bankar, në vitin 2021

Kuadri rregullator dhe metodologjik

Gjatë vitit 2021, duke synuar përafrimin me legjislacionin e BE-së për plotësimin e kuadrit rregullator për ndërhyrjen e jashtëzakonshme në banka, Banka e Shqipërisë miratoi:

- Me vendimin nr. 20, datë 4.7.2021, të Këshillit Mbikëqyrës, rregulloren "Për njohjen kontraktuale të kompetencave të zhvlerësimit dhe konvertimit", e cila përafron rregulloren e Komisionit Evropian 2016/1075/BE, mars 2016, dhe plotëson direktivën 2014/59/BE, të Këshillit dhe Parlamentit Evropian. Kjo rregullore përcakton përmbajtjen e klauzolave kontraktuale, në lidhje me njohjen kontraktuale të kompetencave të zhvlerësimit dhe të konvertimit.

- Me vendimin nr. 33, datë 7.7.2021, të Këshillit Mbikëqyrës, rregulloren "Për krijimin dhe funksionimin e shoqërisë për administrimin e aktiveve", e cila është përgatitur në bazë të praktikave më të mira evropiane.

- Me vendimin nr. 34, datë 7.7.2021, të Këshillit Mbikëqyrës, rregulloren "Për kriteret për përcaktimin e normave të konvertimit të detyrimeve në kapital", në përputhje me EBA/GL/2017/03, datë 11.7.2017, në zbatim të nenit 50(4), të direktivës 2014/59/BE (BRRD), mbi përcaktimin e normave të konvertimit të borxhit në kapital në rikapitalizimin nga brenda. Kjo rregullore specifikon kriteret për normat e konvertimit në kapital të detyrimeve të bankës, duke përdorur kompetencën e zhvlerësimit dhe konvertimit në zbatimin instrumentit të rikapitalizimit nga brenda.

- Me vendimin nr. 35, datë 7.7.2021, të Këshillit Mbikëqyrës, rregulloren "Për llojet e marrëveshjeve që do të mbrohen në transferimin e pjesshëm", në përputhje me rregulloren e deleguar të Komisionit (BE) 2017/867, datë 7 shkurt 2017, mbi llojet e marrëveshjeve që mbrohen në transferimin e pjesshëm të pronës, sipas nenit 76 të direktivës 2014/59/BE së Këshillit dhe Parlamentit Evropian. Kjo rregullore përcakton kushtet për llojet e marrëveshjeve, që duhen mbrojtur në transferimin e pjesshëm të aktiveve dhe të detyrimeve të një banke në ndërhyrje të jashtëzakonshme.

- Në zbatim të dispozitave të rregullores nr. 78/2020, "Për kërkesat minimale për instrumente të kapitalit rregullator dhe detyrime të pranuara", Banka e Shqipërisë hartoi dokumentin metodologjik për vitin 2021, i cili përcakton mënyrën e llogaritjes së kërkesës minimale për instrumente të kapitalit rregullator dhe detyrime të pranuara – MREL, për bankat, bazuar në Politikën SRB për MREL, sipas Paketës Bankare në ciklin e planeve të ndërhyrjes së jashtëzakonshme të vitit 2020.

Planifikimi i ndërhyrjes së jashtëzakonshme

Banka e Shqipërisë ka vijuar të zhvillojë më tej planet e ndërhyrjes së jashtëzakonshme dhe të komunikojë me bankat sistemike, të monitorojë se si ato përmbushin rekomandimet e lëna nga Banka e Shqipërisë, si Autoriteti i Ndërhyrjes së Jashtëzakonshme, për të hequr pengesat e mundshme ndaj aftësisë për ndërhyrje të jashtëzakonshme, të identifikuara me ciklet e planeve të ndërhyrjes së jashtëzakonshme.

Për ciklin e planeve të ndërhyrjes së jashtëzakonshme për vitin 2021, përveç përditësimit të seksioneve të ndryshme të planit, të tilla si: analiza strategjike e biznesit të bankës, identifikimi i funksioneve ekonomike me rëndësi kritike, analiza e ndërvarësive kritike të brendshme dhe të jashtme, infrastruktura dhe sistemet kritike, planet e ndërhyrjes së jashtëzakonshme përmbajnë një analizë më të thelluar, lidhur me përzgjedhjen e strategjisë së preferuar dhe instrumentit të ndërhyrjes së jashtëzakonshme etj. Ato ofrojnë një vlerësim më të mirë, gjithëpërfshirës, si dhe më shumë informacion lidhur me besueshmërinë dhe zbatueshmërinë e procedurave të likuidimit të detyruar, duke vlerësuar nëse ndërhyrja e jashtëzakonshme plotëson testin e interesit publik.

Në zbatim të metodologjisë për përcaktimin e MREL-së, planet e ndërhyrjes së jashtëzakonshme për vitin 2021 përmbajnë nivelin e ndërmjetëm të synuar të kërkesës minimale për instrumente të kapitalit rregullator dhe detyrime të pranuara – MREL, që duhet të përmbushet nga bankat në vitin 2022 dhe nivelin përfundimtar të synuar, që duhet të përmbushet deri në vitin 2027, për secilën bankë në nivel individual. Siç kërkohet nga kuadri rregullator, për ciklin e planifikimit të ndërhyrjes së jashtëzakonshme për vitin 2021, Banka e Shqipërisë përcaktoi nivelin e ndërmjetëm dhe atë përfundimtar të MREL-së, për çdo bankë individuale dhe ua komunikoi bankave përkatëse këto vendime.

Planet individuale të ndërhyrjes së jashtëzakonshme përmbajnë edhe vlerësimin e aftësisë për ndërhyrje të jashtëzakonshme, e cila lidhet me identifikimin e pengesave të mundshme për ndërhyrjen e jashtëzakonshme. Pas identifikimit të pengesave të mundshme për ndërhyrje të jashtëzakonshme, Banka e Shqipërisë mban një komunikim të rregullt me bankat, për të hequr këto pengesa, në përputhje me

planin e punës të rënë dakord.

Në zbatim të marrëveshjes së bashkëpunimit ndërmjet Bankës së Shqipërisë dhe Bordit të Përbashkët të Ndërhyrjes së jashtëzakonshme (SRB), e nënshkruar në tetor 2018, e cila ka në fokus shkëmbimin e informacionit, në lidhje me subjektet bankare që operojnë në Shqipëri dhe në BE, për të mundësuar një planifikim efikas të ndërhyrjes së jashtëzakonshme për subjektet me operacione ndërkufitare, Banka e Shqipërisë është ftuar nga SRB-ja të marrë pjesë në mbledhjet e kolegjit të ndërhyrjes së jashtëzakonshme, për subjektet bankare me filiale që operojnë në Shqipëri.

Fondi i Ndërhyrjes së Jashtëzakonshme

Për sa i përket Fondit të Ndërhyrjes së Jashtëzakonshme, niveli i synuar i Fondit të Ndërhyrjes së Jashtëzakonshme është 0.5% e totalit të detyrimeve të sektorit bankar (aktualisht 6.64 miliardë lekë), llogaritur si diferencë midis aktiveve dhe kapitalit të të gjitha bankave të licencuara në Shqipëri, që duhet të arrihet deri në vitin 2027. Bankat në Shqipëri paguajnë kontribute vjetore në Fond, në përputhje me ligjin dhe metodologjinë e llogaritjes të hartuar nga Banka e Shqipërisë.

Banka e Shqipërisë përditëson në baza vjetore nivelin e synuar të Fondit të Ndërhyrjes së jashtëzakonshme dhe kontributin vjetor të bankave. Për vitin aktual (2021), Banka e Shqipërisë ka përditësuar nivelin e synuar të Fondit të Ndërhyrjes së Jashtëzakonshme dhe kontributin vjetor të bankave, të cilat janë paguar nga bankat brenda afatit rregullator.

Banka e Shqipërisë monitoron rregullisht ecurinë e aktiveve financiare të Fondit të Ndërhyrjes së Jashtëzakonshme, bazuar në raportimin tremujor nga Agjencia Shqiptare e Sigurimit të Depozitave, si administrator i Fondit të Ndërhyrjes së Jashtëzakonshme, në zbatim të politikës së investimit. Politika e investimit ndjek parimet e likuiditetit të aktiveve, të investimit në letra me vlerë të borxhit me rrezik të ulët kredie, dhe më pas, të marrjes së një kthimi të arsyeshëm nga investimet. Në fund të shtatorit 2021, Fondi i Ndërhyrjes së Jashtëzakonshme arriti në 2.7 miliardë lekë, i investuar në llogari rrjedhëse dhe depozita afatshkurtra në Bankën e Shqipërisë si dhe në bono thesari dhe obligacione të qeverisë.

3.3 Skenari alternativ dhe rreziqet

Skenari bazë vlerësohet të ketë probabilitet më të lartë për t'u materializuar. Megjithatë parashikimi i skenarëve alternativë – duke supozuar se një pjesë e risqeve të ndryshme, që rrethojnë skenarin bazë mund të materializohen – është një komponent i rëndësishëm i planifikimit të financave publike. Në mënyrë që të rritet cilësia e planifikimit dhe të ketë një menaxhim më efikas të fondeve publike në çdo situatë që ka një probabilitet të caktuar për të ndodhur, më poshtë paraqiten shkurtimisht dy skenarë alternativë, në mënyrë specifike një skenar "pesimist" dhe një skenar "optimist".

Secili nga skenarët alternativë supozon që një grup risqesh negative (në rastin e një skenari "pesimist") ose risqesh pozitive (në rastin një skenari "optimist") do të materializohen. Ky grup risqesh supozon devijime nga parashikimet në skenarin bazë për treguesit kryesorë makroekonomikë, duke përfshirë kreditimin e ekonomisë, ecurinë e ekonomisë së Eurozonës me efektet që ka në eksportin e mallrave dhe të shërbimeve, në remitanca, në flukset e kapitaleve të huaja, si dhe në kursin e këmbimit, normën e interesit, ritmin dhe ndikimin e reformave të politikave strukturore të planifikuara për periudhën afatmesme etj.

Efekti i përgjithshëm neto i të gjitha risqeve të supozuara, negative ose pozitive, për thjeshtësi analize (modelimi) jepet si një goditje fillestare në terma të një variabli të vetëm, "rritjes ekonomike reale". Pra, skenarët alternativë bazohen në supozime të ndryshme të rritjes ekonomike nga skenari bazë për secilin vit 2022–2024(26). Në këtë seksion, si dhe në seksionin tjetër përkatës 4.7 (Analiza e ndjeshmërisë), në mënyrë që të kemi një pamje më gjithëpërfshirëse dhe të dobishme dhe qasjen e përballimit të secilit skenar alternativ, ne zgjasim horizontin e kohës së simulimit deri në vitin 2026. Tabela e mëposhtme paraqet supozimet e "rritjes reale" në skenarët alternativë, rritjen nominale të derivuar dhe nivelin nominal të PBB-së, si dhe disa supozime të tjera (implikimet e supozuara) mbi disa variabla kryesorë fiskalë që shpjegohen në seksionin 4.7.

Më shumë rëndësi i japim skenarit "pesimist" dhe përballimit të mundshëm të implikimeve të tij, si dhe prezantojmë në mënyrë asimetrike një goditje më të madhe negative në këtë skenar krahasuar me madhësinë e kundërt të goditjes pozitive që prezantojmë në atë "optimist". Supozojmë se në skenarin "pesimist" rritja reale e PBB-së do të jetë 1.5 p.p. më e ulët për çdo vit (2022–2026) se sa parashikimet përkatëse të rritjes në skenarin "bazë". Ndërsa në skenarin "optimist" supozojmë se rritja reale do të jetë 2 p.p. më i lartë për çdo vit se sa ajo që parashikojmë përkatësisht në skenarin "bazë".

Tabelë 3.3.1 Supozimet alternative për secilin skenar

	2016	2017	2018	2019	2020	2021	2022	2023	2024	2025	2026
						Vler	Para	Para	Para	Para	Para
Rritja reale e PBB-së (%)											
Bazë	3.3	3.8	4.1	2.1	-4.0	8.7	4.1	4.2	3.9	3.9	4.1
Pesimist							2.6	2.7	2.4	2.4	2.6
Optimist							4.6	4.7	4.4	4.4	4.6
Rritja nominale e PBB-së (%)											
Bazë	2.7	5.3	5.6	3.4	-4.4	9.4	5.5	5.2	5.4	5.4	5.3
Pesimist							4.0	3.7	3.9	3.9	3.8
Optimist							6.1	5.7	5.9	5.9	5.8
PBB nominale (në miliard lek)											
Bazë	1,472.5	1,550.6	1,636.7	1,691.7	1,617.5	1,769.3	1,867.4	1,964.8	2,070.9	2,183.2	2,299.4
Pesimist							1,840.4	1,908.6	1,982.6	2,060.0	2,138.3
Optimist							1,876.3	1,983.7	2,100.8	2,225.4	2,355.1
Totali i të ardhurave (% e PBB-së)											
Bazë	27.6	27.8	27.5	27.2	26.3	28.6	28.7	29.0	29.1	29.2	29.3
Pesimist							28.2	28.5	28.6	28.7	28.8
Optimist							28.8	29.0	29.1	29.2	29.3
Rritja vjetore e totalit të të ardhurave (%)											
Bazë	7.3	5.7	4.5	2.3	-7.5	19.0	5.9	6.1	5.6	5.8	5.7
Pesimist							2.6	4.6	4.1	4.3	4.2
Optimist							6.6	6.6	6.1	6.4	6.3
Të ardhurat totale (në miliard Lek)											
Bazë	407.0	430.4	449.9	460.3	425.9	506.9	536.8	569.7	601.8	637.0	673.6
Pesimist							519.9	543.9	566.2	590.7	615.7
Optimist							540.3	576.2	611.6	650.4	691.1
Norma efektive e interesit të borxhit publik (%)											
Bazë	3.7	3.2	3.5	3.3	3.2	3.1	3.3	3.7	4.2	4.4	4.5
Pesimist							3.3	3.7	4.2	4.4	4.5
Optimist							3.3	3.7	4.2	4.4	4.5
Norma nominale e këmbimit, në fund të vitit (Lek/Euro)											
Bazë	135.3	133.2	123.5	122.2	123.5	121.0	121.0	121.0	121.0	121.0	121.0
Pesimist							121.0	121.0	121.0	121.0	121.0
Optimist							121.0	121.0	121.0	121.0	121.0

Burimi: Ministria e Financave dhe Ekonomisë

4. Kuadri fiskal

4.1 Politikat strategjike dhe objektivat afatmesëm

Në vitet e fundit, deri përpara goditjes nga pandemia, financat publike kishin hyrë në një trajektore të sigurt dhe optimale të konsolidimit fiskal, të materializuar në parametrat më të rëndësishëm të qëndrueshmërisë. Së pari, kjo u materializua në uljen e deficitit të përgjithshëm buxhetor nga 5% e PBB-së në vitin 2013, në poshtë nivelit prej 2% në vitin 2019. Ndërsa në vitin 2020, si kundërpërgjigje kryesore ndaj amortizimit deri në një farë mase të goditjes nga pandemia, u ndërmor një politikë fiskale mjaft ekspansioniste. Për rrjedhojë, deficiti total buxhetor arriti në rreth 6.8% të PBB-së dhe borxhi publik u rrit në rreth 76% të PBB-së, pra me rreth 10 pikë përqindjeje krahasuar me fundin e 2019-ës.

Për të realizuar një politikë fiskale të tillë ekspansioniste në përgjigje të goditjes, qeverisë iu desh të aktivizonte "klauzolat e devijimit" nga rregullat fiskale gjatë vitit 2020, si klauzola të parashikuara tashmë në ligjin organik të buxhetit (LOB), duke mos cenuar kështu besueshmërinë e financave publike në perceptimin e tregjeve dhe agjentëve ekonomikë. Gjithashtu, me synimin për të ruajtur sa më shumë të ishte e mundur të pacenuar kredibilitetin e financave publike në perceptimin e tregjeve, element kyç ky për financat publike, si një fondament makroekonomik, sidomos për vende të vogla dhe me nevoja rifinancimi buxhetor relativisht siç është Shqipëria, u ndërmor një tjetër iniciativë ligjore në korrik të 2020-ës (në kulmin e pandemisë), duke përfshirë një rregull tjetër të ri fiskal në LOB, i cili sanksiononte ligjërisht që balanca primare e buxhetit të rikthehej në së paku në një nivel të balancuar (pra, jo më e vogël se sa zero) duke filluar nga vitit 2024 e në vijim[6].

[6] Rregulla origjinale sanksiononte "që prej 2023", por më pas kjo u ndryshua sërish në korrik të 2021 dhe u bë "që prej 2024-ës".

Kjo rregull u mirëprit mjaft pozitivisht nga të gjitha institucionet ndërkombëtare (duke përfshirë patjetër edhe agjencitë e *rating*-ut) dhe, rrjedhimisht, nga aktorët ekonomikë në tërësi, si një nismë mjaft e duhur dhe efektive për të ruajtur kredibilitetin dhe qëndrueshmërinë e financave publike, jo vetëm në periudhën afatmesme dhe afatgjatë postpandemisë, por madje vlerësojmë se ishte mjaft ndihmuese për të siguruar një financim (huamarrje) relativisht mjaft normal edhe në afatin e shkurtër përgjatë goditjes, pra përgjatë vitit 2020 dhe pjesës së parë të këtij viti, pavarësisht magnitudës mjaft më të lartë të huamarrjes se sa tipikisht.

Nga viti 2022 e në vazhdim, politika fiskale në periudhën afatmesme do të orientohet drejt konsolidimit fiskal, në përputhje me rregullat fiskale të përcaktuara në ligjin organik të buxhetit (shih kutinë më poshtë mbi parimet dhe rregullat fiskale). Konsolidimi fiskal dhe ulja e borxhit publik janë thelbësore për uljen e dobësive të lidhura me borxhin që pengojnë rritjen dhe shkaktojnë paqëndrueshmëri makroekonomike.

Politika fiskale do të synojë një trajektore rënëse të borxhit publik, pra një trajektore rënëse graduale vjetore, ndërkohë që balanca primare do të kthehet në nivel pozitiv nga viti 2024 e në vazhdim, në përputhje me rregullën fiskale në LOB. Në të njëjtën kohë, krahas konsolidimit fiskal, do të synojmë të ruajmë një raport të shëndetshëm të shpenzimeve buxhetore korrente dhe kapitale, ku shpenzimet kapitale (d.m.th. investimet publike) do të synohen në një mesatare prej rreth 5.6 për qind të PBB-së në çdo vit buxhetor përgjatë periudhës 2022–2024 (përfshirë investimet për rindërtimin pas tërmetit). Deficiti buxhetor për vitin 2022 planifikohet të jetë në nivelin 5.4 për qind të PBB-së nga rreth 5.8 për qind i pritshëm për vitin 2021. Balanca primare për vitin 2022 pritet të jetë ende negative në rreth -2.7 për qind, por me një përmirësim në krahasim me rreth - 3.8 për qind që pritet për vitin 2021. Bilanci korrente fiskale (diferenca ndërmjet investimeve publike dhe deficitit fiskal) do të jetë pozitive në vitin 2022, në nivelin 1 për qind të PBB-së nga një nivel pozitiv i pritshëm prej 2.3 për qind këtë vit, në përputhje me rregullën fiskale përkatëse ("rregulla e artë" e buxhetit).

Për periudhën afatmesme 2022–2024, deficiti buxhetor parashikohet mesatarisht në rreth 3.7 për qind në vit. Më konkretisht, bilanci i përgjithshëm fiskal synohet në -5.4, -2.9 dhe -2.8 për qind respektivisht për 2022-shin, 2023-shin dhe 2024-shin. Bilanci primar parashikohet mesatarisht në rreth -0.8 për qind në vit gjatë periudhës afatmesme vijuese 2022–2024. Në vitin 2022, bilanci primar është projektuar me një deficit primar prej 2.7 për qind të PBB-së dhe në vitin 2023, synohet të jetë në balancë, duke vazhduar më tej në vitin 2024 në vlerë pozitive, përkatësisht 0.3 për qind. Shpenzimet kapitale parashikohen përkatësisht në 6.4, 5.2 dhe 5.3 për qind për vitet 2022, 2023 dhe 2024. Bilanci korrent fiskal synohet mesatarisht në rreth 1.9 për qind në vit gjatë periudhës afatmesme 2022–2024. Më konkretisht, bilanci korrent fiskal është parashikuar përkatësisht në 1.0, 2.2 dhe 2.4 për qind për vitet 2022, 2023 dhe 2024.

Si rrjedhojë, duke filluar nga ky vit (2022) borxhi publik ndaj PBB-së pritet të kthehet në një trajektore rënëse, në përputhje me rregullën fiskale përkatëse, ku pritet të bjerë në rreth 78.9 për qind të PBB-së nga rreth 80.1 për qind i pritshëm për vitin 2021. Deri në fund të vitit 2023, borxhi publik pritet të bjerë në rreth 77.7 për qind të PBB-së dhe rreth 75.8 për qind në vitin 2024. Balanca primare do të kthehet në nivel pozitiv (suficit primar) nga viti 2024 e në vazhdim. Ky objektiv është tashmë ligjërisht i detyrueshëm, ku LOB-ja parashikon që, duke filluar nga viti buxhetor 2024 dhe për çdo vit pasardhës, balanca primare faktike nuk mund të rezultojë negative, pra duhet të jetë së paku e balancuar ose pozitive. Sipas skenarit bazë, borxhi publik pritet të bjerë në rreth 74.6 për qind në vitin 2025 dhe më tej në rreth 67.7 për qind deri në vitin 2028.

Në të njëjtën kohë, synohet dhe programohet një nivel i investimeve publike (duke përfshirë vetëm qeverinë qendrore) në një mesatare vjetore prej rreth 5.3% të PBB-së, gjatë periudhës 2022–2024, thelbësore për të mbështetur rritjen ekonomike në afatmesëm dhe afatgjatë.

PARIMET DHE RREGULLAT FISKALE

Në përputhje të plotë me obligimet që rrjedhin prej ligjit organik të buxhetit (LOB) nr. 9936, datë 26.6.2008, të ndryshuar, KMF 2022–2024 materializon parimet dhe rregullat fiskale të mëposhtme:

1. Në çdo ligj vjetor të buxhetit, fillestar apo të rishikuar, si dhe në planifikimet e buxhetit afatmesëm, raporti i borxhit publik ndaj produktit të brendshëm bruto do të planifikohet më i ulët se niveli i vlerësuar për vitin pararendës, deri atëherë kur niveli i borxhit të arrijë dhe qëndrojë poshtë nivelit 45 për qind të produktit të brendshëm bruto.

Në përputhje me këtë dispozitë (rregull fiskale) të LOB-së, KMF 2022–2024 ***targeton çdo vit një nivel të borxhit publik total, në përqindje të PBB-së më të ulët se sa niveli i vitit pararendës.***

2. Vlera e produktit të brendshëm bruto, nominale, në lek, e cila do të përdoret për llogaritjen e raportit të borxhit publik ndaj produktit të brendshëm bruto për vitet buxhetore që planifikohen dhe për vitin pararendës, nuk mund të jetë më e lartë se vlera respektive e parashikuar ose vlerësuar në raportin "Perspektiva ekonomike botërore" (World Economic Outlook), të Fondit Monetar Ndërkombëtar, më i fundit i publikuar në kohën kur ligji vjetor i buxhetit dorëzohet për miratim në Kuvend. Kjo dokumentohet qartësisht në relacionin shoqërues të ligjit vjetor të buxhetit.

Në përputhje me këtë dispozitë (rregull fiskale) të LOB-së, KMF 2022–2024 **bazohet në projeksionet e mëposhtme të PBB-së nominale, të cilat paraqiten në mënyrë krahasimore kundrejt projeksioneve më të fundit të FMN-së. Në këtë rast, sipas shënimit të bërë në WEO, më të fundit të publikuar në muajin tetor 2020, ku thuhet se "Projeksionet WEO u përgatitën përpara fillimit të misionit të artikullit IV, që përfundoi më datë 11 tetor 2021, dhe kështu nuk pasqyrojnë përditësimet e bëra gjatë misionit", për referencë janë marrë shifrat e PBB-së nominale të misionit më të fundit të FMN-së (misioni i artikullit IV, i kryer në tetor 2021).**

Parashikimet e PBB nominale të MFE dhe FMN (në miliardë Lekë)

	2019	2020	2021 Para.	2022 Para.	2023 Para.	2024 Para.
MFE	1,691.7	1,617.5	1,769.3	1,867.4	1,964.8	2,070.9
FMN	1,691.7	1,617.5	1,769.3	1,867.5	1,964.9	2,071.0
Diferenca MFE - FMN (Diferenca e vlerave të parashikuara duhet të jetë jo më e madhe se zero)	0.0	0.0	0.0	-0.2	-0.2	-0.1

3. Në çdo vit buxhetor të planifikuar duhet të përfshihet një kontingjencë e veçantë, prej jo më pak se 0.7 përqindësh e shpenzimeve totale të buxhetit, për të kompensuar rreziqe potenciale nga luhatjet në kurset e këmbimit ose normat e interesit, me ndikim në nivelin e borxhit.

Në përputhje me këtë dispozitë (rregull fiskale) të LOB-së, kuadri 2022–2024 përfshin për çdo vit në një zë të veçantë të tij, emërtuar *"Kontigjencë për luhatjet e normave të interesit etj."*, ***një kontigjencë prej mbi 0.7 përqindësh e shpenzimeve totale***.

4. Të ardhurat nga privatizimi nuk janë pjesë e procesit të programimit buxhetor. Në rastet e arkëtimit ato përdoren, jo më pak se 50 përqind për uljen e borxhit publik dhe pjesa tjetër për investime publike. Pas arritjes së nivelit të borxhit publik, sipas përcaktimeve të shkronjës "a", të pikës 1, të nenit 4/1 të ligjit organik të buxhetit nr. 57/2016, përdorimi i të ardhurave të arkëtuara nga privatizimet përcaktohet në ligjin vjetor të buxhetit.

Në përputhje me këtë dispozitë (rregull fiskale) të LOB-së, kuadri 2022–2024 ***nuk përfshin të hyra nga privatizimet e mundshme***.

5. Masa e deficitit buxhetor nuk mund të tejkalojë masën e shpenzimeve kapitale të parashikuara çdo vit në ligjin e buxhetit.

Në përputhje me këtë dispozitë (rregulla fiskale – "rregulla e artë") të LOB-së, deficiti i targetuar në kuadrin 2022–2024 ***është çdo vit më i ulët se sa shpenzimet kapitale të planifikuara.*** Rjedhimisht, balanca korrente e targetuar është pozitive prej mesatarisht 2.4 përqindësh të PBB-së në çdo vit të programuar.

6. Në çdo vit buxhetor, që prej vitit 2024 e në vijim, balanca primare faktike nuk mund të rezultojë negative, pra duhet të jetë të paktën e balancuar ose pozitive (suficit primar).

Në përputhje me këtë dispozitë, kuadri 2022–2024 **targeton një balancë primare të balancuar në vitin 2023 me 0.0 për qind dhe 0.3 për qind në vitin 2024**.

1. Linku për raportin WEO: https://www.imf.org/en/Publications/WEO/Issues/2021/10/12/world-economic-outlook-october-2021

4.2 Implementimi i buxhetit për vitin 2021

Të ardhurat totale të mbledhura për periudhën **janar–nëntor 2021** ishin rreth 458 miliardë lekë, duke shënuar një rritje prej 19.4% ose 67.4 miliardë lekësh më shumë se një vit më parë. Të ardhurat nga grantet arritën në 9 miliardë lekë ose 44% të planit vjetor dhe 3.6 miliardë lekë më shumë se e njëjta periudhë e një viti më parë. Të ardhurat e mbledhura nga Drejtoria e Përgjithshme e Doganave (DPD) dhe Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve (DPT), përfshirë kontributet sociale të mbledhura nga DPT për periudhën janar–nëntor 2021, ishin 400.4 miliardë lekë, me një realizim prej 105.6% të planit. dhe 17.9% ose 60.8 miliardë lekë më shumë se e njëjta periudhë e vitit të kaluar. Krahasuar me vitin e kaluar, të ardhurat shënuan rritje, si rezultat i ecurisë pozitive në mbledhjen e detyrimeve doganore dhe tatimore nga administratat përkatëse, duke reflektuar në këtë mënyrë rimëkëmbjen e ekonomisë së vendit tonë pas krizës dhe pasojat e shkaktuara nga tërmeti i vitit 2019 dhe pandemia COVID-19, e shoqëruar me rritje konomike.

Tabelë 4.2.1 Të ardhurat totale nga tatimet dhe doganat (në milionë lekë)

Lloji i taksës	Fakt 11M 2021	Plan 11M 2021	Diferenca fakt/plan 2021	
			VLERA	%
Totali i TVSH-së neto	144,274	136,861	7,413	5.4%
Tatimi mbi fitimin	30,670	29,790	880	3.0%
Akciza	46,608	44,790	1,818	4.1%
Tatimi mbi të ardhurat personale	36,074	37,386	-1,312	-3.5%
Totali i taksave kombëtare	38,483	34,578	3,905	11.3%
Taksa doganore	6,700	5,877	823	14.0%
TOTALI TAKSA + DOGANA	**302,809**	**289,282**	**13,527**	**4.7%**
Kontributet e mbledhura	97,542	89,705	7,837	8.7%
TOTALI GDC + GDT (Kontribute)	**400,351**	**378,987**	**21,364**	**5.6%**

Burimi: Ministria e Financave dhe Ekonomisë (2021)

Faktorët kryesorë që kanë ndikuar në ecurinë 11-mujore kundrejt planit janë:

- Vaksinimi i shpejtë i popullsisë, hapja graduale e ekonomisë dhe sezoni veror, ringjallja e turizmit dhe të gjithë sektorëve të tjerë të ekonomisë që lidhen drejtpërdrejt ose indirekt me turizmin, ndikuan pozitivisht në rritjen ekonomike dhe të ardhurat që ekonomia ka krijuar për buxhetin e shtetit.
- Ecuria pozitive e sektorit të ndërtimit, duke përfshirë rindërtimin, për shkak të pasojave të tërmetit, kanë rritur xhiron, importet, prodhimin vendës dhe të ardhurat buxhetore.
- Rritja e të ardhurave doganore si rezultat i rritjes së vëllimit të importeve dhe e rritjes së çmimeve në tregjet ndërkombëtare.

Të ardhurat nga Drejtoria e Përgjithshme e Doganave arritën në 172.3 miliardë lekë, me një realizim prej 112.3% të planit. Krahasuar me të njëjtën periudhë të vitit 2020, janë arkëtuar 25.6%, ose 35.1 miliardë lekë më shumë.

Tabelë 4.2.2 Të ardhurat e mbledhura nga Drejtoria e Përgjithshme e Doganave (në milionë lekë)

Lloji i taksës	Fakt 11 M 2021	Plan 11 M 2021	Diferenca fakt/plan 2021	
			Vlera	%
TVSH në import	116,811	100,612	16,199	16.1%
Akciza	46,608	44,790	1,818	4.1%
Të drejtat e autorit	2,208	2,211	-3	-0.1%
Taksa doganore	6,700	5,877	823	14.0%
TOTAL DPD	**172,327**	**153,490**	**18,837**	**12.3%**

Burimi: Ministria e Financave dhe Ekonomisë (2021)

Të ardhurat nga tatimi mbi vlerën e shtuar nga importet janë 116.8 miliardë lekë me një realizim 116.1% të planit me një rritje prej 26.9 miliardë lekësh ose 29.9% krahasuar me të njëjtën periudhë të vitit të kaluar. Ecuria e TVSH-së në importe ndikohet nga disa faktorë, si:

- Rritje e volumit të importeve, e cila ka sjellë një rritje të të ardhurave me 135.6 miliardë lekë ose 31.7% më shumë krahasuar me 11-mujorin e 2020-ës.
- Rritje e çmimeve të karburanteve në tregjet ndërkombëtare krahasuar me vitin 2020, të cilat zënë një peshë të konsiderueshme prej rreth 15% në strukturën e TVSH-së në importe, duke dhënë një efekt pozitiv prej 1.8 miliardë lekësh.

Të ardhurat nga akciza janë 46.6 miliardë lekë, me një realizim 104.1% të planit ose 16.5% më shumë se e njëjta periudhë e vitit 2020. Ecuria e akcizës për periudhën janar–nëntor ndikohet nga disa faktorë:

- Rritje e sasisë së karburanteve të importuara me 17.1% krahasuar me një vit më parë, duke sjellë një efekt pozitiv në akcizë me +3.4 miliardë lekë.
- Rritje e importit të cigareve, me 8.9% krahasuar me një vit më parë, duke sjellë një efekt pozitiv në akcizë me +2.4 miliardë lekë.

Akciza e rimbursuar është 271 milionë lekë ose 49% e akcizës së rimbursuar në të njëjtën periudhë të vitit 2020.

Ecuria e të ardhurave nga renta minerale gjatë periudhës janar–nëntor 2021 ishte 2.2 miliardë lekë me një realizim në masën 99.9% të planit, duke shënuar një rritje prej 32.3% ose 539 milionë lekësh më shumë se e njëjta periudhë e vitit të kaluar. Performanca e tarifave të minierave është ndikuar nga disa faktorë, si:

- Rritje e çmimit të naftës bruto në tregjet ndërkombëtare, me efekt 507.8 milionë lekë, por edhe i shoqëruar me rritje të sasisë së naftës bruto të eksportuar me 2.8% më shumë se vitin e kaluar me efekt +35.2 milionë lekë.

- Rritje e sasisë së mineraleve të eksportuara është shoqëruar me një rritje të lehtë të çmimit të mineraleve në tregjet ndërkombëtare, me efekt 21.7 milionë lekë.

Të ardhurat nga taksat doganore ishin 6.7 miliardë lekë, me një realizim prej 114% të planit dhe 19.5% ose 1.1 miliardë lekë më shumë se e njëjta periudhë e një viti më parë.

Grafik 4.2.1: Kontribuesit kryesorë të të ardhurave doganore (janar–nëntor 2021/2020)



Burimi: Ministria e Financave dhe Ekonomisë (2021)

Të ardhurat e mbledhura nga Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve (duke përfshirë kontributet e sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore të mbledhura nga DPT) për periudhën janar–nëntor 2021 janë 228 miliardë lekë, me një realizim 101.1% të planit dhe 12.7% ose 25.7 miliardë lekë më shumë se në të njëjtën periudhë të një viti më parë. Tabela e mëposhtme tregon të dhëna të detajuara mbi performancën tatimore:

Tabelë 4.2.3 Të ardhurat e mbledhura nga DPT (në milionë lekë)

Lloji i taksës	Fakt 11 M 2021	Plan 11M 2021	Diferenca Fakt/Plan 2021	
			vlera	%
TVSH NETO	27,463	36,250	-8,787	-24.2%
TVSH e mbledhur	49,768	52,150	-2,382	-4.6%
Rimbursimi i TVSH-së	22,305	15,900	6,405	40.3%
Tatimi mbi fitimin	30,670	29,790	880	3.0%
Tatimi mbi të Ardhurat Personale	36,074	37,386	-1,312	-3.5%
Taksat nacionale	36,275	32,366	3,909	12.1%
Total	130,482	135,792	-5,310	-3.9%
Kontributet	97,542	89,705	7,837	8.7%
TOTAL GDC + Contributions	**228,024**	**225,497**	**2,527**	**1.1%**

Burimi: Ministria e Financave dhe Ekonomisë (2021)

Të ardhurat neto nga TVSH janë 27.5 miliardë lekë, me një realizim 75.8% kundrejt planit dhe 83 milionë lekë ose 0.3% më pak se 11-mujori 2020. Në periudhën janar–nëntor 2021, shuma e TVSH-së së rimbursuar është 22.3 miliardë lekë, rreth 52.8% ose 7.7 miliardë lekë më shumë se e njëjta periudhë e vitit 2020. Ecuria e të ardhurave nga TVSH është ndikuar ndjeshëm nga rritja e rimbursimeve, të cilat për 11-mujorin 2021 arritën në 22.3 miliardë lekë, 6.4 miliardë lekë ose 40.3% më shumë se plani i rimbursimit të TVSH-së për 11-mujorin 2021. Sektorët me kontributin më të madh në të ardhurat nga TVSH-ja, krahasuar me 11-mujorin 2020 janë tregtia, ndërtimi dhe shërbimet. sektorët.

Grafik 4.2.2 Ecuria e TVSH-së gjatë 11-mujorit 2021 (në milionë lekë)



Grafik 4.2.3 Rimbursimet e TVSH-së gjatë 11 muajve 2021 (në milionë lekë)



Burimi: Ministria e Financave dhe Ekonomisë (2021)

Të ardhurat nga tatimi mbi fitimin janë realizuar në vlerën 30.7 miliardë lekë me një realizim 103% të planit, duke shënuar një rritje prej 23.6% ose 5.9 miliardë lekësh më shumë se e njëjta periudhë e një viti më parë. Nga analiza e tatimit mbi fitimin sipas sektorëve rezulton sektori i shërbimeve me një rritje prej 24% krahasuar me 11-mujorin 2020, sektori i ndërtimit me një rritje prej 47% krahasuar me të njëjtën periudhë të një viti më parë dhe sektori i tregtisë, me një rritje prej 23% krahasuar me vitin e kaluar.

Grafik 4.2.4 Ecuria e tatimit mbi fitimin ndër vite për një periudhë 11-mujore (në milionë lekë)



Burimi: Ministria e Financave dhe Ekonomisë (2021)

Të ardhurat nga tatimi mbi të ardhurat personale janë realizuar me 36.1 miliardë lekë, me një realizim prej 96.5% të planit me një rritje prej 7.1% ose 2.4 miliardë lekë krahasuar me vitin 2020. Ndikim të rëndësishëm në të ardhurat nga tatimi mbi të ardhurat personale kanë pasur:

- Të ardhurat nga tatimi mbi tatimin mbi të ardhurat vjetore individuale me një rritje prej 93% krahasuar me 11-mujorin 2020.
- Të ardhurat dhe aksionet nga tatimi në dividend me një rritje prej 51% krahasuar me 11-mujorin 2020.

Grafik 4.2.5 Të ardhurat nga Tatimi mbi të Ardhurat Personale gjatë viteve për periudhën 11-mujore (milionë lekë)



Burimi: Ministria e Financave dhe Ekonomisë (2021)

Të ardhurat nga taksa kombëtare për vitin 2021 ishin 33.1 miliardë lekë, me një realizim prej 112.1% të planit.

Grafiku 4.2.6 Ecuria e taksës kombëtare ndër vite për periudhën 11-mujore (në milionë lekë)



Burimi: Ministria e Financave dhe Ekonomisë (2021)

Të ardhurat nga kontributet e mbledhura nga DPT arritën vlerën 97.5 miliardë lekë, 8.7%, ose 7.8 miliardë lekë më shumë se plani dhe një rritje prej vetëm 13.3% ose 11.4 miliardë lekë krahasuar me të njëjtën periudhë të vitit 2020.

Ecuria 11-mujore 2021 e treguesve kryesorë të shpenzimeve buxhetore

Shpenzimet e përgjithshme publike për periudhën njëmbëdhjetëmujore të vitit 2021, arritën në rreth 491.4 miliardë lekë, me një realizim në masën 89.7 për qind të planit të periudhës, ndërsa krahasuar me të njëjtën periudhë të vitit 2020 ky zë ka rezultuar 7.8 për qind më i lartë ose rreth 35.7 miliardë lekë më shumë. Në terma vjetorë, shpenzimet e përgjithshme për 11-mujorin e vitit 2021 u realizuan në masën 82.9 për qind të planit vjetor sipas buxhetit fillestar dhe 80.5 për qind të planit vjetor të ndryshuar me aktin normativ nr. 26, datë 22.6.2021 (AN nr. 26).

Tabela 4.2.4 Treguesit fiskalë të konsoliduar për 10-mujorin e vitit 2021 (në milionë lekë)

Emërtimi	Nëntor 2021				Viti 2021			
	Plan	Fakt	Fakt-Plan	në % mbi Plan	Plani Vjetor Buxhet Fillestar	Plani Vjetor AN nr.26	% e realizimit vjetor BF	% e realizimit vjetor AN nr.26
Të Ardhurat e Përgjithshme	442,731	458,383	15,652	103.5%	484,106	489,526	94.7%	93.6%
Shpenzimet e Përgjithshme	547,486	491,366	-56,120	89.7%	592,801	610,069	82.9%	80.5%
Shpenzimet Korente	*423,189*	*404,502*	*-18,687*	*95.6%*	*467,769*	*468,771*	*86.5%*	*86.3%*
Shpenzimet Kapitale	*91,160*	*63,042*	*-28,118*	*69.2%*	*93,032*	*104,298*	*67.8%*	*60.4%*
Deficit/Suficit	-104,755	-32,983	71,772	31.5%	-108,695	-120,543	30.3%	27.4%

Burimi: Ministria e Financave dhe Ekonomisë (2021)

Tabela 4.2.5 Treguesit fiskalë të konsoliduar për 11-mujorin e vitit 2020 dhe 2021 (në milionë lekë)

Emërtimi	Fakt Nëntor 2020	Nëntor 2021		Diferenca Fakt Plan 2021	Në % ndaj Plan 2021	Diferenca Fakt 2021 Fakt 2020	Në % ndaj Fakt 2020
		Plan	Fakt				
Të Ardhurat e Përgjithshme	382,842	442,731	458,383	15,652	103.5%	75,541	19.7%
Shpenzimet e Përgjithshme	455,687	547,486	491,366	-56,120	89.7%	35,679	7.8%
Shpenzimet Korente	*378,922*	*423,189*	*404,502*	*-18,687*	*95.6%*	*25,580*	*6.8%*
Shpenzimet Kapitale	*63,908*	*91,160*	*63,042*	*-28,118*	*69.2%*	*-866*	*-1.4%*
Deficit/Suficit	-72,845	-104,755	-32,983	71,772	31.5%	39,862	-54.7%

Burimi: Ministria e Financave dhe Ekonomisë (2021)

Shpenzimet korrente për periudhën 11-mujore të vitit 2021 rezultuan në rreth 404.5 miliardë lekë, ndërsa krahasuar me të njëjtën periudhë të një viti më parë ky zë ka rezultuar 6.8 për qind më i lartë ose rreth 25.6 miliardë lekë më shumë. Në terma vjetorë, shpenzimet korrente për 11-mujorin e vitit 2021 u realizuan në masën 86.5 për qind të planit vjetor sipas buxhetit fillestar dhe 86.3 për qind të planit vjetor të ndryshuar me aktin normativ nr. 26.

Zërat kryesorë që ndikuan në nivelin e realizimit të shpenzimeve korrente kundrejt planit 11-mujor janë përkatësisht:

- *Shpenzimet për fonde speciale:* 100 për qind të planit të periudhës, 90.5 për qind të planit vjetor fillestar dhe 91.2 për qind të planit vjetor të ndryshuar me AN-në nr. 26.
- *Shpenzimet operative mirëmbajtje:* 97.1 për qind të planit të periudhës, 92.2 për qind të planit vjetor fillestar dhe 88.5 për qind të planit vjetor të ndryshuar.
- *Shpenzimet e tjera sociale:* 96.6 për qind të planit të periudhës, 88.7 për qind të planit vjetor fillestar dhe të ndryshuar.

Analiza e detajuar e zërave kryesorë të shpenzimeve korrente dhe kapitale paraqitet si më poshtë vijon:

Grafiku 4.2.6 Struktura e shpenzimeve korrente



Burimi: Ministria e Financave dhe Ekonomisë (2021)

- Shpenzimet e Personelit për periudhën 11-mujore të vitit 2021, përfaqësuan 18.7 për qind të totalit të shpenzimeve korrente. Niveli i shpenzimeve faktike të personelit prej rreth 75.5 miliardë lekësh, realizon nivelin e parashikuar për këtë zë në planin e periudhës 11-mujore në masën 91.4 për qind. Krahasuar me

të njëjtën periudhë të vitit 2020, ky zë është 8.3 për qind më i lartë ose rreth 5.76 miliardë lekë më shumë. Në terma vjetorë ky zë rezulton 82.2 për qind e planit vjetor fillestar dhe 82.9 për qind të planit vjetor të ndryshuar.

- Shpenzimet për paga për periudhën 11-mujore të vitit 2021 u realizuan në masën rreth 64.5 miliardë lekë ose 99.5 për qind të planit të periudhës. Krahasuar me të njëjtën periudhë të vitit 2020, ky zë rezulton 8.1 për qind më i lartë ose rreth 4.8 miliardë lekë më shumë. Në terma vjetorë, shpenzimet për paga rezultojnë 90.8 për qind e planit vjetor fillestar dhe 91.1 për qind të planit vjetor të ndryshuar.

- Shpenzimet për sigurime shoqërore rezultuan në rreth 10.4 miliardë lekë ose 98.2 për qind të planit të periudhës. Krahasuar me të njëjtën periudhë të vitit 2020, ky zë rezulton 8.4 për qind më i lartë ose 811 milionë lekë më shumë. Në terma vjetorë, shpenzimet për sigurime shoqërore rezultojnë 89.2 për qind e planit vjetor fillestar dhe 89.6 për qind të planit vjetor të ndryshuar.

- Shpenzimet për interesa për periudhën 11-mujore të vitit 2021 kanë përfaqësuar 8.5 për qind të shpenzimeve korrente. Niveli faktik i tyre prej rreth 34.4 miliardë lekësh ka rezultuar në masën 93.9 për qind të planit të periudhës. Në raport me planin vjetor fillestar dhe të ndryshuar, në nivel 11-mujori këto shpenzime janë realizuar në masën 78.6 për qind të tij, ndërsa krahasuar me të njëjtën periudhë të vitit 2020, ky zë ka rezultuar 5.6 për qind më i lartë ose rreth 1.8 miliardë lekë më shumë.

- Shpenzimet operative dhe mirëmbajtje, gjatë periudhës 11-mujore të vitit 2021, kanë shënuar një realizim në masën rreth 46 miliardë lekë ose 97.1 për qind të planit të periudhës. Niveli faktik i tyre ka rezultuar në masën 92.2 për qind të planit vjetor fillestar dhe 88.5 për qind të planit vjetor ndryshuar me AN nr. 26. Krahasuar me të njëjtën periudhë të vitit 2020, ky zë ka rezultuar 12.5 për qind më i lartë ose rreth 5.1 miliardë lekë më shumë.

- Shpenzimet për subvencione, gjatë periudhës 10-mujore të vitit 2021, përfaqësuan 0.2 për qind të totalit të shpenzimeve korrente. Niveli faktik i tyre rezultoi në masën 838 milionë lekë, me një realizim në masën 75.8 për qind të planit të periudhës. Në terma vjetorë ky zë rezulton në masën 54.1 për qind të planit vjetor fillestar dhe të ndryshuar. Krahasuar me të njëjtën periudhë të vitit 2020, shpenzimet për subvencione rezultojnë 8.3 për qind më të ulëta ose rreth 76 milionë lekë më pak.

- Shpenzimet për fondet speciale gjatë periudhës 11-mujore të vitit 2021 rezultuan në nivelin rreth 176.7 miliardë lekë, me një realizim prej 100 përqindësh kundrejt planit të periudhës, 90.5 për qind të planit vjetor, sipas buxhetit fillestar dhe 91.2 për qind të planit vjetor të ndryshuar. Përkatësisht:

- *Shpenzimet për sigurime shoqërore* u realizuan në masën rreth 131.1 miliardë lekë, duke rezultuar 101.3 për qind e planit të periudhës dhe 92.2 për qind e planit vjetor fillestar dhe të ndryshuar.

- *Shpenzimet për sigurime shëndetësore* u realizuan në rreth 43.9 miliardë lekë, duke rezultuar 103.8 për qind e planit të periudhës ose 92.4 për qind e planit vjetor fillestar dhe 95.1 për qind e planit vjetor të ndryshuar.

- *Shpenzimet për kompensimin e pronarëve* u realizuan në rreth 1.67 miliardë lekë, duke rezultuar 61 për qind e planit të periudhës dhe 55.5 për qind e planit vjetor fillestar dhe të ndryshuar.

Kundrejt së njëjtës periudhë të vitit 2020, shpenzimet për sigurime shoqërore janë rreth 12.9 miliardë lekë më të larta, shpenzimet për sigurime shëndetësore janë rreth 5.9 miliardë lekë më të larta dhe shpenzimet për kompensimin e pronarëve 34 milionë lekë më të ulëta.

- Shpenzimet e tjera sociale për periudhën 11-mujore të vitit 2021 rezultuan në rreth 25.45 miliardë lekë, me një realizim prej 96.6 përqindësh të planit të periudhës ose 88.7 për qind të planit vjetor fillestar dhe të ndryshuar. Respektivisht:

- *Shpenzimet për papunësinë* për 11-mujorin e vitit 2021 janë realizuar në masën 895 milionë lekë ose 116.9 për qind e planit të periudhës dhe 111.9 për qind e planit vjetor fillestar dhe të ndryshuar. Kundrejt së njëjtës periudhë të vitit 2020 shpenzimet për këtë zë rezultojnë me një rritje në masën 11.6 për qind ose 93 milionë lekë më shumë.

- *Shpenzimet për ndihmën ekonomike dhe pagesën e paaftësisë* për periudhën 11-mujore të vitit 2021 u realizuan në masën rreth 20.9 miliardë lekë, duke rezultuar 92.5 për qind e planit të periudhës. Në raport me planin vjetor fillestar dhe të ndryshuar, ato janë realizuar në masën 84.5 për qind të tij. Kundrejt së njëjtës periudhë të vitit 2020 shpenzimet për këtë zë rezultojnë pothuajse në të njëjtin nivel.

- *Shpenzimet për kompensimin e ish-të përndjekurve politikë* për periudhën 11-mujore të vitit 2021 u realizuan në masën 690 milionë lekë ose 78.2 për qind të planit të periudhës dhe 69 për qind të planit vjetor fillestar dhe të ndryshuar. Krahasuar me të njëjtën periudhë të vitit 2020, shpenzimet për këtë zë rezultojnë me një ulje në masën 26.5 për qind ose 248 milionë lekë më pak.

- *Shpenzimet për bonusin e lindjeve* për periudhën 11-mujore të vitit 2021 u realizuan në masën 3 miliardë

lekë, duke rezultuar 139.5 për qind e planit të periudhës ose 136.4 për qind e planit vjetor fillestar dhe të ndryshuar. Kundrejt së njëjtës periudhë të vitit 2020 shpenzimet për këtë zë rezultojnë me një rritje prej 19 përqindësh ose 480 milionë lekë më shumë.

- Shpenzimet për pushtetin vendor gjatë 11-mujorit 2021, përfaqësuan 11.2 për qind të totalit të shpenzimeve korrente. Niveli i tyre aktual prej rreth 45.5 miliardë lekësh, përfaqëson 86.8 për qind realizim të nivelit të parashikuar për këtë zë në 11-mujor, në ose 80 për qind të planit vjetor, sipas buxhetit fillestar dhe 78.6 për qind të planit vjetor të ndryshuar. Krahasuar me të njëjtën periudhë të vitit 2020, ky zë rezultoi 12 për qind më i ulët ose rreth 6.19 miliardë lekë më pak, por në vitin 2020 shpenzimet për pushtetin vendor gjatë njëmbëdhjetëmujorit përfshinin edhe shpenzimet për fondin e rindërtimit, i cili gjatë njëmbëdhjetëmujorit të vitit 2021 rezulton të jetë 14 miliardë lekë.

Shpenzimet kapitale për periudhën 11-mujore të vitit 2021 kanë një realizim në masën rreth 63.04 miliardë lekë ose 69.2 për qind në raport me fondet e planifikuara për këtë periudhë. Krahasuar me të njëjtën periudhë të vitit 2020, ky zë është 1.4 për qind më i ulët ose 866 milionë lekë më pak. Respektivisht:

- *Financimi i brendshëm* ka shënuar një realizim prej rreth 40.5 miliardë lekësh ose 67 për qind të planit të periudhës. Krahasuar me të njëjtën periudhë të vitit 2020, ky zë ka rezultuar 3.8 për qind më i ulët ose rreth 1.6 miliardë lekë më pak.

- *Investimet nga të ardhurat e arsimit të lartë* janë realizuar në masën 629 milionë lekë ose 74.2 për qind të planit të periudhës. Krahasuar me të njëjtën periudhë të vitit 2020, ky zë ka rezultuar 30.1 për qind më i ulët ose 271 milionë lekë më pak.

- *Financimi i huaj* ka shënuar një realizim prej rreth 21.9 miliardë lekësh ose 73.4 për qind të planit të periudhës. Krahasuar me të njëjtën periudhë të vitit 2020, ky zë ka rezultuar 4.8 për qind më i lartë ose rreth 1 miliardë lekë më shumë.

Në terma vjetorë, shpenzimet kapitale janë realizuar në masën 67.8 për qind të planit vjetor fillestar dhe 60.4 për qind të planit vjetor të ndryshuar me AN nr. 26. Konkretisht:

- *Financimi i brendshëm* është realizuar në masën 70.3 për qind të planit vjetor fillestar dhe 58.8 për qind të planit vjetor të ndryshuar;

- *Investimet nga të ardhurat e arsimit të lartë* kanë rezultuar 62.9 për qind të planit vjetor fillestar dhe të ndryshuar.

- *Financimi i huaj* është realizuar në masën 63.6 për qind të planit vjetor fillestar dhe të ndryshuar.

Fondi i rindërtimit për 11-mujorin e vitit 2021 ka rezultuar rreth 23.16 miliardë lekë nga rreth 25.3 miliard të planifikuara për këtë periudhë, duke rezultuar 91.5 për qind e planit të periudhës. Nga ky realizim 11-mujor i fondit të rindërtimit rreth 14.02 miliardë lekë janë shpenzime nga qeverisja vendore dhe rreth 9.14 miliardë lekë nga qeverisja qendrore. Për periudhën 11-mujore, shpenzimet për fondin e rindërtimit përbëjnë 4.71 për qind të totalit të shpenzimeve të përgjithshme. Në terma vjetorë, këto shpenzime rezultojnë 82.7 për qind e planit vjetor fillestar dhe të ndryshuar.

Niveli i deficitit për periudhën 11-mujore të vitit 2021 rezultoi në rreth 33 miliardë lekë ose rreth 39.9 miliardë lekë më pak se e njëjta periudhë e një viti më parë. Për periudhën 11-mujore niveli i deficitit rezulton 31.5 për qind e planit të periudhës prej rreth 104.76 miliardë lekësh. Në terma vjetorë, niveli i deficiti është realizuar 30.3 për qind e planit vjetor fillestar dhe 27.4 për qind e planit vjetor të ndryshuar.

Tabelë 4.2.6 Zërat kryesorë të shpenzimeve të përgjithshme publike për 11-mujorin e vitit 2021 (në milionë lekë)

		Fakt Nëntor 2021	Plan vjetor - Buxhet Fillestar 2021	Plan vjetor i ndryshuar - AN nr. 26	% e realizimit (Fakt Nëntor/Plan vjetor Buxhet Fillestar)	% e realizimit (Fakt Nëntor/ Plan vjetor i ndryshuar AN nr.26)
1	Totali i Shpenzimeve	**491,366**	**592,801**	**610,069**	**82.9%**	**80.5%**
1.1	Shpenzime Korente	**404,502**	**467,769**	**468,771**	**86.5%**	**86.3%**
	Personeli	*75,519*	*91,834*	*91,139*	82.2%	82.9%
	Interesat	*34,447*	*43,800*	*43,800*	78.6%	78.6%
	Operative dhe Mirëmbajtje	*45,983*	*49,888*	*51,941*	92.2%	88.5%
	Subvencionet	*924*	*1,550*	*1,550*	59.6%	59.6%
	Shpenzime për fondet speciale	*176,699*	*195,171*	*193,801*	90.5%	91.2%
	Buxheti vendor	*45,475*	*56,826*	*57,840*	80.0%	78.6%
	Shpenzime të tjera sociale	*25,455*	*28,700*	*28,700*	88.7%	88.7%
1.2	Transferime kapitale	**200**				
1.3	Fondi Rezervë/Kontigjenca	**461**	**4,000**	**9,000**	**11.5%**	**5.1%**
1.4	Shpenzime Kapitale	**63,042**	**93,032**	**104,298**	**67.8%**	**60.4%**
	Financim i brendshëm	*40,511*	*57,604*	*68,870*	70.3%	58.8%
	Financim i huaj	*21,902*	*34,428*	*34,428*	63.6%	63.6%
	Investime nga të ardhurat e Arsimit të Lartë	*629*	*1,000*	*1,000*	62.9%	62.9%
1.5	Fondi i Rindërtimit	**23,161**	**28,000**	**28,000**	**82.7%**	**82.7%**

Burimi: Ministria e Financave dhe Ekonomisë (2021)

Masat e marra anti-COVID-19 – Financimi nga fondi rezervë i buxhetit të shtetit, për vitin 2021

Sipas ligjit nr. 137/2020, "Për buxhetin e vitit 2021", të ndryshuar, në buxhetin e MSHMS-së janë planifikuar fonde në një vlerë prej rreth 6 miliardë lekësh, për t'u përdorur në kuadër të masave të marra kundër pandemisë COVID-19.

Nëpërmjet VKM-së nr. 85, datë 10.2.2021, "*Për një shtesë në VKM-në nr. 597, datë 4.9.2019, "Për përcaktimin e procedurave, dokumentacionit dhe masës mujore të ndihmës ekonomike dhe përdorimit të fondeve shtesë mbi fondin e kushtëzuar për ndihmën ekonomike*", në kuadër të masave anti-COVID-19, u miratua dyfishimi i shumës së ndihmës ekonomike për gjashtëmujorin e parë të vitit 2021.

Ndërkohë, nëpërmjet miratimit të katër akteve normative të buxhetit të vitit 2021, me qëllim përballimin e shpenzimeve për blerjen e vaksinave të nevojshme për popullsinë është rritur masa e fondit rezervë të buxhetit të shtetit për vitin 2021. Kështu, fondi rezervë i parashikuar në ligjin fillestar prej 2 miliardë lekësh të planifikuar për financimin e rasteve të paparashikuara, me miratimin e katër akteve normative u ndryshua në vlerën 8 miliardë lekë.

Fondi rezervë i buxhetit të shtetit, në zbatim të VKM-ve të miratuara, është përdorur në vlerën rreth 4.1 miliardë lekë për masat shtesë në luftën kundër COVID-19 dhe për blerjen e vaksinave të nevojshme për vaksinimin e popullatës.

Konkretisht, shuma e fondeve të miratuara për blerjen e vaksinave është 3.5 miliardë lekë, nga të cilat janë përdorur 3.4 miliardë lekë ose 98% e fondit total të akorduar për këtë qëllim. Për financimin e masave të tjera për përballimin e shpenzimeve COVID-19 janë miratuar rreth 0.6 miliardë lekë, nga të cilat janë përdorur 0.5 miliardë lekë ose 87% e totalit të fondeve.

Më poshtë, do të gjeni tabelën *"Masat COVID-19 – Financimi nga fondi rezervë i buxhetit të shtetit, për vitin 2021"*, që përfaqëson fondet e akorduara dhe të realizuara nga fondi rezervë i buxhetit të shtetit, në kuadër të masave anti-COVID-19.

TABELA " MASAT COVID19 - Financimi nga fondi rezervë i buxhetit të shtetit, për vitin 2021"

(in 000 ALL)

Nr.	Përfitues	VKM / Akt Normativ	Përshkrimi	Vaksinat		Masa të tjera Anti Covid-19	
				Plan	Fakt	Plan	Fakt
1	Ministria e Shendetesise dhe Mbrojtjes Social	AN no.3, dt 10.01.2021 i ndryshuar & VKM no.32 dt 20.01.2021 & VKM no. 490, dt 30.07.2021 & VKM no. 545, dt. 29.09.2021	"Për përdorimin e fondit rezervë me qëllim kryerjen e parapagimit të dozave të vaksinave dhe pagesat respektive që rrjedhin nga marrëveshja e nënshkruar për "Prodhimin dhe furnizimin ndërmjet Pfizer export b.v. dhe Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, Ministrit të Shtetit për Rindërtimin dhe Institutit të shëndetit publik", miratuar me ligjin nr. 3, datë 18.01.2021 "Për kryerjen e pagesës së dozave të vaksinave dhe të pagesave respektive që rrjedhin nga marrëveshja e nënshkruar për prodhimin dhe furnizimin, ndërmjet Pfizer export B.V dhe Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, ministrit të Shtetit për Rindërtimin dhe Institutit të Shëndetit Publik, të miratuar me aktin normativ nr. 3, datë 18.1.2021, të Këshillit të Ministrave dhe me ligjin nr. 3/2021.	1,357,770	3,418,712		
2	Ministria e Shendetesise dhe Mbrojtjes Social	AN no.8 dt 22.03.2021 & AN no.9 dt. 22.03.2021 & VKM no.174 dt 24.03.2021	"Për kryerjen e pageses së dozave të vaksinave që rjedh nga marreveshjes se nenshkruar midis MSHMS, ministrit te shtetit per rindertimin dhe Institutit te Shendetit Publik dhe distributorit te autorizuar "Keymen Ilac Sanayi ve Ticaret" AS per furnizimin e RSH me vaksinen e inaktivizuar kunder COVID-19 Coronavac te krijuar nga Sinovac Life Science Co Ltd, dhe te prodhuar ne RK	1,046,000			
3	Ministria e Shendetesise dhe Mbrojtjes Social	AN no.16 dt 07.04.2022 & VKM no. 328, dt. 02.06.2021	"Për kryerjen e pagesës së dozave të vaksinave që rrjedh nga marrëveshja ndërmjet "Human vaccine" Ilc dhe Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale të Shqipërisë, Ministrit të Shtetit për Rindërtimin të Shqipërisë, dhe Institutit të Shëndetit Publik për furnizimin e Republikës së Shqipërisë me vaksinën kundër Covid-19 "Sputnik V", të zhvilluar nga Instituti Kombëtar i Kërkimit Gamaleya për Epidemiologjinë dhe Mikrobiologjinë në Rusi",	55,505			
4	Ministria e Shendetesise dhe Mbrojtjes Social	AN no. 21 dt 19.05.2021 & VKM no. 357, dt. 16.06.2021	Per kryerjen e pagesës së dozave të vaksinave që rjedhin nga marrëveshja midis Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, Ministrit të Shtetit për Rindërtimin dhe Institutit të shëndetit publik", dhe distributorit te Autorizuar "Keymenilac Sanyi ve Ticaret A.S"	1,013,500			
5	Ministria e Financave dhe Ekonomise	VKM no.909 dt 18.11.2020 (also provided for 2021)	"Per percaktimin e procedurave, te dokumentacionit dhe te mases se perfitimit te ndihmes financiare per punonjesit dhe ish-punonjesit e rafinerise se naftes, Ballsh"			461,306	461,290
6	Ministria e Shendetesise dhe Mbrojtjes Social	VKM no 156, date 10.02.2021	"Per nje shtese fondi ne Buxhetin e vitit 2021, te miratuar per MSHMS, per Bashkine Fier"			35,000	35,000
7	Ministria e Turizmit dhe Mjedisit	VKM no. 278, date 12.05.2021	Për një shtesë fondi në buxhetin e vitit 2021, miratuar për Ministrinë e Turizmit dhe Mjedisit, për mbështetjen e promovimin të Turizmit Shqiptar në tregjet ndërkombëtare si nevojë për situatën post COVID-19",			100,000	24,120
TOTAL				3,472,774	3,418,712	596,306	520,410

Burimi: Ministria e Financave dhe Ekonomisë (2021)

Të ardhurat e buxhetit vendor

Për 11-mujorin 2021, njësitë e vetëqeverisjes vendore në shkallë vendi kanë mbledhur të ardhura në vlerën rreth 24.97 miliardë lekë, shifër kjo rreth 5.1 miliardë lekë më shumë se vlera e të ardhurave të mbledhura në të njëjtën periudhë të vitit 2020. E parë në këtë këndvështrim, rritja e efikasitetit të mbledhjes së taksave nga pushteti vendor për vitin 2021 ka ardhur si pasojë e rimëkëmbjes ekonomike pas një situate të vështirë ekonomike të shkaktuar nga pandemia globale COVID-19 gjatë vitit 2020. Në këtë drejtim, të ardhurat vendore janë rritur me rreth 26% në 11 muajt e parë të vitit 2021 krahasuar me të njëjtën periudhë të një viti më parë. Krahasuar edhe me të njëjtën periudhë të vitit 2019 (para pandemisë COVID-19), mbledhja e të ardhurave vendore në vitin 2021 shënon një rritje prej 3.1 miliardë lekësh (nga 21.8 miliardë lekë në 24.97 miliardë lekë) ose 14.4%. Sipas burimit të tyre, kanë rritje taksat vendore dhe taksat e pronës.

Shpenzimet e buxhetit vendor

Referuar treguesve fiskalë të buxhetit të konsoliduar, niveli i shpenzimeve për 11-mujorin 2021 është rreth 45.5 miliardë lekë, krahasuar me të njëjtën periudhë të vitit 2020 prej rreth 51.6 miliardë lekësh është ulur me rreth 6.19 miliardë lekë, por këtu nënvizojmë faktin se për këtë periudhë për vitin 2020, në shpenzimet e buxhetit vendor është përfshirë edhe fondi i rindërtimit. Për 11-mujorin e vitit 2021, fondi i rindërtimit i akorduar në buxhetet vendore rezulton të jetë realizuar në vlerën rreth 14 miliardë lekë (i

papërfshirë në tabelën e mëposhtme të analizës së shpenzimeve vendore). Por nëse krahasojmë 11-mujorin e vitit 2021 me 11-mujorin e 2020-ës, duke përfshirë fondin e rindërtimit më 2021-shin rezulton se shpenzimet e pushtetit vendor janë rritur me rreth 15.2%.

Tabelë 4.2.7 Të ardhurat dhe shpenzimet faktike të qeverisjes vendore sipas natyrës (në milionë lekë)

Nr.	EMËRTIMI	Fakti 11-mujor		Diferencat	
		2021	2020	2021/2020	2021/2020 në %
I.	**Të ardhura nga pushteti vendor**	**24,970**	**19,843**	**5,127**	**126%**
I.1	*Taksa mbi pasurinë*	*5,666*	*4,688*	978	121%
I.2	*Taksa e biznesit të vogël*	*374*	*373*	2	100%
I.3	*Taksa lokale*	*18,930*	*14,782*	4,148	128%
II.	**Shpenzime nga pushtetit vendor**	**45,472**	**51,663**	**-6,191**	**88%**
II.1	**Shpenzime korrente**	**36,445**	**41,119**	**-4,674**	**89%**
	Personeli	*21,905*	*20,495*	1,411	107%
	Shpenzime oper. mirëmbajtjeje	*13,287*	*12,741*	546.5	104%
	Interesa	*16*	*21*	-5	76%
	Subvencione	*125*	*124*	1	101%
	Te tjera	*1,112*	*7,739*	-6,627	14%
II.2	**Shpenzime kapitale**	**9,027**	**10,544**	**-1,517**	**86%**

Burimi: Ministria e Financave dhe Ekonomisë (2021)

4.3 Planet buxhetore për vitin e dorëzimit të ERP-së

Totali i të ardhurave publike për vitin 2022 është planifikuar në vlerën 536.8 miliardë lekë ose 28.7% e PBB-së. Programimi i të ardhurave mbështet synimet e Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë për rimëkëmbjen fiskale, si dhe mbajtjen nën kontroll të deficitit buxhetor dhe borxhit publik. Ky parashikim bazohet në përmirësimin e administrimit fiskal dhe minimizimin e informalitetit në ekonomi, duke mbështetur kështu rimëkëmbjen ekonomike, si dhe rritjen e prodhimit dhe eksporteve.

Grantet janë planifikuar në masën 14 miliardë lekë ose 0.7% e PBB-së; të ardhurat tatimore janë planifikuar në masën 500.2 miliardë lekë ose 26.8% e PBB-së dhe të ardhurat jotatimore janë planifikuar në masën 22.7 miliardë lekë ose 1.2% e PBB-së.

Totali i shpenzimeve publike për vitin 2022 është planifikuar 637.7 miliardë lekë ose 34.1% e PBB-së.

Shpenzimet e personelit, për vitin 2022, reflektojnë koston aktuale të administratës publike, si dhe politikën e re të rritjes së pagave kryesisht për sektorët e shëndetësisë, arsimit dhe mbrojtjes. Fondi vjetor për rritjen e pagave është planifikuar në shumën 2.4 miliardë lekë dhe parashikon rritjen e pagës për funksion me 6% për punonjësit shëndetësor dhe ata arsimorë. Shpenzimet totale për pagat në administratën publike janë planifikuar në masën 91.6 miliardë lekë ose 4.9% e PBB-së.

Shpenzimet për interesa parashikohen në nivelin 50.8 miliardë lekë ose 2.7% të PBB-së, për të përballuar çdo risk të mundshëm të rritjes së normave të interesit.

Shpenzimet operative dhe të mirëmbajtjes për qeverisjen qendrore për vitin 2022 (pa përfshirë shpenzimet që realizohen nga institucione publike, që kanë si burim financimi të ardhurat jashtë limitit), janë parashikuar në masën 63.2 miliardë lekë ose rreth 3.4% e PBB-së. Në këtë zë është programuar mbështetja me prioritet e politikave ekzistuese të qeverisjes qendrore, si: blerja e vaksinave anti-COVID, skema e fermerëve, mirëmbajtja e rrugëve nacionale, programet e nxitjes së punësimit, skemat për mbështetjen e zhvillimit ekonomik dhe mbështetje për rininë dhe fëmijët.

Shpenzimet e buxhetit vendor, për vitin 2022, janë parashikuar në masën 60.3.7 miliardë lekë, me një rritje prej 3.3% më shumë se akti normativ i vitit 2021. Këto shpenzime për vitin 2022, zënë 3.2% të PBB-së nga 2.3% që zinin në vitin 2013. COVID-19, ashtu si edhe në vendet e tjera ka pasur dhe parashikohet të ketë efekte negative në rënien e ekonomisë dhe për pasojë dhe në uljen e të ardhurave buxhetore. Përballimi i një sfide të madhe ekonomike dhe buxhetore nga njësitë e vetëqeverisjes vendore, për shkak të pasojave të shkaktuara nga tërmeti dhe pandemia COVID-19 janë një tregues pozitiv i punës së zhvilluar në këto vite në drejtim të stabilitetit makroekonomik, parashikueshmërisë së fondeve dhe transparencës së përdorimit me disiplinë të fondeve buxhetore. Me qëllim ruajtjen e stabilitetit të shpenzimeve vendore dhe për mbështetjen e njësive të vetëqeverisjes vendore për përballimin e shpenzimeve të COVID-19, niveli i transfertës së pakushtëzuar për vitin 2022 do të jetë rreth 273 milionë lekë më i lartë se viti 2021. Kjo transfertë, krahasuar me vitin 2015 (viti para reformës administrativo-territoriale), është 6.3 miliardë lekë

më shumë ose rreth 54.5 për qind më e lartë. Në transfertën e pakushtëzuar të parashikuar për vitin 2022, 18.7 miliardë lekë, do të shtohen edhe fondet prej 9.3 miliardë lekësh transfertë e pakushtëzuar sektoriale për funksionet e reja, transferuar në nivel vendor, si rrjedhojë, në vitin 2022, granti nga buxheti i shtetit për pushtetin vendor do të jetë në shumën 28 miliardë lekë. Të ardhurat nga taksat dhe tarifat vendore në vitin 2021 do të jenë 27.6 miliardë lekë ose 6 për qind më të larta se sa i pritshmi i vitit 2021 dhe pothuajse mbi dy herë më të larta se ato të viteve 2013 dhe 2015.

Shpenzimet e fondeve speciale që përfshin shpenzimet totale për Fondet e sigurimeve shoqërore, shëndetësore dhe kompensimin në vlerë të ish-pronarëve, janë planifikuar në vlerën prej 212.3 miliardë lekësh. Niveli i shpenzimeve për skemën e sigurimeve shoqërore për vitin 2022, parashikohet në masën 148.9 miliardë lekësh ose 8% e PBB-së. Nga ky fond, për indeksimin e pensioneve është parashikuar niveli prej 2.6 miliardë lekësh dhe 3.5 miliardë lekësh për bonusin e fundvitit për pensionistët. Ndërsa, shpenzimet e Skemës së Sigurimeve të Kujdesit Shëndetësor për vitin 2022 janë parashikuar në masën 52.8 miliardë lekë ose 2.8% e PBB nga 46.1 miliardë lekë të planifikuara në vitin 2021.

Së fundi, shpenzimet për fondin e kompensimit në vlerë të pronarëve, parashikohen në total në masën 4.5 miliardë lekë ose 0.2% e PBB-së.

Shpenzime të tjera sociale përfshijnë fondet për pagesën e papunësisë, aftësisë së kufizuar, ndihmës ekonomike, dëmshpërblimin e ish-të përndjekurve politikë dhe bonusin e lindjeve.

- Shpenzimet për pagesën e papunësisë parashikohen në nivelin 900 milionë lekë.
- Shpenzimet për pagesën e ndihmës ekonomike dhe aftësisë së kufizuar parashikohen në nivelin 23.5 miliardë lekë ose 1.3% e PBB-së.
- Për ish-të përndjekurit është parashikuar një fond prej 1 miliardë lekësh ose 0.1% e PBB-së.
- Për bonusin e lindjeve është parashikuar një fond prej 2.2 miliardë lekësh ose 0.1% e PBB-së.

Shpenzimet për subvencione janë parashikuar në masën 1.55 miliardë lekë, duke u rritur krahasuar me një vit më parë. Këto shpenzime shkojnë për mbështetjen e sektorit të ujësjellës-kanalizimeve, bazuar në performancën e tij, si dhe për të mbuluar një pjesë të shpenzimeve të veprimtarisë hekurudhore dhe veprimtarisë së shërbimeve qeveritare.

Niveli i fondit rezervë për vitin 2022, planifikohet në masën 2.9 miliardë lekë, përkatësisht 2.4 miliardë lekë fond rezervë i Këshillit të Ministrave, 500 milionë lekë fond kontigjence për projektet me BE-në, si dhe 500 milionë lekë kontingjencë për projekte specifike për fëmijët.

Investimet publike për vitin 2022 janë planifikuar në masën 6.4% e PBB ose 119.4 miliardë lekë (duke përfshirë këtu dhe fondin e rindërtimit në shumën 20 miliardë lekë, si dhe transfertën kapitale për fondin e shpronësimeve me 1,2 miliardë lekë). Në planifikimin e investimeve për vitin 2022 janë mbajtur në konsideratë të gjitha detyrimet kontraktuale për projektet e investimeve me financim të huaj dhe të brendshëm. Ashtu, si edhe në vitin 2021, dhe në vitin 2022 do të ketë përparësi financimi i projekteve në vazhdim. Për planifikimin e investimeve janë ndjekur kriteret e mëposhtme:

- prioritetet e Programit të Qeverisë, për periudhën 2021–2025;
- prioritetet e integrimit evropian;
- projektet në vazhdim.
- mbështetja me kosto lokale dhe TVSH për projektet me financim të huaj.

4.4 Perspektiva buxhetore afatmesme

Parashikimi i të ardhurave tatimore dhe doganore për vitin 2022 ka marrë në konsideratë të gjithë faktorët e rëndësishëm që ndikojnë në buxhet, veçanërisht situatën ekonomike të krijuar nga pandemia e COVID-19, përfshirë efektin e politikave të reja fiskale që synojnë rimëkëmbjen ekonomike.

Programimi i të ardhurave për vitin 2022, mbështet qëllimet e Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë për rimëkëmbjen fiskale, si dhe mbajtjen nën kontroll të deficitit buxhetor dhe borxhit publik. Ky program bazohet në përmirësimin e administratës fiskale dhe minimizimin e informalitetit në ekonomi, duke mbështetur kështu rimëkëmbjen ekonomike, si dhe rritjen e prodhimit dhe eksporteve.

Metodologjia e programimit të të ardhurave bazohet në modelet bashkëkohore të programimit, dhe në analizën e hollësishme të faktorëve që ndikojnë në çdo taksë. Modeli i përdorur bazohet në parashikimet makroekonomike për vitin 2022–2024, siç janë rritja nominale, deflatori, analiza e importeve të grupeve kryesore të produkteve, analiza e serive kohore dhe modele, bazuar në koeficientin e elasticitetit "Buoyancy" dhe "Norma efektive e taksave" për secilën taksë.

Faktorët makroekonomikë harmonizohen në planifikim, me treguesit kryesorë që ndikojnë në taksat specifike.

Në detaje, treguesit kryesorë për vlerësimin e të ardhurave janë:

- rritja nominale e PBB-së, duke analizuar këtë efekt në një mënyrë të integruar me faktorë të tjerë për secilën tatim në veçanti, në lidhje me të dhënat historike dhe parashikimet e çmimeve në tregjet ndërkombëtare për taksat e vlerësuara si tatimi i vlerës së shtuar, honorarët e minierave dhe taksat doganore.
- kursi i pritshëm i këmbimit të dy monedhave kryesore: USD dhe euro me lek;
- çmimet në bursë që ndikojnë në të ardhurat nga TVSH-ja dhe renta minerare;
- sasitë e pritshme të importit të mallrave.

Të ardhurat totale të mbledhura nga DPD-ja dhe DPT-ja (përfshirë sigurimet shoqërore) vlerësohet të jetë 471.5 miliardë lekë, ose 39.5 miliardë lekë (9.2%) më shumë se viti i pritshmi 2021. Të ardhurat nga DPD-ja dhe DPT-ja (pa përfshirë kontributet) për 2022-shin vlerësohen të jenë 360.5 miliardë lekë ose 32.5 miliardë lekë (9.9%) më shumë se 2021 paraprake, ndërsa të ardhurat nga kontributet shoqërore vlerësohen të jenë 111 miliardë lekë ose 7 miliardë lekë (6.7%) më shumë se viti i pritshmi 2021.

Tabelë 4.4.1 Të ardhurat totale nga administrata tatimore dhe doganore (në milionë lekë)

Lloji i taksave	2019	2020	I pritshmi 2021	Parashikimi 2022	Parashikimi 2023	Parashikimi 2024	Diferenca 2022 – 2021	
							Vlera	Në %
TVSH neto total	132,412	130,354	151,460	166,061	179,332	193,710	14,601	9.6%
Tatimi mbi fitimin	36,575	28,381	33,631	35,586	37,778	40,009	1,955	5.8%
Akciza	46,742	44,521	51,830	56,478	58,011	59,346	4,648	9.0%
Tatimi mbi të ardhurat personale	46,124	33,658	42,679	45,161	48,063	50,906	2,482	5.8%
Taksat nacionale total	36,423	35,829	40,900	49,741	52,427	55,162	8,841	21.6%
Taksë doganore	6,482	6,241	7,500	7,508	8,115	8,774	8	0.1%
Total DPD+DPT	**304,758**	**278,984**	**328,000**	**360,535**	**383,726**	**407,907**	**32,535**	**9.9%**
Kontributet e mbledhura (DPT)	91,850	98,300	104,000	111,000	118,000	125,000	7,000	6.7%
Total DPD+DPT(kontributet)	**396,608**	**377,284**	**432,000**	**471,535**	**501,726**	**532,907**	**39,535**	**9.2%**

Burimi: Ministria e Financave dhe Ekonomisë (2021)

Të ardhurat doganore projektohen bazuar në analizën e trendit historik të 60 grup-produkteve kryesore për një periudhë shumëvjeçare. Ky parashikim korrigjohet nga efektet e faktorëve të jashtëm në çdo taksë. E njëjta procedurë është përdorur për të ardhurat tatimore, bazuar në modelin statistikor të parashikimit të të ardhurave të pritshme, si dhe faktorët ekzogjenë që ndikojnë në çdo taksë.

Faktorët e jashtëm që janë marrë në konsideratë në ndikimin e rritjes së të ardhurave për vitin 2021 janë:

Kuadri makroekonomik

Rritja nominale e prodhimit të brendshëm bruto e skontuar me koeficientin e elasticitetit është aplikuar duke analizuar këtë efekt në mënyrë të integruar me faktorë të tjerë për çdo taksë në veçanti, të ndërlidhur me të dhënat historike dhe projeksionet e çmimeve në tregjeve ndërkombëtare tek taksat *ad-valorem* si tatimi mbi vlerën e shtuar, renta minerare dhe taksa doganore. Në projeksion janë përfshirë, faktorë që lidhen me rritjen nominale e PBB-së, kursin mesatar të këmbimit euro–lek dhe USD-lek, si dhe çmimet brent të naftës bruto dhe mineraleve të tjera.

Efektet e politikave fiskale

Për vitin 2022 parashikohen disa ndryshime fiskale. Parashikimi i të ardhurave për vitin 2022, mbështet qëllimet e Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë për rimëkëmbjen fiskale, si dhe mbajtjen nën kontroll të deficitit buxhetor dhe borxhit publik. Ky program bazohet në përmirësimin e administratës fiskale dhe minimizimin e informalitetit në ekonomi, duke mbështetur kështu rimëkëmbjen ekonomike, si dhe rritjen e prodhimit dhe eksporteve.

Prioritet do të jetë zbatimi dhe qëndrueshmëria e politikave fiskale, duke stimuluar thjeshtësinë, transparencën, zvogëlimin e kostove të administrimit, si dhe duke shmangur përjashtimet ose tarifat e favorshme.

Në këtë kuadër, janë hartuar edhe politikat fiskale për vitin 2022, të cilat janë prezantuar nëpërmjet paketës fiskale 2022, me efektet në të ardhura, si më poshtë:

- Heqja e skemës së kompensimit të prodhuesit bujqësor për qëllime të TVSH-së (nga 6% në 0%). Parashikohet të rezultojë me një efekt financiar në të ardhurat me rreth 750 milionë lekë në vit.

- Vendosje e normës së reduktuar 10% të TVSH-së për furnizimin e inputeve bujqësore. Parashikohet të rezultojë me një efekt financiar në të ardhurat me rreth 900 milionë lekë në vit.

- Përjashtimi i TVSH-së në importimin e makinerive dhe të pajisjeve në funksion të realizimit të kontratave të investimeve me vlerë të barabartë ose më të madhe se 500 milionë lekë (nga 50 milionë që është aktualisht). Parashikohet të rezultojë me një efekt financiar në të ardhurat me rreth 400 milionë lekë në vit.

- Unifikimi i akcizës së aplikueshme gazit të lëngshëm, si për konsumatorin privat, ashtu edhe tregtar në masën 6 lekë/litër, parashikohet të rezultojë me një efekt financiar në të ardhurat me rreth 375 milionë lekë në vit.

- Ndryshimi i shkallës së taksimit për kategorinë T200, "Cigare që përmbajnë duhan", duke aplikuar kalendarin për 4 vitet në vijim, dhe nga ndryshimi i akcizës së nënprodukteve të tjera të duhanit, parashikohet të rezultojë me një efekt financiar në të ardhurat me rreth 750 milionë lekë në vit.

- Indeksimi çdo dy vjet i taksës specifike të akcizës me normën e shpallur të inflacionit parashikohet të rezultojë me një efekt financiar në të ardhurat me rreth 500 milionë lekë në vit.

- Heqja e rimbursimit të akcizës së lëndëve djegëse për fermerët dhe industrinë agroindustriale (përveç peshkimit), parashikohet të rezultojë me një efekt financiar në të ardhurat me rreth 800 milionë lekë në vit.

- Rritja e bazës së patatueshme për efekt tatimi mbi të ardhurat personale 30.000 lekë në 40.000 lekë dhe 15000 lekë në 200000 lekë. Parashikohet të ndikojnë në uljen e të ardhurave me efekt -685 milionë lekë.

- Vendosja e taksës kombëtare për karburantin e furnizuar në zonat e lira (për rieksport) 40 lekë/litër. Parashikohet të ndikojnë në rritjen e të ardhurave me efekt 0.8 miliardë lekë.

- Vendosjen e taksës për importimin ose prodhimin e qumështit pluhur, parashikohet të kemi një efekt financiar pozitiv në të ardhurat e shtetit me 50 milionë lekë në vit.

Parashikimi i të ardhurave për çdo taksë për vitin 2021

Të ardhurat nga TVSH-ja parashikohet të arrijnë 166.1 miliardë lekë, 32.5 miliardë lekë, ose 9.9% më shumë se në vitin 2021. Burimi kryesor i rritjes së të ardhurave të TVSH-së për vitin 2022 pritet të jetë:

- TVSH që do të gjenerohet si rezultat i rritjes ekonomike;
- TVSH nga rritja e volumit të importeve dhe konjuktura e çmimeve ndërkombëtare;
- TVSH nga përmirësimi i administrimit, lufta ndaj informalitetit dhe kontrolli i zinxhirit të transaksioneve ndërmjet operatorëve.
- TVSH nga efektet e paketës fiskale 2020 (+2 miliardë lekë).

Të ardhurat e akcizës parashikohet të rriten me 4.7 miliardë lekë, ose 9% më shumë se një vit më parë, me një vlerë totale prej 56.5 miliardë lekësh. Faktorët kryesorë që parashikohet të ndikojnë në rritjen e të ardhurave të akcizës janë si më poshtë:

- Rritja e importit të mallrave të ngurta si lëndët djegëse dhe cigare.
- Forcimi i luftës kundër informalitetit, përmes kontrollit rigoroz të subjekteve të akcizës.
- Disiplinimi i mëtejshëm i procedurave të përfitimit të përjashtimeve dhe rimbursimeve nga kjo taksë.
- Akcizë e ardhur nga efektet e paketës fiskale 2022 (+2.4 miliardë lekë).

Të ardhurat nga tatimi mbi fitimin parashikohet të realizohen në shumën prej 35.6 miliardë lekësh, 2 miliardë lekë 5.8% më shumë se një vit më parë. Rritja e parashikuar në tatimin mbi fitimin bazohet:

- Në rikuperimin e ekonomisë dhe rritjen e saj, çka do reflektohet edhe në deklaratat e tatimpaguesve;
- Në forcimin e kontrollit të deklaratave, bazuar në kriteret e riskut;
- Në fiskalizimin nëpërmjet se cilit sigurohet një kontroll tatimor më i mirë dhe efikas me fokus tatimpaguesit, që nuk deklarojnë dhe nuk paguajnë detyrimet e tyre në përputhje me ligjin dhe, gjithashtu, krijon një mekanizëm të mbikëqyrjes në kohë reale, të pajisjeve fiskale që operojnë me para në dorë dhe atyre pa para në dorë.

Të ardhurat nga tatimi mbi të ardhurat personale parashikohet të realizohen në 45.2 miliardë lekë, 2.5 miliardë lekë, ose 5.8% më shumë se në vitin 2020. Në parashikimin e të ardhurave nga tatimi mbi të ardhurat personale janë marrë në konsideratë rritja ekonomike dhe impakti i saj në nivelin e pagës mesatare, si dhe rritja e numrit të të punësuarve në sektorin privat, bazuar në ecurinë e vitit 2021.

Të ardhurat nga taksat nacionale vlerësohen të jenë 49.7 miliardë lekë, 8.8 miliardë lekë, ose 21.6% më shumë se një vit më parë.

Të ardhurat nga taksa doganore parashikohet të jenë 7.5 miliardë lekë, 8 milionë lekë, ose 0.1% më shumë se viti fiskal 2021. Në planifikimin e të ardhurave, merren parasysh efektet e rritjes së importeve të

tatueshme, si dhe disa efekte minimale nga lëvizja e tarifave doganore.

Të ardhurat nga kontributet e sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore të mbledhura nga DPT-ja konsiderohen të jenë 96.3 miliardë lekë, 5.4 miliardë lekë ose 5.9% më shumë se viti fiskal 2020. Planifikimi për rritjen ardhurave nga kontributet e sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore mbështetet nga këta faktorë:

- Rimëkëmbja ekonomike, e cila do të reflektohet në rritjen e numrit të të punësuarve;
- Forcimin e administrimit nëpërmjet kontrollit të nivelit të pagës të deklaruar dhe deviacionit të saj nga paga reale që përfitohet;

Rrisqet fiskale

Lidhur me parashikimin e të ardhurave tatimore dhe doganore, rreziqet fiskale për vitin 2022 konsistojnë në:

- zgjatja e situatës pandemike dhe efektet reale të paparashikuara të saj;
- efektet e pritshme mbi ekonominë si pasojë e rritjes së çmimeve të karburanteve dhe energjisë elektrike.

Shpenzimet tatimore *(Tax Expenditures)*

Shpenzimet tatimore, apo *tax expenditures* konsiderohen humbje nga të ardhurat fiskale të parashikuara në legjislacionin fiskal në fuqi, si rezultat i lehtësirave fiskale ose normave preferenciale të vendosura për kategori të caktuara tatimpaguesish ose aktivitetesh. "Shpenzimet tatimore" janë vlerësuar duke përdorur një metodologji të re bazuar mbi disa modele për vlerësimin e shpenzimeve tatimore, sipas llojit të tatimeve. Analiza e përjashtimeve ligjore dhe përcaktimi i *benchmark*-ut (përjashtime që janë normë në të gjithë vendet) u krye me asistencë të Bankës Botërore.

Për vlerësimin dhe matjen e "përjashtimeve nga taksat" janë marrë në konsideratë tatimet dhe taksat e mëposhtme:

- tatimi mbi vlerën e shtuar, përkatësisht në ligjin nr. 92/2014, "Për tatimin mbi vlerën e shtuar" në Republikën e Shqipërisë, të ndryshuar;
- tatimi mbi të ardhurat, përkatësisht në ligjin nr. 8438, datë 28.12.1998, "Për tatimin m bi të ardhurat", i ndryshuar;
- akciza, përkatësisht në ligjin nr. 61/2012, "Për akcizën në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar.

Duke marrë në konsideratë indeksin zinxhir të rritjes reale ekonomike, si dhe efektet e veçanta që prodhohen si pasojë e ndryshimeve në politikat fiskale, përcaktohet vlera totale paraprake e shpenzimeve tatimore për zërat e mëposhtëm:

- shpenzime tatimore nga tatimi mbi vlerën e shtuar;
- shpenzime tatimore nga akciza;
- shpenzime tatimore nga tatimi mbi fitimin.

Duhet theksuar se pjesën më të madhe të vlerës së shpenzimeve tatimore e zënë ato shpenzime të cilat rrjedhin si efekt i përjashtimeve nga secili prej tatimeve të mësipërme. Pjesën dërrmuese të totalit të shpenzimeve tatimore e zë shpenzimi tatimor që vjen prej TVSH-së, dhe diferenca e mbetur si shpenzim tatimor nga akciza dhe tatimi mbi fitimin.

Vlerësimi për shpenzimet tatimore 2020 është 77.6 miliardë lekë. Ky është vlerësim paraprak, për vitin 2020, vlera e saktë do të publikohet në raportin e plotë periodik të shpenzimeve tatimore, i cili do të publikohet në fund të vitit 2021.

Prioritetet që financon buxheti afatmesëm 2022–2024

Buxheti për vitet 2022–2024 do të financojë me prioritet politikat e grupuara sipas fushave të mëposhtme:

- Shërbimet për qytetarët dhe sipërmarrjet:

Rriten me 6% pagat e punonjësve në sektorët e shëndetësisë, arsimit dhe mbrojtjes.

- Financohen si prioritete mbështetja e *start-up*-eve, pagesa e papunësisë së naftëtarëve dhe garancia sovrane 1 miliardë lekë për manifakturën dhe sipërmarrjen.
- Fermerët përfitojnë rreth 12.7 miliardë lekë në vitin 2022 përmes skemave shtesë për fermerët, rimbursimit të naftës, projektit të garancisë së kredisë për zonat rurale dhe garancisë sovrane për fermerët.
- Do të vijojë fokusi në shëndetësi me financimin e vaksinës COVID-19 për vitin 2022 me vlerën 2.7 miliardë lekë.
- Fondi i rindërtimit shkon në 20 miliardë lekë dhe për transfertën kapitale të fondit të shpronësimeve në 1,8 miliardë lekë për vitin 2022.

- Për Spitalin Rajonal të Fierit programohet një fond prej 750 milionësh, si dhe do të vijojnë skemat e rimbursimit të barnave dhe bonusit të bebes.

- Rritet fondi i mbështetjes për shtresat në nevojë: ndihma ekonomike rritet me 10%, trefishohet ndihma për gratë e trafikuara dhe fëmijët e mitur dhe dyfishohet ndihma për nënat me shumë fëmijë.

- Në një zë të veçantë të skemës së sigurimeve sociale, në buxhet parashikohet indeksimi i pensioneve (prej 2.6 miliardë lekësh) dhe bonusi i fundivitit për pensionistët (3.5 miliardë lekë).

- Gjithashtu, buxheti i vitit 2022 parashikon shpenzimet për pagesën e papunësisë me 900 milionë lekë, për pagesën e aftësisë së kufizuar me 23.5 miliardë lekë dhe për ish-të përndjekurit me një fond prej 1 miliardë lekësh.

- Do të vijojë skema e librave shkollorë falas për nxënësit nga shtresa në nevojë, e cila zgjerohet deri në shkollën e mesme.

- Me një fond shtesë prej 250 milionë lekësh për 2022-shin e në vijim sigurohet transporti për nxënësit dhe mësuesit që banojnë larg nga shkolla.

- Me 700 milionë lekë të alokuara për projektet për universitetet, fokusi mbetet tek të rinjtë dhe edukimi.

- Për shpenzimet e buxhetit vendor, po zbatohet një program decentralizimi, ku synohet një skemë financimi e përshtatshme dhe efektive që përmirëson në mënyrë të qëndrueshme cilësinë e shërbimeve.

- Digjitalizimi:

Reforma e digjitalizimit rrit cilësinë e shërbimeve ndaj biznesit dhe qytetarit, si dhe ndihmon në luftën kundër korrupsionit.

Me investimet në projektin e dronëve dhe satelitëve rritet efikasiteti i kontrollit në sektorët e mbrojtjes dhe rendit.

Investimet në digjitalizim përfshijnë ministritë përkatëse në sektorët e rendit, mbrojtjes, shëndetësisë, financave dhe ekonomisë dhe arsimin.

Me një fond 1.9 miliardë lekë financohen në arsimin parauniversitar laboratorët shkencorë dhe klasat e teknologjisë së informacionit.

Me investimet në projektet për trajnimin e të rinjve në teknologjinë e informacionit, ata do të përshtaten më mirë me kërkesat dhe ofertat në tregun e punës dhe krijohen vende cilësore të punës.

- Investimet në infrastrukturën kyçe:

- Do të vijojnë investimet për infrastrukturën rrugore në disa prej projekteve kryesore, si: Rruga e Arbrit, Tuneli i Llogorasë, Unaza e Jashtme e Tiranës, *By pass*-i në Shkodër dhe segmentet Palasë–Dhërmi e Elbasan–Përrenjas–Qafëthanë.

- Mirëmbajtja e rrugëve nacionale me financim të brendshëm do të përfitojë një rritje prej 1 miliardë lekësh, duke mbajtur rreth 2.6 miliardë lekë në total për mirëmbajtjen e rrugëve duke përfshirë dhe financimet e projektit të Bankës Botërore për mirëmbajtjen e sigurinë rrugore.

- Përfshihen në buxhetin e vitit 2022 investimet për portet e Durrësit dhe Vlorës dhe aeroportet e Vlorës dhe Sarandës.

Parashikohen të këtë buxhet linjat e reja hekurudhore Tiranë–Durrës dhe Tiranë–Rinas (1.7 miliardë lekë).

- Do të vijojë puna për projektin e Teatrit në Tiranë dhe të Qendrës Kombëtare për Fëmijët.

- Financohet me këtë buxhet Agjencia Kombëtare e Bregdetit për pastrimin e plazheve me një fond total prej 200 milionë lekësh.

Në sektorin e turizmit mundësohet garanci sovrane 1 miliardë lekë;

500 milionë lekë alokohen për njësitë e vetëqeverisjes vendore për pastrimin e mbetjeve.

Huamarrja në periudhën afatmesme

Në periudhën afatmesme, nevojat për financim do të plotësohen duke përdorur burimet e brendshme dhe ato të huaja të financimit.

Burimet e brendshme të financimit do të vazhdojnë të jenë burimi kryesor i financimit (rreth 80% të financimit bruto), me qëllim zhvillimin e tregut të brendshëm të titujve shtetërorë, si edhe mbajtën e riskut të kursit të këmbimit nën kontroll (borxhi në monedhë të huaj jo më shumë se 55% e totalit të borxhit shtetëror). Huamarrja e brendshme do të vazhdojë të bazohet kryesisht te sektori bankar, ndërkohë që ka pritshmëri pozitive për rritjen e aktivitetit të institucioneve jofinanciare dhe individëve.

Nëpërmjet titujve afatshkurtër, kryesisht do të synohet rifinancimi me sukses i titujve ekzistues që maturohen dhe menaxhimi aktiv i nevojave për likuiditet. Ndërkohë, nëpërmjet titujve afatgjatë do të

synohet të mbulohet financimi i deficitit buxhetor. Struktura e financimit të brendshëm do të jetë fleksibël në terma të përzgjedhjes së titujve shtetërorë, në varësi të kushteve të tregut të brendshëm (niveli i kërkesës, normat e interesit etj.), duke garantuar në këtë mënyrë optimizimin e kostove, në përputhje me objektivat e vendosur për të menaxhuar risqet e portofolit të borxhit.

Në periudhën afatmesme, huamarrja nëpërmjet burimeve të huaja do të plotësojë nevojat vjetore për hua të qeverisjes qendrore (në terma bruto) deri në 20%, si edhe do të kontribuojë në optimizimin e kostove të portofolit të borxhit, duke qenë se një pjesë e konsiderueshme e këtij financimi do të synojë të sigurohet me terma koncesionalë dhe gjysmëkoncesionalë (nëpërmjet burimeve dypalëshe dhe shumëpalëshe të financimit). Huamarrja nga burime bilaterale dhe multilaterale do të përdoret kryesisht për të financuar projektet strategjike të qeverisë dhe reformat e ndërmarra nga qeveria. Gjithashtu, burimet private të financimit të siguruara në tregjet ndërkombëtare të kapitalit do të përdoren kryesisht për qëllime të menaxhimit të riskut, menaxhimit të detyrimeve të borxhit në valutë të huaj, si edhe për të shmangur konsumin e burimeve të brendshme dhe stimuluar kreditimin e sektorit privat.

4.5 Balanca strukturore

(Përbërësi ciklik i deficitit, masat e njëhershme dhe të përkohshme, pozicioni fiskal)

Vlerësimi i PBB-së potenciale dhe hendekut të prodhimit

Teknika e filtrimit HP u përdor për të vlerësuar një seri kohore të PBB-së potenciale. Filtrimi HP është aplikuar në rritjen ekonomike aktuale vjetore me çmime konstante, duke marrë parasysh vlerat më të përshtatshme të parametrit lambda në rastin e të dhënave vjetore, përkatësisht: $\lambda = 100; \lambda = 30; \lambda = 6.5$ Rritja e PBB-së potenciale u nxor më pas si një mesatare e serive të filtrimit HP bazuar në këta tre parametra të ndryshëm të lambdas. Bazuar në rritjen potenciale të përfituar, u nxor më pas niveli i PBB-së potenciale dhe në përputhje me të u llogarit dhe niveli i *output*-it. Parashikimet më të fundit të MFE-së deri në vitin 2028 janë përdorur për t'u marrë me problemin e të dhënës së fundit që shfaq teknika e filtrimit HP.

Hendeku i prodhimit, e përcaktuar zyrtarisht si $G_t = \frac{GDP_{t,\,aktual} - GDP_{t,potencial}}{GDP_{t,potencial}}$ është paraqitur në anën e majtë të figurës së mëposhtme. Ndërsa rritja potenciale përkatëse kundrejt asaj aktuale paraqitet në anën e djathtë.

Grafik 4.5.1 Hendeku i prodhimit (majtas) dhe rritja aktuale dhe potenciale (djathtas)



Burimi: Ministria e Financave dhe Ekonomisë

Rezultatet tregojnë se prodhimi aktual ka qenë nën potencialin për periudhën 2002–2006, gati duke u mbyllur në vitin 2007 dhe më pas duke kaluar në një hendek pozitiv relativisht të madh në vitin 2008. Ndryshimi i fundit pozitiv në hendekun e prodhimit vazhdoi disi edhe gjatë periudhës 2009–2012 duke u tkurrur gradualisht në reflektim të një rritje aktuale më të ulët krahasuar me atë potenciale, për shkak të efekteve negative të krizës financiare globale. Pavarësisht se Shqipëria arriti të absorbojë shumë më lehtë goditjen e parë nga kriza globale në vitin 2009, duke shmangur një recesion të rëndë që ndodhi në shumicën e vendeve të tjera, prapë rritja aktuale u dobësua ndjeshëm krahasuar me nivelet e para krizës, por, gjithashtu, edhe në krahasim me potencialin e saj. Në vitin 2013 u regjistrua rritja më e ulët dhe në të njëjtën kohë hendeku i prodhimit u zhvendos në territorin negativ dhe qëndroi negativ deri në vitin 2016, me nivelin më të ulët të arritur në vitin 2015. Hendeku i prodhimit u zhvendos pak në territorin pozitiv

deri në vitin 2017, u intensifikua në vitin 2018 dhe, gjithashtu, vazhdoi e fortë edhe në vitin 2019, me gjithë rritjen aktuale më të ulët në këtë vit, veçanërisht rritjen e tremujorit të fundit kur vendi u godit nga tërmeti i nëntorit. Në vitin 2020, më e rëndësishmja për shkak të goditjes pandemike COVID-19, e cila e detyroi ekonominë në një recesion të fortë në rreth -4.0 për qind, por, gjithashtu, duke reflektuar në një farë mase ngadalësimin e ndjeshëm të rritjes aktuale që kishte ndodhur tashmë në vitin 2019, hendeku i prodhimit arriti pikën më negative në dekada me rreth -5.6 për qind të PBB-së potenciale. Megjithëse rritja aktuale u rrit me shpejtësi në vitin 2021 dhe do të vazhdojë edhe më fort në periudhën afatmesëm, duke çuar kështu që prodhimi të konvergojë gradualisht drejt potencialit të tij, prapë për shkak të humbjes drastike të prodhimit në vitin 2020, hendeku negativ i prodhimit parashikohet të vazhdojnë deri në vitin 2022 dhe pastaj të konvergojë drejt potencialit në vitin 2023 dhe 2024.

Vlerësimi i elasticitetit dhe ndjeshmërisë së buxhetit ndaj hendekut të prodhimit

Pasi u hoqën faktorët që kanë pasur ndikime vetëm në një periudhë të caktuar, u vlerësuan elasticitetet e të ardhurave dhe të shpenzimeve edhe me metodën e disagregimit (sipas qasjes së OECD-së 2005) dhe me metodën agregate (sipas qasjes së FMN-së 2010). Gjithsesi, elasticitetet finale totale të marra nga secila metodë ishin pothuajse të ngjashme.

Për të qenë më konkretë, elasticiteti i përgjithshëm i të ardhurave, i nxjerrë nga elasticitetet specifike të zërave kryesorë të të ardhurave me metodën e disagregimit ishte 1.031, ndërsa elasticiteti i vlerësuar nga metoda agregate ishte 1.460.[7] Të ardhurat totale u rregulluan për efektet e ciklit, duke aplikuar mbi to elasticitetin mesatar të përfituar nga të dyja qasjet, i cili është:

$$\varepsilon_{R,Y} = mesatare\ (1.031, 1.460) = 1.246$$

Për sa u përket elasticiteteve të shpenzimeve, ato nuk ishin të ndryshme nga niveli zero. Analiza e regresionit na prodhoi elasticitete të shpenzimeve me shenjë negative, sipas të dyja metodave, por asnjëra prej tyre nuk ishte statistikisht e rëndësishme, duke na treguar se koeficienti i elasticitetit është i barabartë me zero:

$$\varepsilon_{G,Y} = 0$$

Si rezultat, shpenzimet totale nuk u rregulluan për efekte ciklike. Aplikimi direkt i formulës së ndjeshmërisë për bilancin e buxhetit ndaj hendekut të prodhimit (ose i ashtuquajtur elasticitet i pjesshëm) na dha vlerën e mëposhtme:

$$\sigma_B \equiv r\left(\varepsilon_{R,Y} - 1\right) - g\left(\varepsilon_{G,Y} - 1\right) = 0.256\,(1.246 - 1) - 0.265\,(0 - 1) = 0.327$$

Ku $r = 0.256$ është norma mesatare e të ardhurave totale ndaj PBB-së (duke përjashtuar faktorët njëndikimësh) për 5 vitet e fundit (2016 - 2020); $g = 0.256$ është norma mesatare e shpenzimeve primare ndaj PBB-së (duke përjashtuar faktorët njëndikimësh) për 5 vitet e fundit (2016–2020). Parametri i vlerësuar i ndjeshmërisë së buxhetit na thotë se për çdo pikë përqindje negative (pozitive) të hendekut të prodhimit, bilanci i përgjithshëm fiskal primar do të përkeqësohet (përmirësohet) me 0.327 pikë përqindjeje të PBB-së potenciale.

Llogaritja e bilancit fiskal të rregulluar ciklikisht dhe vlerësimi i ndikimit të pritshëm të politikës fiskale në ekonomi.

Bazuar te hendeku i vlerësuar i prodhimit *(OG)* dhe parametri i ndjeshmërisë së buxhetit (σ_B) komponenti ciklik i bilancit fiskal primar (CPB) në terma të PBB-së potenciale është llogaritur, si:

$$CBT_t = \sigma_B * OG_t$$

ku stabilizatorët automatikë (AS) janë përkufizuar si ndryshimi i CPB-së të dyja viteve rresht, pra:

$$AS_t = CPB_t - CPB_{t-1}$$

[7] Për shkak të mungesës së të dhënave dhe serive relativisht të shkurtra, në rastin e metodës së disagregimit disa prej elasticiteteve/koeficienteve të vlerësuar nuk ishin të rëndësishëm në nivelet konvencionale dhe u vendosën disa supozime.

Bilanci primar i rregulluar ciklikisht (CAPB) llogaritet si diferencë mes bilancit primar fiskal aktual (PB) dhe komponentit të tij ciklik (CPB):

$$CAPB_t = PB_t - CPB_t$$

Bilanci i përgjithshëm i rregulluar ciklikisht (CAB) del pasi bilancit primar të rregulluar ciklikisht i hiqen shpenzimet për interesat (INT) te bilanci primar i rregulluar ciklikisht:

$$CAB_t = CAPB_t - INT_t$$

Impulsi fiskal (FI) në terma të PBB-së potenciale është ndryshimi i bilancit primar të rregulluar ciklikisht çdo vit, relativisht me vitin e kaluar:

$$FI_t = CAPB_{t-1} - CAPB_t$$

Bazuar në drejtimin e impulsit fiskal (ngushtues apo zgjerues) dhe hendekut të prodhimit (negative ose pozitive), ne po japim një paraqitje të thjeshtë për sa i përket natyrës së politikës fiskale, n.q.s. ajo ka qenë prociklike, kundërciklike apo neutrale. Rezultatet e marra janë paraqitur në tabelën dhe grafikun më poshtë.

- Tabelë 4.5.1 Qëndrimi i politikës fiskale

Year	Output Gap (OG)	Actual Overall Fiscal Balance (B)	Actual Primary Fiscal Balance (PB)	Cyclical Primary balance (CPB)	Cyclically Adjusted Primary balance (CAPB)	Interest Expenditures (INT)	Cyclically Adjusted Ovearall Balance (CAB)	Automatic Stabilizers (AS)	Fiscal Impulse (FI)	Fiscal stance relative to output gap
1999	1.4	-9.6	-1.7	0.5	-2.2	7.9	-10.0	-	-	-
2000	0.4	-8.0	-2.1	0.1	-2.2	5.9	-8.1	-0.3	0.1	Neutral
2001	1.5	-7.2	-3.0	0.5	-3.5	4.2	-7.7	0.3	1.2	Pro-cyclical
2002	-0.5	-6.2	-2.2	-0.2	-2.0	4.1	-6.1	-0.6	-1.5	Pro-cyclical
2003	-1.1	-5.0	-0.6	-0.3	-0.3	4.4	-4.7	-0.2	-1.7	Pro-cyclical
2004	-1.4	-5.2	-1.3	-0.5	-0.9	3.9	-4.7	-0.1	0.6	Counter-cyc
2005	-1.5	-3.5	-0.3	-0.5	0.2	3.2	-3.0	0.0	-1.1	Pro-cyclical
2006	-1.0	-3.4	-0.5	-0.3	-0.2	2.9	-3.0	0.1	0.4	Counter-cyc
2007	-0.2	-3.5	-0.9	-0.1	-0.8	2.7	-3.5	0.3	0.7	Counter-cyc
2008	2.5	-5.6	-2.7	0.8	-3.5	2.9	-6.4	0.9	2.7	Pro-cyclical
2009	1.8	-7.1	-3.9	0.6	-4.5	3.2	-7.7	-0.2	1.0	Pro-cyclical
2010	2.1	-3.1	0.3	0.7	-0.4	3.4	-3.8	0.1	-4.1	Counter-cyc
2011	1.7	-3.5	-0.4	0.6	-0.9	3.2	-4.1	-0.1	0.5	Pro-cyclical
2012	0.6	-3.4	-0.3	0.2	-0.5	3.1	-3.6	-0.4	-0.4	Counter-cyc
2013	-0.6	-5.0	-1.7	-0.2	-1.5	3.2	-4.7	-0.4	1.0	Counter-cyc
2014	-1.1	-5.2	-2.3	-0.4	-1.9	2.9	-4.8	-0.2	0.4	Counter-cyc
2015	-1.3	-4.1	-1.4	-0.4	-0.9	2.7	-3.6	-0.1	-1.0	Pro-cyclical
2016	-0.6	-1.8	0.7	-0.2	0.8	2.5	-1.6	0.2	-1.8	Pro-cyclical
2017	0.5	-2.0	0.1	0.2	-0.1	2.1	-2.2	0.4	1.0	Pro-cyclical
2018	1.9	-1.6	0.6	0.6	0.0	2.2	-2.2	0.4	-0.1	Neutral
2019	1.2	-1.9	0.2	0.4	-0.2	2.1	-2.3	-0.2	0.2	Neutral
2020	-5.6	-6.8	-4.7	-1.8	-2.9	2.1	-5.0	-2.2	2.7	Counter-cyc
2021	-0.7	-5.8	-3.8	-0.2	-3.6	2.1	-5.6	1.6	0.7	Counter-cyc
2022	-0.3	-5.4	-2.7	-0.1	-2.6	2.7	-5.3	0.1	-1.0	Pro-cyclical
2023	0.1	-2.9	0.0	0.0	0.0	2.9	-3.0	0.1	-2.5	Counter-cyc
2024	0.1	-2.8	0.3	0.0	0.3	3.2	-2.9	0.0	-0.3	Counter-cyc

Burimi: Ministria e Financave dhe Ekonomisë

Grafik 4.5.2 Qëndrimi i politikës fiskale



Burimi: Ministria e Financave dhe Ekonomisë

Tabelë 4.5.2 Politika fiskale në raport me ciklet ekonomike

Fiscal stance	Unit	Number of years	
		2000 - 2021	2022 - 2024
Pro-cyclical	number	10	1
Counter-cyclical	number	8	2
Neutral	number	3	0
Cumulative output gap v.s. Cumulative fiscal impulse --> Overall fiscal stance			
Cumulative output gap	p.p. of GDP	-1.2	-0.1
Cumulative fiscal impulse	p.p. of GDP	1.4	-3.9
Overall fiscal stance		Counter-cyclical	Pro-cyclical

Burimi: Ministria e Financave dhe Ekonomisë

Kjo analizë e thjeshtë përshkruese tregon se gjatë viteve 2000–2021 qëndrimi i politikës fiskale ka qenë prociklik në dhjetë vjet, kundërciklike në tetë vjet dhe neutral në tre prej tyre. Kur matet si një shumë akumuluese e impulseve fiskale gjatë gjithë viteve (2000–2021) në raport me hendekun e prodhimit kumulativ për ato vite përkatëse, qëndrimi fiskal rezulton gjerësisht në anën kundërciklike. Më konkretisht, hendeku kumulativ i prodhimit për vitet 2000–2021 rezulton negativ, në -1.2 pikë përqindjeje të PBB-së potenciale, ndërsa impulset kumulative fiskale për periudhën përkatëse rezultojnë, gjithashtu, pozitive me vetëm 1.4 pikë përqindjeje të PBB-së.

Ndërsa për horizontin trevjeçar në vijim (2022–2024), edhe pse hendeku kumulativ i prodhimit parashikohet të jetë pothuajse zero, por prapë negativ, ajo gradualisht do të konvergjojë drejt potencialit të tij, duke u rikuperuar nga humbja e madhe e vitit 2020, si dhe politika fiskal kumulative synohet të jetë negative. Kjo tregon një politikë fiskale prociklike, që ka të ngjarë të pasqyrojë borxhin publik të nivelit relativisht të lartë dhe, për këtë arsye, nënkupton që një rëndësi më e madhe i jepet objektivit të sigurimit të qëndrueshmërisë afatgjatë të financave publike kundrejt objektivit të stabilizimit afatshkurtër të cikleve ekonomike. Drejtimi i qartë drejt një rruge më të fortë konsoliduese merr edhe më shumë rëndësi nga nevoja për të përmirësuar më shpejt parametrat kryesorë të financave publike pas përkeqësimit të ndjeshëm në vitin 2020. Prandaj, në programin aktual trevjeçar qëndrimi kumulativ fiskal gjatë vitit 2022–2024 synohet të jetë prociklik në terma kumulativë për tërë horizontin kohor.

4.6 Niveli i borxhit dhe zhvillimet

Ecuria e borxhit të qeverisjes qendrore

Përgjatë periudhës janar–shtator 2021, portofoli i borxhit është menaxhuar në përputhje me objektivat e Strategjisë Afatmesme të Menaxhimit të Borxhit (SAMB), për të siguruar mbajtjen e raporteve të qëndrueshme ndërmjet kostos dhe risqeve. Pavarësisht nevojave të larta që karakterizuan edhe këtë vit, në vijim të vitit 2020, që u godit nga pandemia COVID-19, dhe vitit 2019, kur Shqipëria u godit nga një tërmet i fuqishëm, huamarrja gjatë kësaj periudhe ka arritur të përmbushë plotësisht nevojat buxhetore, si edhe të gjitha nevojat që burojnë nga detyrimet e borxhit ekzistues. Huamarrja u realizua duke përdorur burimet e brendshme të financimit dhe të ato të huaja, përkatësisht në nivelet 279.3 miliardë lekë dhe 31.7

miliardë lekë. Gjithashtu, gjatë kësaj periudhe, është vijuar me aktivitetet që kanë synuar zhvillimin e mëtejshëm të tregut primar. Në këtë drejtim, pas shtatorit 2021 vlen për t'u përmendur emetimi me sukses i Eurobondit me vlerë 650 milionë euro në tregjet ndërkombëtare, i cili përveçse plotësoi nevojat për likuiditet, përçoi një sinjal pozitiv për sa i përket aftësisë për të siguruar fonde dhe qëndrueshmërisë së financave publike në Republikën e Shqipërisë.

Borxhi i qeverisjes qendrore

Në fund të muajit shtator 2021, borxhi i qeverisjes qendrore u vlerësua në nivelin 1,281.8 miliardë lekë ose 76.2% e PBB[8]. Në terma nominalë, stoku i borxhit të qeverisjes qendrore është rritur me rreth 57.8 miliardë lekë krahasuar me fundin e vitit 2020, nga të cilat 53 miliardë lekë i përkasin borxhit të brendshëm dhe 4.8 miliardë lekë borxhit të jashtëm. Në fund të muajit shtator 2021, stoku i borxhit ndaj PBB-së është ulur në krahasim me fundin e vitit 2020. Gjithsesi, kjo është një rënie e përkohshme, pasi huamarrja e jashtme kryesore është kryer pas shtatorit 2021 dhe do të ndikojë ndjeshëm në nivelin e borxhit.

Tabelë 4.6.1 Stoku i borxhit të qeverisjes qendrore (në milionë lekë)

	2016	2017	2018	2019	2020	Sht-2021
Stoku I Borxhit Gjithsej (I+II)	**1,065,709.0**	**1,087,341.9**	**1,106,568.8**	**1,112,044.2**	**1,224,038.2**	**1,281,791.3**
I. Stoku I Borxhit të Brendshëm	**561,120.0**	**577,055.7**	**580,310.3**	**597,290.0**	**644,087.8**	**697,043.4**
Shtetëror	530,834.0	546,938.7	565,092.5	582,135.6	630,791.1	682,829.4
Garancia	30,286.0	30,117.0	15,217.8	15,154.4	13,296.7	14,214.0
II. Stoku I Borxhit të Jashtëm	**504,589.0**	**510,286.2**	**526,258.5**	**514,754.2**	**579,950.4**	**584,747.9**
Shtetëror	481,407.0	490,517.9	496,804.2	488,055.8	544,434.4	551,423.0
Garancia	23,182.0	19,768.2	29,454.3	26,698.4	35,516.0	33,324.9
PBB	**1,472,479.6**	**1,550,644.0**	**1,635,715.0**	**1,679,284.2**	**1,572,269.4**	**1,682,636.9**
Stoku I Borxhit Gjithsej/ PBB	72.4%	70.1%	67.7%	66.2%	77.9%	76.2%
Stoku I Borxhit të Brendshëm/ PBB	38.1%	37.2%	35.5%	35.6%	41.0%	41.4%
Stoku I Borxhit të Jashtëm/ PBB	34.3%	32.9%	32.2%	30.7%	36.9%	34.8%

Burimi: Ministria e Financave dhe Ekonomisë (2021)

Për sa i përket kompozimit sipas instrumenteve, më shumë se 60% e peshës së portofolit të borxhit të qeverisjes qendrore vazhdojnë ta mbajnë instrumentet e tregtueshme (bono thesari, obligacione, Eurobond). Instrumentet e tregtueshme kanë shënuar një rritje të peshës me 1 pp krahasuar me fundin e vitit 2020, ndërkohë kreditë për projekte janë reduktuar me të njëjtën masë.

Grafik 4.6.1 Kompozimi i borxhit të qeverisjes qendrore sipas instrumenteve



Burimi: Ministria e Financave dhe Ekonomisë (2021)

Në përputhje me objektivat për reduktimin e ekzpozimit të portofolit të borxhit ndaj risqeve, pesha e instrumenteve afatgjata u rrit me 0.4 pikë përqindjeje.

Grafik 4.6.2 Kompozimi i borxhit sipas maturitetit origjinal të instrumenteve të huas

[8] PBB në bazë vjetore, referuar Draftkuadrit Makroekonomik dhe Fiskal 2022–2024.



Burimi: Ministria e Financave dhe Ekonomisë (2021)

Burimet e financimit

Gjatë periudhës janar–shtator 2021, nevojat për hua vijuan të jenë të larta në krahasim me periudha të zakonshme, si rezultat i situatës së pandemisë COVID-19, e cila vazhdon të jetë prezente, si dhe nevojës për të stimuluar rimëkëmbjen e ekonomisë pas rënies së madhe që pati në vitin 2020. Pavarësisht nevojave për financim të rritura, huamarrja ka arritur të përmbush plotësisht nevojat buxhetore, si edhe të gjitha nevojat që burojnë nga detyrimet e borxhit ekzistues.

Gjatë nëntëmujorit të vitit 2021, Ministria e Financave dhe Ekonomisë ka emetuar në tregun e brendshëm tituj shtetërorë në vlerën 279.3 miliardë lekë, nga të cilat 233.6 miliardë lekë shërbyen për rifinancimin e titujve ekzistues. Në përputhje me objektivat strategjikë, huamarrja e re u realizua kryesisht nëpërmjet titujve afatgjatë.

Tabelë 4.6.2 Huamarrja e Brendshme (janar –shtator 2021)

Lloji I Instrumentit	Janar-Shtator 2021			
	Emetime (në mld Lekë)	Maturime (në mld Lekë)	Financime Neto (në mld Lekë)	Financime Neto (në %)
Instrumente Afatshkurtra	**178.7**	**171.6**	**7.1**	**15.5%**
Bono Thesari	178.7	171.6	7.1	15.5%
Bono Thesari Euro	0.0	0.0	0.0	0.0%
Instrumente Afatgjata	**100.6**	**62.0**	**38.7**	**84.5%**
Obligacione 2 vjeçare	37.7	31.8	5.9	12.8%
Obligacione 2 vjeçare në Euro	0.0	0.0	0.0	0.0%
Obligacione 3 vjeçare	15.1	5.0	10.1	22.0%
Obligacione 5 vjeçare	19.7	14.5	5.2	11.4%
Obligacione 7 vjeçare	14.1	10.6	3.6	7.8%
Obligacione 10 vjeçare	13.9	0.0	13.9	30.5%
Total	**279.3**	**233.6**	**45.7**	**100.0%**

Burimi: Ministria e Financave dhe Ekonomisë (2021)

Huamarrja e huaj gjatë nëntë muajve të vitit 2021 u realizua në nivelin prej 258 milionë eurosh. Përveç huave për financimin e projekteve nga kreditorët dypalësh dhe shumëpalësh, gjatë kësaj periudhe vlen për t'u përmendur:

- Mbështetja buxhetore e Bankë Botërore në vlerën 80 milionë USD në politikat për zhvillimin e qëndrueshmërisë dhe rritjes fiskale.
- Mbështetja buxhetore e Bashkimit Evropian, kësti i parë në vlerën 90 milionë euro për asistencën makrofiskale.

Tabelë 4.6.3 Huamarrja e huaj

	9m. 2020		9m. 2021	
	Shuma (në mln EUR)	% Totalit	Shuma (në mln EUR)	% Totalit
Disbursimet Total	**923.6**	**100.0%**	**258.0**	**100.0%**
Eurobond	645.1	69.8%	0.0	0.0%
Mbështetje Buxhetore	185.7	20.1%	157.4	61.0%
Hua për financim projektesh	92.8	10.1%	100.6	39.0%

Burimi: Ministria e Financave dhe Ekonomisë (2021)

Kostot dhe risqet

Kushtet e favorshme në tregjet e brendshme dhe të jashtme për sa i përket kërkesës për borxh, si dhe mjedisi i favorshëm i normave të interesit, shoqëruar me një strategji huamarrje të mbështetur kryesisht në titujt afatgjatë me norma interesi fikse, mundësuan reduktimin e mëtejshëm të ekspozimit ndaj risqeve si edhe mbajtjen e kostos nën kontroll.

Gjithashtu, në portofolin e borxhit të brendshëm ka vazhduar përmirësimi i mëtejshëm i raportit kosto risk, dhe YMP ka shënuar rënie pavarësisht rritjes së peshës së instrumenteve afatgjata në portofol.

Grafik 4.6.3 Borxhi i brendshëm afatshkurtër/borxhi i brendshëm afatgjatë & YMP



Burimi: Ministria e Financave dhe Ekonomisë (2021)

Shpenzimet për interesa gjatë periudhës janar–shtator të vitit 2021 janë vlerësuar në 28.4 miliardë lekë. Krahasuar me të njëjtën periudhë të vitit 2020, shpenzimet për interesa të borxhit shtetëror janë rritur me 3.8 miliardë lekë, kryesisht si rezultat i një stoku më të lartë të borxhit për periudhën e referuar.

Grafiku 4.6.4 Interesat e borxhit shtetëror në vlerë absolute dhe relative ndaj PBB-së



Burimi: Ministria e Financave dhe Ekonomisë (2021)

Në periudhën afatmesme, pritet një rritje graduale e shpenzimeve për interesa në vlerë nominale, kryesisht si rezultat i rritjes së stokut të borxhit. Gjithashtu, në terma relativë ndaj PBB-së dhe të

ardhurave tatimore, kosto e borxhit pritet të rritet gradualisht.

Grafik 4.6.5 Shpenzimet për interesa dhe interesa ndaj PBB-së dhe të ardhurave tatimore



Burimi: Ministria e Financave dhe Ekonomisë (2021)

Reduktimi i riskut të rifinancimit dhe riskut të normave të interesit në tregun e brendshëm është ndër objektivat parësorë në menaxhimin e portofolit të borxhit. Në këtë drejtim, pavarësisht situatës së krijuar nga përhapja së pandemisë COVID-19, e cila shkaktoi një rritje të nevojave për huamarrje, raportet e riskut në portofolin e borxhit të brendshëm kanë qenë në nivele të qëndrueshme.

Borxhi i jashtëm paraqet më pak risk se borxhi i brendshëm, kryesisht pasi është i kompozuar nga instrumente me afat të gjatë maturimi dhe një pjesë e konsiderueshme e tij është me terma koncesionalë.

Risku i rifinancimit është përmirësuar si rezultat i reduktimit të peshës së instrumenteve afatshkurtra. Jetëgjatësia e borxhit të brendshëm është rritur duke prekur nivelin e 796 ditëve në fund të muajit shtator 2021, krahasuar me 783 ditë në fund të vitit 2020.

Risku i normave të interesit, gjithashtu, është përmirësuar, si rezultat i reduktimit të peshës së instrumenteve me afat të shkurtër maturimi dhe instrumenteve me norma interesi të ndryshueshme. Koha mesatare e rivlerësimit të normës së interesit është rritur nga 2.14 në 2.19 vite. Ndërkohë, pesha e instrumenteve që rivlerësojnë normën e interesit në harkun kohor të një viti është rritur nga 46.7% në dhjetor 2020 në 49% në shtator 2021, si rezultat i përfshirjes rregullisht të instrumenteve me maturim afatshkurtër (3M dhe 6M) në ankandet e tregut vendës.

Tabelë 4.6.4 Treguesit e riskut të normave të interesit në borxhin e brendshëm

Treguesi	2018	2019	2020	Sht-2021
Obligacione me norma interesi të ndryshueshme/ Totalit	6.5%	4.8%	2.9%	1.9%
Obligacione me norma interesi fikse/ Totalit	59.1%	62.0%	65.3%	67.4%
Borxhi i rivlerësuar në një vit/ Totalit	54.3%	50.9%	46.7%	49.1%

Burimi: Ministria e Financave dhe Ekonomisë (2021)

Pavarësisht zhvillimeve pozitive të tregut të brendshëm, portofoli i borxhit vazhdon të jetë i ekspozuar ndaj riskut të rifinancimit dhe riskut të normave të interesit. Nisur nga ky fakt, në të ardhmen, menaxhimi i borxhit të vazhdojë përpjekjet për zgjatjen e mëtejshme të jetëgjatësisë së borxhit të brendshëm si edhe mbajtjen nën kontroll të peshës së instrumenteve me norma interesi të ndryshueshme.

Zhvillimi i tregut primar

Tregu primar i titujve shtetërorë gjatë periudhës janar–shtator të vitit 2021, përgjithësisht është karakterizuar nga zhvillime pozitive, ndër të cilat mund të përmenden: i. kërkesa e kënaqshme e tregut në raport me nevojat e qeverisë për huamarrje; ii. vijimi me projektin *market maker* për emetimin e obligacionit 3-vjeçar dhe 5-vjeçar reference.

Gjatë periudhës nëntëmujore, kërkesa për tituj shtetërorë ka rezultuar në vlerën 376.2 miliardë lekë, nga të cilat 224.8 miliardë lekë për bono thesari dhe 151.4 miliardë lekë për obligacione. Kërkesa ka qenë relativisht më e lartë se oferta e qeverisë për tituj shtetërorë, duke rezultuar në një raport të përgjithshëm

mbulimi prej 1.36 herësh. Për sa u përket karakteristikave të kërkesës, kërkesa e investitorëve për bono thesari 3-mujore dhe 6-mujore vijon të jetë prezente, edhe pse jo e lartë, dhe këto instrumente përdoren kryesisht në menaxhimin e likuiditetit. Ndërkohë, instrumentet me maturim afatgjatë (obligacione 5-vjeçare, obligacione 7-vjeçare dhe 10-vjeçare) kanë treguar një kërkesë shumë të mirë.

Grafik 4.6.6 Kërkesa dhe oferta për tituj shtetërorë në tregun e brendshëm



Burimi: Ministria e Financave dhe Ekonomisë (2021)

Në vazhdim të angazhimit të marrë, në lidhje me përmirësimin e mëtejshëm të tregut primar të titujve shtetërorë, si edhe hedhjen e hapave për funksionimin e tregut sekondar, përgjatë vitit 2021 janë ndërmarrë aktivitete që kanë për qëllim reduktimin e fragmentizimit të kërkesës dhe krijimin e madhësive *benchmark* për titujt afatgjatë. Për sa i përket krijimit të madhësive *benchmark*, ka vazhduar implementimi i projektit për emetimin e obligacioneve 3- dhe 5-vjeçare referencë. Rezultatet e këtij projekti kanë qenë pozitive në kuadër të rritjes së aktivitetit të tregtimit të titujve në tregun sekondar. Për më tepër, numri i titujve të emetuar është konsoliduar duke përdorur ankandet e rihapjes së titujve ekzistues në vend të emetimeve të reja.

Grafik 4.6.7 Ecuria e ankandeve në tregun primar



Burimi: Ministria e Financave dhe Ekonomisë 2021

Në periudhën afatmesme, zhvillimi i tregut primar do të bazohet kryesisht në aktivitetet të cilat kanë për qëllim rritjen e likuiditetit, eficiencës dhe transparencës.

Ecuria e normave të interesit

Gjatë vitit 2021, normat e interesit në tregun e letrave me vlerë kanë shënuar ulje të ndjeshme krahasuar me fundin e vitit 2020, pavarësisht nga rritja e nevojave të financimit. Normat e interesit të instrumenteve me maturitet më të gjatë (5Vj, 7Vj dhe 10Vj) kanë qenë më të ulëta se vitin e kaluar. Instrumentet afatshkurtra, bonot e thesarit kanë pësuar një ulje të lehtë të normës. Instrumentet me maturitet afatmesëm (2VJ dhe 3VJ) gjatë 2021 kanë shfaqur norma lehtësisht më të larta krahasuar me ato të vitit 2020.

Grafik 4.6.8 Yield-i mesatar i ponderuar



Burimi: Ministria e Financave dhe Ekonomisë (2021)

Detyrimet kontigjente

Në fund të muajit shtator 2021, portofoli i borxhit të garantuar vlerësohet në 47.5 miliardë lekë (2.8% e PBB) ose 3.7% e portofolit të borxhit të qeverisjes qendrore. Garancitë në tregun e brendshëm përfaqësojnë 29.9% të totalit të stokut të borxhit të garantuar ose 14.2 miliardë lekë, ndërsa garancitë e emetuara në favor të kreditorëve të huaj përfaqësojnë 70.1% të stokut të borxhit të garantuar ose 33.3 miliardë lekë. Gjatë vitit 2020, Qeveria e Republikës së Shqipërisë emetoi dy garanci shtetërore, në kuadër të menaxhimit të situatës së krijuar nga pandemia COVID-19.

Për të mbështetur tregtarët dhe shoqëritë tregtare me likuiditet, qeveria e Republikës së Shqipërisë emetoi garancinë shtetërore në shumën prej 11.0 miliardë lekësh, për kompanitë që kishin vështirësi në pagimin e pagave të punonjësve. Shpenzimet e interesit mbulohen plotësisht nga qeveria dhe nuk kërkohet asnjë kolateral nga kompanitë. Përveç garancisë së parë, qeveria e Republikës së Shqipërisë emetoi një garanci shtetërore të dytë, në shumën prej 15.0 miliardë lekësh, duke siguruar hua për kapital qarkullues dhe investime për të gjithë sektorët e ekonomisë. Qeveria garantoi 60% , e cila nënkupton se skema e dytë e garancisë mund të garantojë kreditimin e biznesit deri në shumën prej 25 miliardë lekësh. Deri në fund të muajit shtator 2021 nga këto garanci janë aprovuar kredi në vlerën prej: i. rreth 5.9 miliardë lekë (nga të cilat 5.3 miliardë lekë të disbursuara) për garancinë e parë; dhe ii. rreth 16.5 miliardë lekë (prej të cilave 16.1 miliardë lekë të disbursuara) për garancinë e dytë. Afati i fundit i aplikimit për të dyja skemat e garancive ka përfunduar. Deri në fund të shtatorit 2021 stoku i garancive është 10.1 miliardë lekë ose ndryshe 21.3% e stokut total të garantuar.

Përveç garancive për biznesin, në kuadër të situatës së krijuar nga COVID-19, portofoli i garancive të brendshme përbëhet nga linja kredie afatshkurtra dhe me norma interesi tregtare, të cilat i janë akorduar KESH sh.a. nga bankat tregtare vendëse. Në dallim nga garancitë e brendshme, garancitë e huaja janë kredi afatgjata të akorduara kryesisht me norma interesi koncesionale.

Grafik 4.6.9 Garancitë sipas rezidencës së kreditorit



Burimi: Ministria e Financave dhe Ekonomisë (2021)

Grafik 4.6.10 Garancitë shtetërore sipas sektorëve



Burimi: Ministria e Financave dhe Ekonomisë (2021)

Në periudhën afatmesme, niveli i garancive është planifikuar të qëndrojë në nivelin 5%–6 % ndaj PBB-së, dhe garancitë e reja do të emetohen kryesisht:

- Për të mbështetur projektet zhvillimore, të cilat kontribuojnë në përmirësimin e infrastrukturës, zhvillimin rajonal, mbrojtjen e mjedisit dhe krijimin e vendeve të reja të punës;
- Për të mbështetur masat e mundshme të ndërmarra, në rast të përkeqësimit të sistemit financiar;
- Për të menaxhuar risqet dhe kostot e portofolit ekzistues të detyrimeve kontingjente.

Koncesionet dhe PPP-të

Njësia e Monitorimit të Risqeve Buxhetore në Drejtorinë e Menaxhimit të Buxhetit monitoron vetëm ecurinë e pagesave faktike dhe të planifikuara (brenda vitit buxhetor) dhe treguesit e performancës, për kontratat koncesionare/PPP me mbështetje buxhetore. Aktualisht, janë 13 kontrata koncesionare/PPP aktive me mbështetje buxhetore.

Për vitin 2021, plani fillestar vjetor për kontratat koncesionare/PPP me mbështetje buxhetore, rezultonte rreth 12.72 miliardë lekë (rreth 5.44 miliardë lekë investime dhe rreth 7.27 miliardë lekë shpenzime korrente).

Fondet buxhetore të planifikuara për vitin 2021, sipas planit të ndryshuar, me destinacion mbështetjen buxhetore për kontratat koncesionare/PPP, rezultojnë në total rreth 12.11 miliardë lekë. Nga këto, rreth 5.4 miliardë lekë investime dhe rreth 6.7 miliardë lekë shpenzime korrente.

Krahasuar me planin fillestar vjetor 2021, plani i ndryshuar vjetor rezulton rreth 608.05 milionë lekë më i ulët. Ndryshimet i referohen konkretisht:

- pakësimit prej 40.45 milionë lekësh për kontratën "Ndërtimi dhe operimi i Porti Jahteve Orikum-Dukat";
- pakësimi prej 510 milionë lekësh për kontratën e "Kontrollit bazë të popullsisë *(check up)*";
- pakësimi prej 140 milionë lekësh për kontratën "Ofrimi i setit të personalizuar të instrumenteve kirurgjikale";
- pakësimi prej 25 milionë lekësh për kontratën e "Ofrimit të shërbimit të dializës";
- pakësimit prej 142.6 milionë lekësh për kontratën e "Ofrimit të shërbimeve laboratorike spitalore";
- shtesës prej 250 milionë lekësh, nga fondet e Bashkisë Tiranë, për kontratën "Për ndërtimin e landfillit, inceneratorit dhe rehabilitimin e venddepozitimeve ekzistuese Tiranë dhe prodhimin e energjisë elektrike".

* Kontrata e "Kontrollit bazë të popullsisë *(check up)"* u ndërpre përkohësisht (deri në muajin gusht 2021), për shkak të pandemisë COVID-19 dhe rifilloi zbatimin në muajin shtator 2021.

Ndërkohë, bazuar në VKM-në nr. 702, datë 18.11.2021, "Për një ndryshim në vendimin nr. 20, datë 20.1.2021, të Këshillit të Ministrave, "Për financimin e shërbimeve shëndetësore spitalore nga skema e detyrueshme e sigurimeve të kujdesit shëndetësor për vitin 2021", të ndryshuar, plani vjetor i pagesave për kontratat koncesionare/PPP me mbështetje buxhetore: "Ofrimi i setit të personalizuar të instrumenteve

kirurgjikale", "Ofrimi i shërbimit të dializës" dhe "Ofrimi i shërbimeve laboratorike spitalore", është pakësuar.

Krahasuar me pagesat faktike të vitit 2020 të cilat arritën vlerën rreth 9.63 miliardë lekë, pagesat e planifikuara për vitin 2021, sipas planit të ndryshuar, janë 25.7% më të larta ose rreth 2.48 miliardë lekë më shumë. Kjo duke konsideruar faktin se, për vitin 2021 janë planifikuar fonde për kontrata të cilat gjatë vitit 2020 patën pakësime të konsiderueshme, për shkak të situatës së pandemisë COVID-19, me qëllim lehtësimin e barrës buxhetore të vitit të vështirë 2020.

Pagesat faktike për periudhën 11-mujore 2021, për kontratat koncesionare/PPP me mbështetje buxhetore rezultojnë në masën rreth 9.24 miliardë lekë ose 76.3% të pagesave të planifikuara, sipas planit vjetor, të rishikuar, për vitin 2021.

Referuar periudhës 11-mujore 2021, niveli më i lartë i pagesave është realizuar në muajin shtator 2021, me rreth 1.7 miliardë lekë, ku veçojmë pagesën prej 1.02 miliardë lekësh për kontratën "Për përmirësimin, ndërtimin, operimin dhe mirëmbajtjen e Rrugës së Arbrit".

Krahasuar me të njëjtën periudhë të një viti më parë, ku pagesat faktike 11-mujore të vitit 2020 arritën në nivelin rreth 7.95 miliardë lekë, pagesat faktike 11-mujore të vitit 2021 rezultojnë rreth 1.3 miliardë lekë më të larta. Kjo rritje ka ardhur kryesisht si pasojë e pagesave më të larta të realizuara specifikisht për kontratat:

- "Për përmirësimin, ndërtimin, operimin dhe mirëmbajtjen e Rrugës së Arbrit" ku pagesat faktike 11-mujore 2021 rezultojnë rreth 433.6 milionë lekë më të larta se e njëjta periudhë e një viti më parë. Lidhur me këtë rritje të pagesave për vitin 2021, në raportimin e muajit shtator 2021, nga ana e autoritetit kontraktor u raportuar se projekti arriti në 9-mujorin e fundit të punimeve (sipas kontratës) dhe investimi në ndërtim në masën 70 për qind. Për këtë arsye, bazuar në grafikun e punimeve dhe modelin financiar të kontratës, kështet pas muajit qershor 2021 janë më të larta.
- "Ofrimi i shërbimeve laboratorike spitalore" ku pagesat faktike 11-mujore 2021 rezultojnë rreth 712.8 milionë lekë ndërkohë që, për të njëjtën periudhë të një viti më parë, nuk rezultonin pagesa të realizuara për këtë kontratë. Kjo duke konsideruar faktin se, për vitin 2020, për shkak të situatës së pandemisë, u shty fillimi i funksionimit të kësaj kontrate deri në muajin nëntor 2020 dhe si rrjedhojë, fondet e planifikuara për vitin 2020 u pakësuan me 720 milionë lekë nga plani fillestar vjetor.
- "Shërbimi i skanimit në dogana", ku pagesat faktike 11-mujore 2021 rezultojnë rreth 315.6 milionë lekë më shumë se e njëjta periudhë e një viti më parë. Gjatë vitit 2020, kjo kontratë vazhdoi funksionimin normal, edhe pse pagesat nga muaji gusht (pjesërisht) deri në nëntor 2020, u shtynë (me marrëveshje negocimi) për t'u paguar me këste gjatë vitit 2022, pa aplikuar penalitete.

Tabelë 4.6.5 Pagesat faktike/të planifikuara për kontratat koncesionare/PPP me mbështetje buxhetore, për 11M 2020 dhe 2021

Autoriteti Kontraktor	Nr.	Emërtimi i Kontratës PPP	Viti i fillimit	Viti i mbarimit	Programi	Lloji i Shpenzimit	në 000 LEK 2020		2021				Diferenca
							Fakt 11M	Fakt 12M	Fakt 11M	Plan fillestar vjetor	Plan i rishikuar vjetor	% e realizimit (fakt 11M/plan vjetor i ndryshuar)	Fakt 11M 2021-11M 2020
Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë	1	Ndërtimi, operimi dhe transferimi i inceneratorit për përpunimin e mbetjeve urbane të Bashkisë së Elbasanit	2015	2021	06220	Investime	351,669	582,720	40,292	50,000	50,000	81%	-311,377
	2	Ndërtimi, operimi dhe transferimi i inceneratorit për përpunimin e mbetjeve urbane të Bashkisë Fier	2016	2022	06220	Investime	506,693	752,770	627,309	752,771	752,771	83%	120,617
	3	Ndërtimi dhe Operimi i Rrugës së Arbrit	2018	2031	04520	Investime	2,027,110	2,691,055	2,460,737	3,375,100	3,375,100	73%	433,627
	4	Ndërtim, Operim dhe Mirëmbajtje e Rrugës Milot-Morinë	2017	2047	04520	Investime	795,300	811,734	790,027	810,259	810,259	98%	-5,273
	5	Ndërtimi dhe Operimi i Portit Jahteve Orikum - Dukat	2018	2030	04520	Investime	0	0	34,023	393,979	353,529	10%	34,023
	6	Ndërtimi dhe Operimi i Rrugës Milot - Balldren	2018	2032	04520	Investime	0	0	0	65,000	65,000	0%	0
Ministria e Financave dhe Ekonomisë	1	Financimi, ngritja dhe operimi i shërbimit të skanimit të konteinerve e automjeteve të tjera në Republikën e Shqipërisë	2013	2030	01150	Korente	1,137,705	1,140,893	1,453,316	1,580,698	1,580,698	92%	315,611
Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale	1	Për paketën e shërbimeve të kontrollit mjekësor bazë (Check-up)	2015	2025	07220	Korente	322,322	322,322	73,007	876,090	366,090	20%	-249,315
	2	Koncesioni/PPP (Ofrimi i setit të personalizuar të instrumenteve kirurgjikale, material mjekësor steril njëpërdorimësh në sallat kirurgjikale, trajtimi i mbetjeve biologjike dhe dezinfektimi i sallave kirurgjikale)	2016	2026	07330	Korente	1,077,991	1,288,269	1,226,928	1,704,982	1,564,982	78%	148,938
	3	Koncesioni/PPP (Ofrimi i shërbimit të dializës)	2016	2026	07330	Korente	654,690	733,203	666,095	779,000	754,000	88%	11,405
	4	Ofrimi i shërbimeve laboratorike spitalore	2020	2030	07330	Korente	0	30,670	712,775	1,280,444	1,137,845	63%	712,775
Bashkia Tiranë/Ministria e Arsimit, Sportit dhe Rinisë	1	Ndërtimi i Shkollave të Arsimit Parauniversitar në Bashkinë e Tiranës	2018	2025	09120	Investime	0	0	0	0	0	0%	0
Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë/ Bashkia Tiranë	1	Construction of landfill, incinerator and rehabilitation of existing landfill of Tirana and electricity generation	2017	2047	06220 5100	Korente	1,080,000	1,280,000	1,159,443	1,050,000	1,300,000	89%	79,443
	13	TOTAL					7,953,479	9,633,635	9,243,953	12,718,323	12,110,274	76%	1,290,474

Burimi: Ministria e Financave dhe Ekonomisë (2021)

4.7 Analiza e ndjeshmërisë dhe krahasimi me programin e mëparshëm

Ky seksion paraqet ndikimet e pritshme në kuadrin fiskal, si dhe rregullimet e mundshme të politikave fiskale dhe ato buxhetore sipas secilit skenar. Kjo është në përputhje me të dy skenarët alternativë makroekonomikë të paraqitur në seksionin 3.3.

Në rastin e skenarit makroekonomik "pesimist", i cili supozon një rritje ekonomike dukshëm më të ulët për çdo vit krahasuar me skenarin "bazë", do të ishte e arsyeshme dhe e përshtatshme për të supozuar efikasitet më të ulët të mbledhjes së taksave për një numër të komponentëve kryesorë të taksave. Ndërsa, efektiviteti më i lartë i mbledhjes së taksave mund të pritet nëse do të ndodhë skenari makroekonomik "optimist". Prandaj, për të llogaritur ndryshimet e mundshme në performancën e mbledhjes së të ardhurave nën secilin skenar alternativ, si dhe për të llogaritur "një efekt të përgjithshëm neto" të stabilizuesve automatikë, në rastin e skenarit pesimist ne afektojmë "raportin e të ardhurave totale ndaj PBB-së "me një të tretën e goditjeve përkatëse (në p.p) të prezantuara në "rritjen reale" për çdo vit dhe në mënyrë asimetrike e afektojmë këtë variabël me një të dhjetën në rastin e skenarit "optimist".

Ndërsa në secilin skenar alternativ mbajmë të njëjtin supozim të normave efektive të interesit si në skenarin bazë (të përcaktuara si shpenzime interesi në vitin "t", të pjesëtuar me stokun e borxhit në vitin "t-1"), ne llogaritim ndryshimet në nivelet e shpenzimeve të interesit, për shkak të huamarrjes më të lartë ose më të ulët sipas secilit skenar. Kursi i supozuar nominal i këmbimit mbetet, gjithashtu, identik në të gjithë skenarët. Duhet të theksohet se materializuar në buxhetin e çdo viti ekziston, gjithashtu, një kontigjencë (ligjërisht i detyrueshëm sipas përcaktimeve në LOB) me rreth 0.3 për qind të PBB-së që do të mbulonte çdo shpenzim më të lartë interesi, për shkak të ndonjë rritjeje në normat e interesit ose zhvlerësimit të kursit të këmbimit.

Pajtueshmëria me rregullat fiskale në LOB dhe, rrjedhimisht, politika fiskale e përgjithshme konsoliduese ruhet në çdo skenar makroekonomik. Sidoqoftë, objektivi sasior i deficitit fiskal vjetor ndryshon në secilin skenar, duke reflektuar kryesisht një përgjigje kundërciklike ndaj dinamikave të ndryshme të supozuara të ciklit ekonomik, sa herë që është e mundur në përputhje me rregullat fiskale. Më konkretisht, parashikohet një zbutje e objektivit të deficitit fiskal në rastin e skenarit "pesimist" dhe një konsolidim fiskal më i fortë në rastin e skenarit "optimist".

Në skenarin "pesimist", zbutja e politikës fiskale, krahasuar me skenarin "bazë", do të materializohej deri në masën që të gjithë parametrat kryesorë të financave publike (p.sh. raporti i borxhit ndaj PBB-së, bilanci primar dhe bilanci aktual) do të mbeten në të njëjtën kohë, në përputhje me të gjitha rregullat përkatëse fiskale të përcaktuara në ligjin organik të buxhetit. Rregullimet (masat) e nevojshme të shpenzimeve për të siguruar pajtueshmërinë me rregullat fiskale sipas skenarit "pesimist" kryhet në "shpenzimet e kapitalit me financim të brendshëm", si dhe në "shpenzimet operacionale dhe të mirëmbajtjes". Më konkretisht, ulja mesatare vjetore e shpenzimeve kapitale gjatë viteve 2022–2026, sipas skenarit "pesimist" kundrejt "bazës" është 26.3 miliardë lekë ose 1 për qind e PBB-së mesatarisht për çdo vit. Nën skenarin "pesimist", niveli mesatar vjetor i totalit të shpenzimeve kapitale gjatë 2022–2026 bie në 4.5 për qind të PBB-së nga 5.5 për qind e PBB-së së planifikuar në skenarin "bazë". Shpenzimet operacionale dhe të mirëmbajtjes gjatë viteve 2022–'26 zvogëlohen me një mesatare prej 12.2 miliardë lekësh në vit krahasuar me skenarin bazë, ose mesatarisht me 0.5 për qind të PBB-së në vit.

Në skenarin "optimist" të gjithë zërat diskrecionalë të shpenzimeve në terma nominalë supozohen identikë si në skenarin "bazë" dhe të gjitha të ardhurat e papritura reflektohen si një bilanc i përgjithshëm fiskal më i lartë (d.m.th. deficit më i ulët) për çdo vit, krahasuar me skenarin "bazë".

Në mënyrë që të shërbejë në mënyrë adekuate të gjitha nevojat e shërbimit të buxhetit dhe borxhit (d.m.th. nevojat e financimit) gjatë horizontit kohor prej pesë vjetësh (përfshirë 2026), tri zëra financimi, përkatësisht "huamarrja e brendshme neto", "ndryshimi i stokut të likuiditetit në TSA" dhe "stoku i likuiditetit në TSA" janë optimizuar njëkohësisht në secilin skenar alternativ, më e rëndësishmja në atë "pesimist". Ndërsa, huamarrja e huaj neto, si në huamarrjen tregtare, ashtu edhe në atë koncesionale, në të dy skenarët alternativë mbeten saktësisht të njëjtë si në skenarin "bazë".

Një supozim i nënkuptuar në rastin e skenarit "pesimist" të paraqitur këtu është se, së pari, inflacioni do të mbetet në përputhje me objektivin e politikës monetare dhe inflacioni i pritur do të mbetet i mirë ankoruar dhe së dyti, qëndrimi i politikës monetare do të mbetet përgjithësisht lehtësues, por gjithsesi plotësisht brenda në kornizë konvencionaleve, pa ndonjë përdorim të paketës "jokonvencionale". Ndërsa, vetëm në një skenar tjetër "shumë ekstrem pesimist", që do të thotë vetëm në rast të një krize të rëndë ekonomike, e cila seriozisht do të rrezikonte stabilitetin makroekonomik dhe perspektivën afatgjatë, mund të supozohet se mund të përdoret çdo mundësi e disponueshme dhe e përshtatshme e instrumentit të veçantë "jokonvencional" i politikës monetare, vetëm si një mundësi e fundit dhe në një rast të tillë, me sa duket nën një koordinim dhe mbikëqyrje shumë të ngushtë të institucioneve ndërkombëtare partnere. Në të njëjtën kohë, do të ishte mjaft e arsyeshme të supozohet se në një skenar të tillë "shumë ekstrem pesimist", një gamë më e gjerë dhe më e thellë e rregullave/masave/reformave të financave publike mund dhe duhet të ndërmerren, dhe ndoshta të shtrihet në të gjithë sektorin publik dhe në mallrat/shërbimet publike.

Grafikët dhe tabelat vijuese paraqesin implikimet kryesore fiskale të skenarëve alternative.

Grafik 4.7.1 Dinamika e treguesve kryesorë në skenarë të ndryshëm



Burimi: Ministria e Financave dhe Ekonomisë (2021)

Tabelë 4.7.1A Të ardhurat dhe shpenzimet kryesore për secilin skenar (miliardë lekë)

	2016	2017	2018	2019	2020	2021	2022	2023	2024	2025	2026
						Vler	Para	Para	Para	Para	Para
					Të ardhurat totale						
Bazë	407.0	430.4	449.9	460.3	425.9	506.9	536.8	569.7	601.8	637.0	673.6
Pesimist							519.9	543.9	566.2	590.7	615.7
Optimist							540.3	576.2	611.6	650.4	691.1
					Shpenzimet totale						
Baza nga e cila:	433.7	461.4	476.1	491.9	536.3	610.2	637.7	627.7	660.7	698.6	726.1
Shpenzimet korrente nga të cilat:	368.7	382.3	397.3	416.9	421.4	464.0	505.7	522.6	548.5	574.8	598.2
Operacionale & Mirëmbajtje	44.3	43.4	45.5	47.2	48.9	58.8	62.9	59.5	61.5	64.7	66.6
Interesat	36.3	31.9	36.5	35.1	34.4	36.3	50.8	57.5	65.5	71.4	77.5
Shpenzimet kapitale nga të cilat:	59.5	68.5	78.4	75.0	101.7	143.2	120.4	101.6	108.7	118.4	122.9
Financim i brëndshëm	39.1	46.2	52.2	51.5	60.6	79.2	62.6	62.1	66.4	69.4	72.3
Financim i jashtëm	20.4	22.3	26.2	23.5	24.5	29.0	36.0	37.7	40.4	46.6	46.6
Fondi i rindërtimit					16.6	35.0	20.0	0.0	0.0	0.0	0.0
Pesimist nga e cila:							616.7	592.7	621.7	649.1	678.1
Shpenzimet korrente nga të cilat:							497.7	512.6	538.5	557.8	582.2
Operacionale & Mirëmbajtje							54.9	49.5	51.5	47.7	50.6
Interesat							50.8	57.5	65.5	71.4	77.5
Shpenzimet kapitale nga të cilat:							107.4	76.6	79.7	85.9	90.9
Financim i brëndshëm							49.6	37.1	37.4	36.9	40.3
Financim i jashtëm							36.0	37.7	40.4	46.6	46.6
Fondi i rindërtimit							20.0	0.0	0.0	0.0	0.0
Optimist nga e cila:							637.7	627.7	660.7	698.6	726.1
Shpenzimet korrente nga të cilat:							505.7	522.6	548.5	574.8	598.2
Operacionale & Mirëmbajtje							62.9	59.5	61.5	64.7	66.6
Interesat							50.8	57.5	65.5	71.4	77.5
Shpenzimet kapitale nga të cilat:							120.4	101.6	108.7	118.4	122.9
Financim i brëndshëm							61.6	61.1	65.4	68.4	71.3
Financim i jashtëm							36.0	37.7	40.4	46.6	46.6
Fondi i rindërtimit							20.0	0.0	0.0	0.0	0.0

Burimi: Ministria e Financave dhe Ekonomisë

Tabelë 4.7.2A Parametrat kryesorë fiskalë dhe zërat e financimit për secilin skenar (miliardë lekë)

	2016	2017	2018	2019	2020	2021	2022	2023	2024	2025	2026
						Vler	Para	Para	Para	Para	Para
Deficiti i Përgjithshëm											
Bazë	-26.7	-31.0	-26.2	-31.5	-110.4	-103.3	-100.9	-57.9	-58.9	-61.6	-52.5
Pesimist							-96.8	-48.8	-55.4	-58.4	-62.4
Optimist							-97.4	-51.5	-49.1	-48.2	-35.0
Financimi i deficitit të përgjithshëm											
Bazë nga e cila:	26.7	31.0	26.2	31.5	110.4	103.3	100.9	57.9	58.9	61.6	52.5
Huamarrja e brëndshme neto	10.6	16.3	19.6	17.8	48.4	49.9	50.0	50.0	50.0	50.0	50.0
Ndryshimi i stokut të likuiditetit në	0.3	-11.0	-30.5	16.6	14.7	-76.1	50.4	3.4	7.2	-7.7	-22.2
Huamarrja neto e jashtme nga e cila	17.5	29.1	33.1	-9.4	60.9	123.5	0.5	4.5	1.7	19.3	24.7
Financimi i projekteve të shënj	18.8	23.4	21.2	20.5	17.0	21.0	25.0	25.7	28.4	34.1	34.3
Eurobond	0.0	0.0	62.5	0.0	80.5	78.6	0.0	60.5	60.5	60.5	81.1
Mbështetje buxhetore nga IFIs	21.1	31.3	0.9	1.6	23.8	57.4	17.3	0.0	0.0	0.0	0.0
Ripagesat	-22.0	-25.8	-51.7	-29.8	-61.7	-34.1	-42.5	-82.2	-88.2	-76.2	-91.7
Flukse të tjera	-1.7	-3.4	4.1	6.5	-13.7	6.0	0.0	0.0	0.0	0.0	0.0
Pesimist nga e cila:							96.8	48.8	55.4	58.4	62.4
Huamarrja e brëndshme neto							40.9	38.8	50.6	39.8	37.9
Ndryshimi i stokut të likuiditetit në TSA							55.4	5.4	3.2	-0.7	-0.2
Huamarrja neto e jashtme nga e cila:							0.5	4.5	1.7	19.3	24.7
Numri i projekteve të kërkimit dhe të inovacionit të financuar	10 (projekte K&Zh) 20 (projekte për infrastrukturën e kërkimit shkencor)	15/25	20/30
% e fondit për kërkim dhe inovacion në raport me PBB-në (GERD)	0.1	0.15	0.2
Numri i marrëveshjeve/projekteve dypalësh dhe shumëpalësh	5+	10+	10+

3. Ndikimi i pritshëm në konkurrueshmëri

Forcimi i kapaciteteve kërkimore institucionale do të kontribuojë në përmirësimin e pjesëmarrjes në programet e *Horizon Europe* dhe do të forcojë lidhjet midis akademisë, biznesit dhe qeverisë në periudhën afatmesme dhe afatgjatë. Të ushqyerit e biznesit me kërkime dhe inovacione do të çojë në prodhimin e produkteve inovative në këto infrastruktura dhe do të krijojë vlerë të shtuar përmes komercializimit të këtyre produkteve.

Lidhur me konceptin S3, arsyetimi themelor pas është se duke përqendruar burimet e njohurive dhe duke i lidhur ato me një numër të kufizuar aktivitetesh prioritare ekonomike, vendet dhe rajonet mund të bëhen – dhe të mbeten – konkurrues në ekonominë globale. Ky lloj specializimi u mundëson rajoneve të përfitojnë nga shkalla, shtrirja dhe përhapja në prodhimin dhe përdorimin e njohurive, të cilat janë shtytës të rëndësishëm të produktivitetit. Shkurtimisht, Specializimi i zgjuar ka të bëjë me gjenerimin e aseteve dhe aftësive unike bazuar në strukturat e veçanta të industrisë dhe bazat e njohurive të rajonit.

4. Kostoja e parashikuar e aktiviteteve dhe burimi i financimit

Buxheti total i programit kërkimor në draftbuxhetin e planifikimit afatmesëm.

5. Ndikimi i pritshëm në përfundimet sociale, si: punësimi, ulja e varfërisë, barazia gjinore dhe aksesi në kujdesin shëndetësor

Ndikimi pozitiv në punësim reflektohet në krijimin e një qëndrueshmërie afatgjatë për personelin e kualifikuar. Fondet e siguruara nga MAS-i nëpërmjet instrumenteve "Projekte për përmirësimin e infrastrukturës"; "Projektet dypalëshe" dhe "Projektet e kërkimit dhe zhvillimit", ndër të tjera, mbështesin krijimin e vendeve të punës. Zhvillimet në inovacione pritet të kenë ndikim pozitiv në një gamë të gjerë aspektesh të aspekteve ekonomike dhe sociale dhe të zhvillimit.

Adaptimi, si specializim i zgjuar, synon të nxisë rritjen dhe vendet e punës, duke i mundësuar vendit të identifikojë dhe zhvillojë avantazhet e veta konkurruese. Nëpërmjet partneritetit dhe qasjes nga poshtë-lart, specializimi i zgjuar bashkon autoritetet lokale, akademinë, sferat e biznesit dhe shoqërinë civile, duke punuar për zbatimin e strategjive afatgjata të rritjes të mbështetura nga fondet e BE-së.

6. Ndikimi i pritshëm në mjedis dhe ndryshimi i klimës

Masat konsiderohen neutrale, për sa i përket ndikimit në mjedis. Nuk parashikohen ndikime negative në mjedis; përkundrazi, projektet inovative kanë potencialin të sjellin rezultate pozitive.

7. Rreziqet e mundshme

Sfidat për zbatimin e masave të lartpërmendura në fushën e kërkimit dhe të inovacionit përfshijnë vështirësi në koordinimin ndërinstitucional si dhe kufizime buxhetore.

Rreziku	Mundësia (e ulët, e lartë)	Veprimi zbutës i parashikuar
Kufizimet buxhetore	E ulët	Sipas kuadrit buxhetor afatmesëm, fondet e planifikuara për programet kombëtare për K&Zh, infrastrukturën e kërkimit shkencor dhe projektet dypalëshe/shumëpalëshe do të rriten për tri vitet e ardhshme.

Sfida kyçe #2

Rritja e mbulimit dhe e mjaftueshmërisë së mbrojtjes sociale dhe e sigurimit shëndetësor për të reduktuar popullsisë që rrezikohet nga varfëria

a) Analiza e pengesave kryesore

Sistemi i mbrojtjes sociale në Shqipëri mbizotërohet nga skemat e sigurimeve shoqërore (pensionet, përfitimet e papunësisë), si edhe nga programet jokontributive të parave (ndihma ekonomike dhe transfertat e aftësisë së kufizuar). Megjithëse është tejkaluar dyfishi që nga viti 2005, shpenzimi i përgjithshëm në Shqipëri për mbrojtjen sociale mbetet i ulët. Shqipëria shpenzoi 9.4% të PBB-së së saj për mbrojtjen sociale, që përkon me gjysmën e mesatares së BE-27, 18.6%. Pjesa më e madhe e shpenzimeve

për mbrojtjen sociale mbulon pensionet (82.4%), e ndjekur nga programet e asistencës në para jokontributive për personat me aftësi të kufizuara dhe personat e rrezikuar nga varfëria dhe skema e bonusit të bebes.

Shkalla e rrezikut nga varfëria në vitin 2019 është ulur me 0.4% krahasuar me vitin 2018. Aktualisht është 23.0%. Gjithashtu, treguesi i rrezikut nga varfëria apo përjashtimi social është ulur me 2.8%.

46.2% e popullsisë ishte në rrezik të varfërisë ose përjashtimit social, shifër me e lartë se mesatarja e BE-27 prej 21.6%.

Transfertat sociale, si pensionet e pleqërisë dhe ato familjare, të përfshira në të ardhurat e disponueshme të familjes, reduktojnë tendencën e rrezikut nga varfëria. Kur në nivelin e të ardhurave nuk përfshihen të gjitha transfertat sociale, rreziku i varfërisë në vitin 2019 vlerësohet 38,1 %, ndërsa vlerësohet 26,1%, kur në nivelin e të ardhurave përfshihen transfertat sociale vetëm nga pensionet e pleqërisë dhe ato familjare.

Skema e Ndihmës Ekonomike është programi kryesor i transfertave në para për të varfrit në Shqipëri, që është përmirësuar rrënjësisht gjatë viteve të fundit.

Kjo skemë ende has në disa pengesa: i. niveli i përfitimit mund të mos jetë adekuat krahasimisht me nevojat e popullsisë së targetuar nga ky program; ii. nuk ka një mekanizëm nëpërmjet të cilit niveli i përfitimit të përditësohet rregullisht; iii. formula e targetimit mund të rishikohet, për arsye se Shqipëria ka shkuar drejt përdorimit të anketës EU-SILC për llogaritjen e treguesve të varfërisë, ndërsa formula e përshtatshmërisë është llogaritur bazuar në Anketën e Buxhetit të Familjes; iv. Mbulimi i programit mund të mos jetë adekuat për sa i përket madhësisë së popullsisë aktualisht në nevojë.

Qeveria ka ndërmarrë masa të përkohshme për të rritur përshtatshmërinë e përfitimeve të asistencës sociale dhe për të zgjeruar mbështetjen e të ardhurave gjatë pandemisë. Për vitin 2021, buxheti për skemën u rrit nga 4.6 miliardë lekë në 7.1 miliardë lekë dhe përfitimet u dyfishuan në gjashtëmujorin e parë të 2021. Nga këto masa përfituan mesatarisht 69,700 familje.

Zbatimi i reformës së shërbimeve të kujdesit shoqëror u shoqërua me vënien në funksionim të Fondit Social. Fondi total i disbursuar për pushtetin vendor nga Fondi Social gjatë viteve 2020 dhe 2021 është përkatësisht 1,2 milion euro dhe 1,5 milion euro.

Në vitin 2020, shërbimet e kujdesit shoqëror të financuara nga fondi social funksionuan vetëm në 8 bashki.

Ndikimi i kësaj reforme është zgjerimi i hartës së shërbimeve (gjatë vitit 2021, 5 bashki (Kavajë, Krujë, Lezhë, Berati, Gjirokastër) së pari, kanë ofruar të paktën tri lloje shërbime të mbrojtjes sociale); rritja e numrit të përfituesve (në vitin 2020 – 0.56% e popullsisë në krahasim me 0.35% në 2019).

Programi i Përbashkët i OKB-së, "Askush mos të mbetet pas", në bashkëpunim me SHSSH-në ka kontribuar në aftësimin e bashkive për të planifikuar, buxhetuar, ofruar dhe monitoruar shërbimet vendore të kujdesit social, bazuar në të drejtat, siç parashikohet në Strategjinë e Mbrojtjes Sociale dhe ligjin për shërbimet e kujdesit shoqëror. Bashkitë kanë forcuar kapacitetet e tyre për zbatim të politikave të përfshirjes sociale në nivel lokal duke zhvilluar dhe kostuar plane të kujdesit social, të cilat u përgjigjen nevojave të burrave dhe të grave në nevojë. 60 bashki kanë hartuar dhe miratuar tashmë plane të kujdesit social.

Buxheti afatmesëm për 2021–2023 parashikon që vlera vjetore arrin në 1.61 milionë euro, pavarësisht rritjes së numrit të bashkie, që kualifikohen dhe rrjedhimisht në burimet e nevojshme. Masat për promovimin e përfshirjes sociale dhe të mundësive të barabarta për grupet vulnerabël fokusohen në gratë, të rinjtë, minoritetet rome dhe egjiptiane, personat me aftësi të kufizuara dhe të moshuarit. Fuqizimi dhe promovimi i të drejtave të barabarta dhe mosdiskriminimi përbëjnë çelësin për adresimin e pabarazive në kushtet e jetesës. Trajtimi i problemit të përjashtimit dhe diskriminimit në zonat urbane dhe rurale duhet të ketë një mbulim më të gjerë dhe aksesi në shërbime duke targetuar popullatën në nevojë për të mbështetur kohezionin social. Shqipëria ka bashkëpunuar me OKB-në për integrimin dhe përshpejtimin e OZHQ-ve në politikat dhe monitorimin e përfshirjes sociale dhe OZHQ-ve. Barazia gjinore, përfshirja sociale dhe planet kombëtare të veprimit për fëmijët, romët dhe egjiptianët dhe personat me aftësi të kufizuara përmbajnë një kornizë treguesish, që duhet të monitorohen me efektivitet nga secili aktor për të rritur zbatueshmërinë e të drejtave sociale-ekonomike në nivel qendror dhe vendor.

Përmirësimi i shtrirjes dhe i mbulimit të shërbimeve të kujdesit shoqëror, si mjediset e kujdesit për fëmijët, mjediset për personat me aftësi të kufizuara ose të moshuarit, janë komponentë thelbësorë që

mungojnë në sistemin e mbrojtjes sociale dhe do t'i ndihmojë këto kategori të rrisin pjesëmarrjen në tregun e punës dhe të zbutin varfërinë.

b) Masat e reformës

Masa e reformës 04: Rritja e mbulimit dhe e përshtatshmërisë së mbrojtjes sociale dhe e sigurimeve shëndetësore, për të ulur përqindjen e popullsisë së rrezikuar nga varfëria

1. Përshkrimi i masës

Qëllimi i përgjithshëm i kësaj mase është zgjerimi i mbulimit, gjithëpërfshirjes, efektivitetit dhe shënjestrimit më të mirë të individëve në nevojë, me shërbime të integruara sociale dhe mekanizmave financiarë: fondit social dhe ndërmarrjeve sociale.

Vëmendje e veçantë do t'u kushtohet: i. shërbimeve të integruara shëndetësore dhe sociale; ii. të fuqizohen njësitë e qeverisjes vendore për të përfshirë shërbimet dhe mekanizmat e duhur të kujdesit social në planet e tyre të politikave sociale; iii. vazhdimësisë së zbatimit të planit kombëtar të veprimit për deinstitucionalizimin; iv. rishikimit të standardeve minimale ekzistuese për 17 shërbime të kujdesit social dhe identifikimi i standardeve të reja funksionale dhe strukturore sipas nevojës; v. hartimit të një metodologjie dhe përcaktimit të kostos për njësi për shërbimet e kujdesit social, bazuar në standardet minimale strukturore dhe të funksionimit; vi. zhvillimit të metodologjisë për vlerësimin dhe shpërndarjen e fondit social kombëtar, duke marrë parasysh masat që adresojnë përmirësimin e transparencës dhe barazisë vertikale dhe horizontale.

Bazuar në vlerësimin e ecurisë së nivelit të përfitimit të ndihmës ekonomike, do të vendoset një mekanizëm transparent për rishikimin e rregullt të saj

Është ngritur një mekanizëm koordinues ndërinstitucional në nivel qendror, me ekipe pune në nivel rajonal dhe vendor për referimin dhe punësimin e individëve dhe anëtarëve në moshë pune të familjeve që përfitojnë ndihmë sociale. Këto struktura do të sigurojnë riintegrimin social, nëpërmjet koordinimit dhe zbatimit të një programi të daljes nga skema e ndihmës ekonomike. Është miratuar programi i daljes dhe plani i veprimit, me qëllimin për të nxitur integrimin shoqëror të familjeve nëpërmjet programeve të nxitjes së punësimit, në mënyrë që kjo skemë të mos përdoret si mjet përfitimi që mund të çojë drejt papunësisë së zgjatur të familjeve përfituese të ndihmës ekonomike dhe ta kthejë atë në një skemë aktive.

Aktualisht, është përgatitur udhërrëfyesi me hapat dhe afatet kohore për rregullimin e përfitimeve të ndihmës ekonomike dhe vendosjen e një mekanizmi transparent për rishikimin e rregullt vjetor të tyre, në përputhje me kushtin e asistencës makrofinanciare të BE-së për Shqipërinë.

Hapat e udhërrëfyesit, sipas angazhimit, do të zbatohen deri në fund të vitit 2024. Hapat përfshijnë analizën e performancës së përfitimit të ndihmës ekonomike, duke përdorur të dhënat më të fundit të HBS-së dhe EU-SILC dhe krijimin e një mekanizmi për të përditësuar rregullisht nivelin e përfitimit të ndihmës ekonomike.

Me ligjin 57/2019, "Për asistencën sociale në Republikën e Shqipërisë", u hoq një kufizim i mëparshëm, për të garantuar që përfitimet e fituara për shkak të aftësisë së kufizuar të mos ndërpriteshin, në rast punësimi për personat me aftësi të kufizuara, një hap drejt përfshirjes dhe integrimit social.

Në kuadër të barazisë gjinore dhe përfshirjes sociale, qeveria ka miratuar dokumentet strategjike: Strategjia për Barazinë Gjinore 2021–2030; Plani Kombëtar për Personat LGBTI; Plani Kombëtar i Veprimit për Aftësinë e Kufizuar 2021–2025; Plani Kombëtar për Barazinë, Përfshirjen dhe Pjesëmarrjen e Romëve dhe Egjiptianëve 2021–2025 dhe Agjenda Kombëtare për të Drejtat e Fëmijëve 2021–2026.

Ndërhyrjet konkrete synojnë:

i. krijimin e një mekanizmi për të rishikuar masën e përfitimit të ndihmës ekonomike;

ii. forcimin e kapaciteteve administrative të qeverisjes vendore për sektorin social, veçanërisht për të aplikuar për mbështetje nga fondi social dhe për të planifikuar, administruar dhe ofruar shërbime të reja të kujdesit social. Bazuar në një metodologji të re, në lidhje me vlerësimin dhe shpërndarjen e fondit social kombëtar, shërbimet sociale në territor duhet t'u përgjigjen më mirë nevojave të grupeve vulnerabël;

iii. mbështetjen e personave nga grupet e pafavorizuara me punësim në ndërmarrjet sociale, në zbatim të legjislacionit për ndërmarrjet sociale dhe akteve nënligjore, si mjet për riintegrimin e personave nga grupet vulnerabël. Nga kjo masë kanë përfituar statusin e ndërmarrjeve sociale 8 organizata, të cilat janë parashikuar të punësojnë 80 persona nga grupet vulnerabël;

iv. mbështetjen për të vazhduar aksesin në shërbimet e mbështetjes sociale edhe në rrethanat e reja të krijuara nga COVID-19 për gratë, burrat, vajzat, djemtë dhe fëmijët vulnerabël, që rrezikojnë të mbeten pas.

a) Aktivitete të planifikuara më 2022-shin

a) Krijimi i mekanizmit për përditësimin e rregullt të nivelit të përfitimit të NE-së;

b) Zbatimi i sistemit të vlerësimit biopsikosocial për personat me aftësi të kufizuara me mbështetje në para dhe kujdes shoqëror në katër qarqe;

c) Mbështetje për personat nga shtresat e disavantazhuara, veçanërisht përfituesit e ndihmës ekonomike dhe personat me aftësi të kufizuara drejt punësimit në ndërmarrjet sociale. Financimi i 5 ndërmarrjeve sociale;

d) Përmirësimi dhe zgjerimi i ofrimit të shërbimeve sociale të integruara me bazë komunitare nga njësitë e qeverisjes vendore për të gjitha kategoritë në nevojë në kuadër të fondit social;

e) Vlerësim i gjithë institucioneve publike të kujdesit rezidencial dhe zhvillimi i planit të transformimit të tyre;

f) Krijimi i një qendre mbështetëse dhe miqësore për fëmijët në Tiranë, Shkodër dhe Durrës, bazuar në pilotimin aktual në Korçë dhe Vlorë;

g) Zbatimi i Planeve Kombëtare të Veprimit për përfshirjen sociale dhe reduktimin e varfërisë nëpërmjet politikëbërjes dhe treguesve të përmirësuar.

b) Aktivitete të planifikuara më 2023-shin

a) Rregullimi i përfitimeve të ndihmës ekonomike;

b) Zgjerimi i zbatimit të sistemit të vlerësimit biopsikosocial për të mbështetur personat me aftësi të kufizuara, me mbështetje të kombinuar në para dhe kujdes social në rajone të tjera;

c) Mbështetje për personat nga shtresat në nevojë, veçanërisht përfituesit e ndihmës ekonomike dhe personat me aftësi të kufizuara, drejt punësimit në ndërmarrjet sociale. Financimi i ndërmarrjeve sociale.

c) Aktivitete të planifikuara më 2024-ën

a) Zgjerimi i zbatimit të skemës së vlerësimit biopsikosocial për të mbështetur personat me aftësi të kufizuara me mbështetje të kombinuar në para dhe kujdes social në qarqe të tjera;

b) Mbështetje për personat nga shtresat e pafavorizuara, veçanërisht përfituesit e ndihmës ekonomike dhe personat me aftësi të kufizuara, drejt punësimit në ndërmarrjet sociale. Financimi i ndërmarrjeve sociale;

c) Përmirësimi i ofrimit të shërbimeve sociale me bazë komunitare nga njësitë e qeverisjes vendore, për të gjitha kategoritë në nevojë, në kuadër të fondit social;

d) Finalizimi i transformimit për të gjitha shërbimet rezidenciale, njëkohësisht transformimi i avancuar i institucioneve rezidenciale jopublike;

e) Zbatimi i Planeve Kombëtare të Veprimit për përfshirjen sociale dhe reduktimin e varfërisë nëpërmjet politikëbërjes dhe treguesve të përmirësuar.

2. Treguesit e rezultateve

Tregues	Bazë (2021)	I ndërmjetëm (2023)	Synimi (2024)
% e popullsisë të rrezikuar nga varfëria dhe përjashtimi social	46.2% (2019)	45%	44%
Numri i shërbimeve të reja sociale për grupet e pafavorizuara të ofruara nëpërmjet njësive të qeverisjes vendore duke përdorur burime nga fondi social	19	30 (kumulative)	45 (kumulative)
Numri i personave vulnerabël të punësuar në ndërmarrjet sociale	N/A	100 (kumulative)	150 (kumulative)

3. Kostoja e parashikuar e aktiviteteve dhe burimi i financimit

Buxheti i mbrojtjes dhe përfshirjes sociale për vitin 2022 është 209,584,879 euro;

Buxheti i mbrojtjes dhe përfshirjes sociale për vitin 2023 është 216,679,174 euro;

Buxheti i mbrojtjes dhe përfshirjes sociale për vitin 2024 është 216,499,794 euro.

Nga ky buxhet, për vitin 2022, fondi për pagesën e ndihmës ekonomike dhe të aftësisë së kufizuar vlerësohet në 177 920 686 euro.

Financimi për fondin social përllogaritet në 1,6 milionë euro dhe për ndërmarrjet sociale 1 milionë euro.

Nga IPA (IPA 2019/04 l-203/Shqipëri/BE për përfshirjen sociale është vlerësuar një fond për Fondin social 1 milionë euro për vitin 2022 dhe 1.5 milionë për 2023-shin

4. Ndikimi i pritshëm në përfundimet sociale si punësimi, ulja e varfërisë, barazia gjinore dhe aksesi në kujdesin shëndetësor

Përmirësimi i situatës socio-ekonomike të kategorive në nevojë, ndikimi i drejtpërdrejtë në zbutjen e varfërisë, duke rritur nivelin e përfitimit të ndihmës ekonomike. Rritja e aksesit në paketën bazë të shërbimeve sociale dhe shëndetësore.

5. Ndikimi i pritshëm në mjedis dhe ndryshimi i klimës

Masa e reformës nuk pritet të ketë ndikim në mjedis.

6. Rreziqet e mundshme

Rreziku	Mundësia (e ulët, e lartë)	Veprimi zbutës i parashikuar
Kapacitete të munguara apo të ulëta në nivel vendor për hartimin e planeve të detajuara sociale.	I ulët	Bashkëpunimi me aktorët lokalë për ngritjen e kapaciteteve për plane sociale
Rritja e nivelit të varfërisë përtej parashikimeve për shkak të krizave të COVID-19	I lartë	Rishikimi i përfitimeve të ndihmës sociale

Masa e reformës 05: Rritja e aksesit në kujdesin shëndetësor

1. Përshkrimi i masës

Shëndeti për të gjithë mbetet synimi ynë kryesor. Rritja e aksesit në kujdesin shëndetësor dhe ofrimi i një kujdesi shëndetësor të sigurt dhe të barabartë në të gjitha nivelet e sistemit publik dhe jo vetëm, mbetet një nga objektivat kryesorë të qeverisë shqiptare. Ky objektiv është në përmbajtje të gjithë dokumenteve e politikave që janë në proces zbatimi, hartimi dhe buxhetimi të Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale nga viti 2013 e në vazhdim.

Ka pasur rritje progresive të buxhetit të dedikuar për shëndetësinë. Në vitin 2021 buxheti i dedikuar për shëndetësinë është 63.7 miliardë lekë ose 10.6% e buxhetit të shtetit dhe 3.6% e PBB-së (krahasuar me vitin 2020 ka një rritje prej 0.3% të PBB-së). Buxheti për vitin 2021 është 20.8% më i lartë se buxheti i shëndetësisë për vitin 2020 dhe 79.1% rritje krahasuar me vitin 2013. Shpenzimet për shëndetësi për frymë janë rritur nga 12,295 lekë më 2013-ën në 22,410 më 2021-shin me një rritje prej 82.3%.

Kontributet e kujdesit shëndetësor në vitin 2021 arrijnë në 14,084 milionë lekë dhe projeksioni për tri vitet e ardhshme është një rritje progresive vjetore të kontributeve shëndetësore mesatarisht 7%. Projeksioni është që në vitin 2022 kontributet shëndetësore të jenë 15,096 milionë lekë, në vitin 2023 kontributet 15,151 milionë lekë dhe në vitin 2024 do të jenë në masën 17,172 milionë lekë ose një rritje prej 21,78% krahasuar me vitin 2021.

Kujdesi shëndetësor në Shqipëri është tashmë në procesin e transformimit dhe modernizimit të vazhdueshëm. Objektivi ynë është të ofrojmë një ofertë shëndetësore të barabartë, të aksesueshme dhe të qëndrueshme pavarësisht nga statusi social dhe ekonomik, mosha, duke filluar nga lindja e deri tek të moshuarit.

Nga viti 2017, qeveria shqiptare ka zhvilluar një Program Kombëtar për Rindërtimin e të gjitha objekteve të kujdesit shëndetësor. Deri në vitin 2021, përmes këtij programi, 300 objekte të kujdesit parësor shëndetësor jo vetëm që u transformuan për sa u përket punimeve civile, por edhe u pajisën me pajisje të reja mjekësore. Programi do të vijojë të zbatohet edhe gjatë viteve në vazhdim, duke synuar transformimin e të gjitha objekteve të kujdesit shëndetësor parësor në vend brenda vitit 2025.

Parandalimi dhe diagnostikimi i hershëm i sëmundjeve tumorale do të vazhdojë të mbetet prioritet në fushën e shëndetit publik. Synimi është zgjerimi i tri programeve ekzistuese *Check Up,* Programet e Kancerit të Gjirit dhe Kancerit të Qafës së Mitrës, jo vetëm për kategoritë e grup-moshave, por edhe në lidhje me terapitë e trajtimit, sipas standardeve më të mira ndërkombëtare. Synimi është që brenda vitit 2025 vaksina HPV të jetë pjesë e Programit Kombëtar për Kancerin e Qafës së Mitrës, aktivitet ky që do të bëhet i mundur nëpërmjet bashkëpunimit të ngushtë me Institutin e Shëndetit Publik dhe Organizatën Botërore të Shëndetësisë.

Nga viti 2013 e deri më tani është përfshirë në listën e barnave me rimbursim 214 barna të reja dhe është rritur me 25% fondet e dedikuara rimbursimin e barnave nga lista, duke garantuar jo vetëm një paketë të plotë barnash që ofrohet falas për të gjithë qytetarët me sëmundje kronike, por edhe një listë me terapi inovative, për të cilat 8 vjet më parë qytetarët kishin koston nga buxheti i tyre familjar.

Është trefishuar financimi i barnave për trajtimin e pacientëve me kancer dhe tashmë garantojmë trajtim 100% falas me barna për pacientët me kancer gjiri dhe kancer malinj të gjakut.

Brenda vitit 2023 synohet ndryshimi i hartimit të Listës së Rimbursimit të Barnave, duke zhvendosur fokusin nga rimbursimi i barit si produkt në rimbursimin e protokollit të trajtimit të diagnozave, për t'iu

përgjigjur më mirë nevojave të pacientëve, teknologjitë dhe risitë në Shërbimin Farmaceutik.

Sistemi i gjurmueshmërisë së barnave do të jetë një tjetër aktivitet që do të zhvillohet brenda vitit 2023 me synim rritjen e disponueshmërisë së barnave dhe garantimin e një monitorimi të plotë të barnave që qarkullojnë në Republikën e Shqipërisë.

Për herë të parë në vitin 2018 është përfshirë në skemën e rimbursimit edhe rimbursimin e pajisjeve mjekësore. Dhe, që nga viti 2018, të gjithë fëmijët dhe të rinjtë deri në moshën 25 vjeç përfitojnë falas fishat e diabetit.

Me synimin e mbulimit universal për fëmijët 0–18 vjeç më 2019ën u zgjerua numri i vaksinave në Programin Kombëtar të Imunizimit dhe Vaksinimit, duke përfshirë vaksinën e Rotavirusit dhe synimin për të vazhduar mbështetjen për forcimin e programit për të mbrojtur mbulimin me vaksinim në 98%.

Për më tepër, do të vazhdohet mbështetja financiare për çdo familje që sjell në jetë një fëmijë me programin dedikuar të *Baby Bonus,* nga i cili që nga fillimi i programit në 2019 janë rreth 100 mijë familje që kanë përfituar bonusin financiar të tremujorin e parë të jetës së të porsalindurit.

Në drejtim të përmirësimit të shëndetit të popullatës do të vazhdohet financimi dhe shtimi i paketave shëndetësore, me synim rritjen e aksesit në trajtime mjekësore dhe ofrimin e shërbimeve shëndetësore të shtuara pranë vendbanimit.

Nga buxheti i shtetit mbulohen plotësisht mbi 85% e nevojave të popullsisë për trajtimin e diagnozave kardiovaskulare dhe veshkave dhe synohet rritja e mbulimit me 5% deri në fund të vitit 2024, duke zgjeruar paketat me paketat e dedikuara shëndetësore për rehabilitimin, kujdesi paliativ dhe geriatrik.

Gjatë këtyre 8 viteve është investuar në modernizimin e rrjetit të Spitalit Obstetrik Gjinekolog, duke filluar me punimet civile dhe pajisjet e reja mjekësore në SUOGJ "Koço Gliozheni", SUOGJ "Mbretëresha Geraldinë", spitalet e reja obstetrike dhe gjinekologe në Berat, Kukës, Sarandë, Lezhë. Në Korçë kanë vijuar investime të mëdha dhe në Spitalet Pediatrike Nënë Tereza, Durrës dhe Elbasan.

Synimi është që brenda vitit 2024 të jenë ngritur 4 pole spitalore rajonale që do të krijohen në qendrat referuese të diagnostifikimit dhe të trajtimit, si dhe të krijohet dhe të funksionojnë plotësisht 10 qendra të mjekësisë familjare që do të ofrojnë shërbime të integruara sociale dhe shëndetësore me fokus në shëndeti mendor, shërbimet për fëmijët dhe të rinjtë si dhe kujdesi paliativ.

Pandemia e COVID 19 testoi të gjitha nivelet e sistemit. Me mbështetjen e OBSH-së u përgatitën 4 dokumente strategjike,si udhërrëfyes i qasjes sonë të integruar për të menaxhuar pandeminë dhe për t'u siguruar që sistemi ynë shëndetësor publik të ofrojë akses në kohë për shërbimin e kujdesit shëndetësor duke filluar nga parandalimi, diagnostikimi, trajtimi dhe vaksinimi.

Në kohë rekord u transformuan 4 spitale në spitale COVID–19, nga këto dy u krijuan për herë të parë si spitale. Është dyfishuar numri i ventilatorëve dhe njësive të ICU-së, si dhe u rritën katër herë kapacitetet laboratorike për testim. Mbështetje e veçantë financiare është ofruar nëpërmjet mekanizmit të bonusit prej 1000 eurosh mbi pagën për të gjithë personelin mjekësor dhe 500 euro mbi pagën për personelin ndihmës.

Nga marsi i vitit të kaluar e deri më tani rreth 4000 personel mjekësor kanë përfituar 1000 euro bonus dhe mbi 1200 staf ndihmës kanë përfituar 500 euro bonus mbi pagën.

Mbështetja financiare për personelin mjekësor dhe për personelin ndihmës do të vazhdojë të ofrohet deri në përfundimin e pandemisë së COVID-19.

Gjatë këtij viti të pandemisë, kemi investuar dhe përgatitur njësitë e kujdesit të kujdesit shëndetësor dhe pavijonet e sëmundjeve infektive në 11 spitalet rajonale për të qenë gati për çdo lloj emergjence.

Gjatë këtij katërvjeçari do të vazhdohet të garantohen dhe ofrohen shërbime shëndetësore që mbulohen 100% nga buxheti i shtetit, duke filluar nga diagnozat e deri te fuqizimi i rrjetit laboratorik publik me pajisje dhe pajisje të reja mjekësore për të garantuar në sektorin spitalor publik të gjitha analizat mjekësore. Trajtimi nëpërmjet paketës së dedikuar të Listës së Rimbursimit të Barnave për të gjithë pacientët që janë të infektuar nga SARS–COV–2, si dhe një paketë të plotë trajtimi sipas praktikave dhe protokolleve më të mira ndërkombëtare për të gjithë pacientët tanë që do të kenë nevojë për trajtim spitalor.

Brenda vitit 2022 do të jetë përfunduar modernizimi i infrastrukturës së Spitalit tonë të Sëmundjeve Infektive në Qendrën Spitalore "Nënë Tereza" në Tiranë, që do të garantojë jo vetëm një transformim të plotë të kujdesit spitalor për qytetarët tanë, por edhe dyfishimin e njësive të ICU-së.

Në një kohë rekord është arritur të të garantohen rreth 3 milionë doza vaksinash dhe deri në fund të pranverës, përmes mekanizmit COVAX dhe kontraktimit të drejtpërdrejtë me prodhuesit dhe shpërndarësit e autorizuar do të garantohen 5 milionë doza për të nisur edhe aplikimin e dozës së tretë dhe

doza dhe për fëmijët nën 18 vjeç sipas rekomandimeve të OBSH-së dhe ICDC-së.

Shëndeti do të vazhdojë të mbetet një e mirë publike dhe për këtë arsye deri në vitin 2030 synohet rritja e financimit publik për shëndetësinë në 70%, duke garantuar që asnjë familje shqiptare të mos bjerë në varfëri për shkak të kostove shëndetësore.

Gjatë këtyre 8 vjetëve i është kthyer dinjiteti i personelit mjekësor. Sot një mjek ose një infermier që është i punësuar në një spital publik ka një pagë 63% më të lartë se në vitin 2013. Një mjek i përgjithshëm ose një infermier në qendrën e kujdesit shëndetësor parësor ka një pagë 68% më të lartë se në vitin 2013. Do të vazhdohet edhe gjatë këtij katërvjeçari për të zbatuar politikën për rritjen e pagave deri në 40% për personelin mjekësor.

Brenda vitit 2025 do të përfundohet testimi dhe modernizimi i rrjetit laboratorik publik në 10 spitale rajonale dhe bashkiake, duke garantuar një rritje prej 20% të qytetarëve, që do të përfitojnë nga ekzaminimet laboratorike, rritjen e kapaciteteve diagnostikuese në 10 spitale bashkiake, rajonale dhe universitare, nëpërmjet investimit në pajisje mjekësore, ngritja e 3 qendrave rajonale të ekselencës në ofrimin e kujdesit për sëmundjet akute ishemike, si dhe investime të mëdha do të bëhen edhe në modernizimin e institucioneve të shëndetit mendor.

a) Aktivitete të planifikuara më 2022–2024

a) Financimi i këtij lloji të kujdesit shëndetësor (të tri nivelet e sistemit primar, sekondar dhe terciar);

b) Rritja e kostos – efikasitetit të listës së barnave të rimbursimit dhe rishikimi i legjislacionit kombëtar për barnat dhe shërbimet farmaceutike;

c) Vazhdimi i financimit të 12 paketave të kujdesit shëndetësor të ofruara në spitalet publike dhe private dhe rritja e numrit të përfituesve me 5% në bazë vjetore;

d) Rishikimi i ligjit për spitalet dhe metodologjia e kostos së shërbimeve të kujdesit shëndetësor me qëllim përmirësimin e mekanizmit të financimit të institucioneve të kujdesit shëndetësor;

e) Vazhdimi i financimit të programeve të depistimit parandalues dhe rritja deri në 10% të numrit të përfituesve;

f) Politikat e dedikuara për profesionistët e kujdesit shëndetësor parashikojnë praktikën e dyfishtë dhe klasifikimin e pagave, sipas treguesve të performancës;

g) Krijimi i Shërbimit Shëndetësor Kombëtar, si një pagues i vetëm dhe transformimi gradual i financimit të spitaleve nga buxheti historik në paketat e shërbimit shëndetësor;

h) Strategjia Kombëtare e Shëndetësisë 2021–2025 dhe plani i veprimit i buxhetuar.

2. Treguesit e rezultateve

Tregues	Bazë	I ndërmjetëm	Synimi
Numri i qytetarëve që përfitojnë nga shërbimet e kujdesit shëndetësor publik	93%	95%	97%
Numri i qytetarëve që përfitojnë nga 12 paketat e kujdesit shëndetësor dhe 3 programet kombëtare të depistimit të financuara 100% nga buxheti i shtetit	+5%	+5%	+5%

3. Ndikimi i pritshëm në konkurrueshmëri

Veprimet e parashikuara kanë disa dimensione ndikimi, të tilla si zbatimi dhe përmirësimi i ofrimit të shërbimeve të kujdesit shëndetësor publik, rritja e aksesit, diversifikimi i ofrimit të shërbimeve, duke futur modele të reja inovative të kujdesit shëndetësor (shërbimet e banimit, vullnetare dhe me bazë komunitare) me theks të veçantë në ofrimin e shërbimeve me theks të veçantë në cilësinë e lartë, të arritshëm dhe të përballueshëm.

4. Kostoja e parashikuar e aktiviteteve dhe burimi i financimit

Buxheti i shëndetësisë për vitin 2022 është 63.5 miliardë lekë ose 3.4% e PBB-së dhe 9.96% e buxhetit të shtetit.

Buxheti i shëndetësisë për vitin 2023 është 60 miliardë lekë ose 3.1% e PBB-së dhe 9.6% e buxhetit të shtetit.

Buxheti i shëndetësisë për vitin 2024 është 62 miliardë lekë ose 3% e PBB-së dhe 9.4% e buxhetit të shtetit.

5. Ndikimi i pritshëm në përfundimet sociale, si: punësimi, ulja e varfërisë, barazia gjinore dhe aksesi në kujdesin shëndetësor

Reformat në shëndetësi synojnë të moshuarit, gratë, fëmijët, të varfrit dhe personat me aftësi të kufizuara. Masa e reformës pritet të përmirësojë mirëqenien e qytetarëve, duke ofruar shërbime shëndetësore falas me qëllim arritjen e mbulimit universal shëndetësor.

6. Ndikimi i pritshëm në mjedis dhe ndryshimi i klimës

Masa e reformës nuk pritet të ketë ndikim në mjedis.

7. Rreziqet e mundshme

Rreziku	Mundësia (e ulët, e lartë)	Veprimi zbutës i parashikuar
Kufizimet për shkak të pandemisë COVID-19	I mesëm	Një planifikim i kujdesshëm në nivelin qendror
Vonesat në aktivitete specifike, veçanërisht në lidhje me rimodelimin e financimit të kujdesit shëndetësor	I mesëm	Një ekip që ka nisur punën për zhvillimin e një plani të detajuar
Mungesa e vullnetit politik	I ulët	Një angazhim i niveleve më të larta të qeverisjes dhe përfshirja e të gjithë partnerëve të mundshëm në këtë sektor

Sfida kyçe #3

Përmirësimi i mjedisit të biznesit dhe klimës së investimeve, duke rritur mbështetjen e qeverisë dhe duke trajtuar informalitetin

a) Analiza e pengesave kryesore

Sektori privat i Shqipërisë përbëhet kryesisht nga ndërmarrjet mikro, të vogla dhe të mesme (MSME), të cilat kanë një barrë informaliteti. Shqipëria nisi një fushatë në mbarë vendin për të luftuar ekonominë informale në vitin 2016 dhe numri i tatimpaguesve të regjistruar dhe kontribuuesve socialë u rrit ndjeshëm. Që nga viti 2019, qeveria ka zbatuar një metodë të bazuar në risk për të përqendruar veprimin e saj në ekonominë informale, në një mënyrë më efikase dhe për ta zhvendosur fokusin larg mobilizimit të të ardhurave shtesë të buxhetit, duke rritur numrin e kontrolleve dhe inspektimeve.

Me gjithë përparimin e kohëve të fundit duke rritur numrin e bizneseve të regjistruara, ato ndonjëherë ende nuk deklarojnë tatimet apo punonjësit dhe kryejnë transaksione me para në dorë. Bizneset informale përgjithësisht kanë rendiment më të ulët se bizneset formale, gjë që është një barrë, si për bizneset, ashtu edhe për ekonominë. Të ardhurat publike reduktohen nga veprimtaria e fshehur ekonomike, duke rezultuar në pakësimin e ofrimit të të mirave dhe shërbimeve publike. Biznesi i kryer jashtë ekonomisë së rregulluar sjell probleme për sigurinë, shëndetin, mbrojtjen sociale dhe rreziqet mjedisore për punëtorët dhe komunitetet. Informaliteti pengon jo vetëm zhvillimin e atyre bizneseve që vendosin të mbeten informale, por është, gjithashtu, një pengesë për kompanitë formale që ndeshen me konkurrencën nga sektori informal. Duke qenë jashtë ekonomisë formale, këto kompani nuk kanë mundësinë për të përfituar nga aksesi në financat formale, aksesi në tregjet formale dhe nga mbrojtja ligjore e pronës, kontratave dhe investimeve të tyre. Për të lejuar bizneset të kontribuojnë më mirë në ekonomi është e rëndësishme që qeveria të vazhdojë të investojë në mënyrë thelbësore në formalizimin e këtyre MSME-ve.

Qeveria shqiptare është e vendosur t'i shërbejë qeverisjes së mirë të bizneseve, si dhe reduktimit të metodës korruptuese në disa aspekte në luftën kundër evazionit dhe informalitetit. Gjatë periudhës 2020–2021, qeveria shqiptare u përfshi në një proces shumë të rëndësishëm lidhur me ligjin e fiskalizimit, i cili do të ndihmojë drejtpërdrejt administratën tatimore për të marrë të dhëna në kohë reale dhe të sakta, për të gjitha transaksionet e biznesit me administratën tatimore, por edhe të gjithë informacionin që qarkullon në marrëdhëniet "biznes me biznes" dhe "biznes me qeverinë".

I gjithë procesi i informacionit nëpërmjet faturimit tashme është elektronik dhe kjo do të ushtrojë një presion edhe më të madh ndaj aksesit në deklarimet reale financiare dhe atyre jofiskale, që sot ne i konsiderojmë të jenë larg realitetit.

Faza e parë e zbatimit të fiskalizimit, e cila konsiston në transaksione pa para të gatshme ndërmjet tatimpaguesve dhe subjekteve publike (B2G) ka nisur më 1 janar 2021; faza e dytë e transaksioneve pa para ndërmjet tatimpaguesve (B2B) ka filluar më 1 korrik 2021, ndërsa më 1 shtator 2021 ka nisur faza e fundit për transaksionet me para në dorë tatimpagues-konsumator (B2C). Të dhënat në dispozicion janë si vijon:

1. Rreth 59.000 tatimpagues aktivë të fiskalizuar dhe mbi 126 milionë fatura të fiskalizuara që prej datës 1 janar 2021.

2. 88.609 tatimpagues ose 73% e totalit të tatimpaguesve aktivë janë pajisur me certifikatë fiskalizimi.

3. 21.878 tatimpagues ose 86.4 % e tatimpaguesve aktivë biznes i madh (BM) janë pajisur me certifikatë fiskalizimi. 18.643 tatimpagues aktivë BM ose 73.6 % e totalit të BM kanë lëshuar fatura të fiskalizuara.

4. 64.698 tatimpagues ose 71.1% e tatimpaguesve aktivë biznes i vogël (BV) janë pajisur me certifikatë

fiskalizimi. 37.654 ose 41.4% e tatimpaguesve aktivë BV kanë lëshuar fatura të fiskalizuara.

Administrata tatimore do të jetë e angazhuar në luftën kundër informalitetit për të garantuar zbatimin korrekt të procedurave tatimore. Tatimpaguesit mospërmbushës do të evidentohen nga analiza e riskut dhe do të përfshihen dhe struktura të tjera në verifikimin dhe kontrollimin e tyre për të garantuar përmbushjen e detyrimeve tatimore që të forcohet besimi i tatimpaguesve përmbushës dhe i publikut ndaj administratës tatimore.

Për vitin 2022 do të miratohet plani i përmbushjes që do të fokusohet në sektorët me një rëndësi të veçantë në ekonomi, si: turizmi, subjekte kafe-restorante, ndërtimi dhe pagat.

Gjithashtu, për vitin 2022, do të mbahet parasysh identifikimi dhe analizimi i sjelljeve deviante nga subjektet që tentojnë të përfitojnë nga pragjet tatimore (skema feniks, nëndeklarim i shitjeve, mosdeklarim i blerjeve etj.)

Në vitin 2021, në kuadër të luftës kundër informalitetit administrata tatimore hartoi dhe zbatoi:

1. Planin sektorial të turizmit 2021, me këto arritje:

i. për të njëjtët tatimpagues që kanë qenë aktiv dhe në vitin 2019, gjatë sezonit turistik të vitit 2021 është shënuar një rritja e TVSH-se së detyrueshme për t'u paguar me 15%;

ii. është kryer regjistrimi në përgjegjësinë e TVSH-së për 175 tatimpagues;

iii. rritje me 8% e numrit të punonjësve për tatimpagues aktiv në të dyja periudhat 2021–2020;

iv. rritje me rreth 16% e numrit të punonjësve të deklaruar për popullatën e targetuar aktive (për totalin e TP-së).

2. Planin sektorial të rindërtimit

Duke marrë shkas nga lehtësitë e krijuara nga qeveria shqiptare për të mundësuar procesin e rindërtimit nga pasojat e tërmetit të vitit 2019 në një kohë sa më të shpejtë, administrata tatimore zbatoi një projekt të menaxhimit të riskut për subjektet e përfshira në procesin e rindërtimit dhe që janë pajisur me Autorizimin "Për përjashtim nga TVSH-ja për subjektet e rindërtimit". Në kuadër të zbatimit të këtij plani sektorial, qëllimi i administratës është ndërgjegjësimi i tatimpaguesve, për: 1. Deklarim real dhe në kohë të detyrimeve tatimore. 2. Mosabuzim me autorizimin e marrë dhe mënyrën e zbatimit të përjashtimit nga TVSH-ja për aktivitetet e rindërtimit.

Forma e trajtimit të tyre konsiston në dërgimin e letrave të personalizuara ata tatimpagues që nuk kanë rezultuar me rregulla të thyera nga pikëpamja tatimore bazuar në analizën e riskut. Ndërsa për ata tatimpagues të cilët kanë rezultuar mospërmbushës janë planifikuar 125 vizita fiskale, 45 kontrolle tatimore në ambientet e TP-së, si dhe 324 kontrolle nga zyra për TP-në që nuk janë të pajisur me autorizimin "Për përjashtim nga TVSH për subjektet e rindërtimit", por kanë bërë shitje pa TVSH ndaj tatimpaguesve të pajisur me autorizimin, për sa i përket detyrimit për rregullim të TVSH-së. Janë realizuar 45% e kontrolleve nga zyra dhe kemi të dhëna në shifra për efektin në detyrim pagese për TVSH-në, që aktualisht rezulton në vlerën 53.735.561 lekë.

Ky proces është në vijimësi dhe gjatë vitit 2022 do të pasqyrojmë një përmbledhje të gjetjeve nga vizitat fiskale dhe kontrollet në ambientet e tatimpaguesve për të konkluduar mbi këtë plan sektorial.

Pandemia e COVID-19 ka pasur një ndikim të madh në ekonominë shqiptare gjatë vitit të kaluar. Përgjatë vitit 2020 ekonomia globale u përball me vazhdimin e përhapjes së pandemisë COVID-19 dhe me masat shtrënguese të ndërmarra nga autoritetet publike për frenimin e përhapjes. Në Shqipëri, qeveria vendosi kufizime të lëvizjes së lirë që prej muajit mars, për të parandaluar përhapjen e mëtejshme të pandemisë në vend. Shqipëria është veçanërisht e ekspozuar ndaj tkurrjes ekonomike prej pandemisë për shkak se mbështetet fort nga sektori i turizmit dhe, për shkak të marrëdhënieve të saj intensive me disa ekonomi të BE-së të prekura rëndë nga pandemia. Sipas vlerësimeve më të fundit nga INSTAT-i, PBB-ja reale u tkurr me 2.34 për qind në terma vjetorë në tremujorin e parë, duke u pasuar nga një rënie më e thellë prej -10.20 përqindësh në tremujorin e dytë dhe nga statistikat e fundit të publikuara nga INSTAT-i, në tremujorin e tretë, rënia është zbutur në shifrën -3.47 për qind krahasuar me tremujorët respektivë të vitit 2019. Ndërsa në terma nëntëmujorë për vitin 2020, ekonomia ka pësuar rënie me 5.52 për qind kundrejt së njëjtës periudhë të 2019.

Eksportet e mallrave dhe të shërbimeve, sipas vlerësimeve të INSTAT-it, gjatë nëntëmujorit të vitit 2020 janë tkurrur në mënyrë drastike me rreth 29.6 për qind. Por, ndërkohë, duke qenë se edhe tkurrja e importeve të mallrave dhe të shërbimeve ka qenë po ashtu tepër e fortë, si dhe në reflektim të peshës së lartë që importet kanë në ekonominë tonë, ka rezultuar në një rritje të kërkesës së huaj neto (ngushtim të deficitit midis eksporteve dhe importeve) krahasuar me një vit më parë me rreth 6.6 për qind, e

rrjedhimisht duke dhënë një kontribut pozitiv në rritjen e PBB-së prej rreth 1.2 pikë përqindjeje.

Nga pikëpamja e ofertës agregate, dy sektorët të cilët kanë pësuar rritje përgjatë periudhës nëntëmujore të viti 2020, krahasuar me të njëjtën periudhë të një viti më parë janë: "Bujqësia" me rritje prej 1.8 përqindësh dhe kontribut pozitiv prej 0.3 pikë përqindjeje, si dhe "Aktivitete të pasurive të paluajtshme" me rritje prej 5.9 përqindësh dhe kontribut pozitiv prej 0.4 pikë përqindjeje. Sektorët e tjerë kanë pësuar rënie në rendin vijues, ku: "Tregtia me shumicë dhe pakicë" është ulur me 15 për qind, dhe kontribut negativ prej 2.4 pikë përqindjeje; "Aktivitete shkencore dhe profesionale" me rënie prej 14.4 përqindësh dhe kontribut prej -0.9; "Arte, argëtim dhe çlodhje", me rënie prej 10.8 përqindësh dhe kontribut prej -0.2; "Industria" me rënie prej 5.4 përqindësh dhe kontribut prej -0.7 pikë përqindjeje etj.

Dinamika në tregun e punës ka reflektuar përgjithësisht atë të aktivitetit ekonomik. Ndërkohë që viti 2019 rezultoi me një reduktim të mëtejshëm të shkallës së papunësisë me një nivel mesatar për gjithë vitin prej 12 përqindësh (për grup-moshën 15–64 vjeç), nëntëmujori i 2020 regjistroi një përkeqësim të konsiderueshëm të këtij treguesi në gjysmën e parë të vitit dhe më pas një rikuperim në tremujorin e tretë. Referuar anketës tremujore të forcës së punës nga INSTAT-i, norma e papunësisë (për grup-moshën 15–64 vjeç) regjistroi nivelin prej 11.9 përqindësh në tremujorin e parë, 12.5 për qind në të dytin dhe ra sërish në 12.1 për qind në T3-2020. Norma mesatare e papunësisë për nëntëmujorin e 2020-ës ishte 12.2 për qind, duke qëndruar pothuajse në të njëjtin nivel prej 12.1 përqindësh të nëntëmujorit të 2019. Ndërkohë, për grup-moshën 15 vjeç e sipër, norma e papunësisë gjatë tremujorit të tretë të vitit 2020 regjistroi nivelin prej 11.6 përqindësh, me një rritje prej vetëm 0.2 pikë përqindjeje nga tremujori i tretë i 2019.

Shumë nga sfidat strukturore të përshkruara më sipër kanë luajtur një rol ose në përforcimin e ndikimit në epideminë e COVID-19 ose në kufizimin e fushëveprimit të përgjigjeve të politikave për të zvogëluar ndikimin e saj. Në qershor 2021, Këshilli Shqiptar i Investimeve nisi rezultatet e sondazhit me temë "Vlerësimi i ndikimit të COVID-19 në aktivitetin e biznesit në Shqipëri". Ky anketë bazohet në sondazhin e parë të kryer nga Sekretariati gjatë muajit prill 2020 dhe synon të mbledhë të dhëna për periudhën 12-mujore (prill 2020–prill 2021). Sondazhi "Vlerësimi i ndikimit të pandemisë COVID-19 në biznesin në Shqipëri", një iniciativë e Sekretariatit të Këshillit të Investimeve dhe Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë, u ndërmor në periudhën prill–maj 2020, me qëllim mbledhjen e provave mbi efektet e pandemisë COVID-19 në biznesin dhe aktivitetin e saj.

Sipas sondazhit:

- Kompanitë kanë vazhduar të përdorin shërbimet *online*, kryesisht shërbimet qeveritare dhe në një masë më të vogël shërbimet *online* të institucioneve financiare.

- Kompanitë që kanë deklaruar se kanë përdorur shërbimet *online*, në 86% e tyre deklarojnë se do të vazhdojnë t'i përdorin ato në të ardhmen.

- 86% e kompanive të intervistuara në fillim të pandemisë deklaruan se nuk kishin një strategji emergjence. Sot, një vit më vonë, 52% e kompanive deklarojnë se do të miratojnë një plan emergjence, më të predispozuar janë bujqësia, tregtia dhe turizmi.

- 60% e kompanive mbi 14 milionë lekë vlerësojnë se do të miratojnë plane emergjente, ndërkohë që vetëm 47% e kompanive deri në 5 milionë lekë e konfirmojnë këtë.

- Pandemia duket se ka përshpejtuar nevojën që kompanitë të fokusohen tek inovacioni, 57% e të anketuarve thonë se kanë ndryshuar planet e tyre të investimeve drejt inovacionit, kryesisht teknologjive të reja dhe menaxhimit të rrezikut. Bujqësia është sektori me dëshirën më të lartë për t'u orientuar drejt inovacionit.

- Bujqësia do të investojë më shumë në forcimin e kanaleve tregtare, menaxhimin e rrezikut dhe teknologjitë e reja. Turizmi në menaxhimin e riskut dhe formimin profesional.

- Pavarësisht përmasave, kompanitë deklaruese kanë ndryshuar planet e tyre të investimit drejt Inovacionit, kryesisht menaxhimit të riskut dhe formimit profesional.

b) Masat e reformës

Masa e reformës 06: Fuqizimi i luftës kundër informalitetit

1. Përshkrimi i masës

Nismat kryesore të marra nga administrata e taksave kundër informalitetit në vitin 2021 u bazuan në parime dhe objektiva të qartë bazuar në inteligjencën (risk).

Faza e parë e zbatimit të fiskalizimit, e cila konsiston në transaksione pa para të gatshme ndërmjet tatimpaguesve dhe subjekteve publike (B2G) ka nisur më 1 janar 2021; Faza e dytë e transaksioneve pa

para ndërmjet tatimpaguesve (B2B) ka filluar më 1 korrik 2021, ndërsa më 1 shtator 2021 ka nisur faza e fundit për transaksionet me *cash* tatimpagues-konsumator (B2C). Të dhënat në dispozicion janë si vijon:

- Rreth 59.000 tatimpagues aktivë të fiskalizuar dhe mbi 126 milionë fatura të fiskalizuara që prej datës 1 janar 2021;
- 88.609 tatimpagues ose 73% e totalit të tatimpaguesve aktivë janë pajisur me certifikatë fiskalizimi;
- 21.878 tatimpagues ose 86.4 % e tatimpaguesve aktivë Biznes i Madh (BM) janë pajisur me certifikatë fiskalizimi. 18.643 tatimpagues aktivë BM ose 73.6 % e totalit të BM kanë lëshuar fatura të fiskalizuara;
- 64.698 tatimpagues ose 71.1% e tatimpaguesve aktivë Biznes i Vogël (BV) janë pajisur me certifikatë fiskalizimi. 37.654 ose 41.4% e tatimpaguesve aktivë BV kanë lëshuar fatura të fiskalizuara.

Në kuadrin e luftës kundër informalitetit, administrata tatimore hartoi dhe zbatoi veprimet e mëposhtme:

1. Plani Sektorial i Turizmit 2021;
2. Rregullat e riskut për mbikëqyrjen e tatimpaguesve në kuadrin e ndryshimit të pragut të TVSH-së;
3. Plani Sektorial i Rindërtimit.

Rezultatet kryesore nga këto iniciativa janë:

1. Plani Sektorial i Turizmit 2021

- Rritje me 8% e xhiros gjatë sezonit turistik 2021, krahasuar me vitin 2019 për të njëjtën periudhë për tatimpaguesit aktivë të synuar;
- 4% rritje e pagesës së TVSH-së duke identifikuar dhe inkurajuar tatimpaguesit që rezultojnë në mosdeklarim apo pagesë të vonuar;
- Reduktim me 25% të numrit të tatimpaguesve (TP) që deklarojnë në listë pagesë vetëm 1 punonjës;
- Zvogëlim me 15% të numrit të punonjësve me pagë minimale ose më pak.

2. Plani Sektorial i Rindërtimit

U identifikuan tatimpagues me risk:

- shitjet e mëdha të përjashtuara nga TVSH-ja;
- tatimpagues me përqindjen më të lartë të punonjësve nen pagën minimale;
- tatimpagues me një rënie në koeficientin e pagesës së TVSH-së;
- tatimpagues që rezultojnë me 1–3 punonjës;
